

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

Për klasën VI dhe VII të arsimit joformal
për shkollën e mesme të ulët

Prishtinë, dhjetor 2004

Kryeredaktor

Isuf Zeneli

Redaktorë

Agim Bërdyna

Ramush Lekaj



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,
E SHKENCËS DHE E
TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF
EDUCATION, SCIENCE
& TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i Planit dhe i programit për klasën e gjashtë dhe të shtatë për mësimin joformal

NUMËR: MASHT[I] 3/2005

DATA: 06.01.2005

Në bazë të nenit 1.3, pika (ç), të Rregullores numër 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenin 6.1, pika (c), dhe nenit 42 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1 Qëllimi

Qëllim i këtij Udhëzimi është zbatimi i Planit dhe i programit mësimor për klasën e gjashtë dhe të shtatë të mësimin joformal, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2
Plani dhe programi

Plani dhe programi i ri për klasën e gjashtë dhe të shtatë të mësimi joformal i është bashkëngjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3
Zbatimi

- 3.1. Ky Plan dhe program për klasën e gjashtë dhe të shtatë të mësimi joformal zbatohet nga viti shkollor 2004/2005.
- 3.2. Me zbatimin e Planit dhe programit për klasën e gjashtë dhe të shtatë të mësimi joformal shfuqizohen planet dhe programet e deritashme për klasën e gjashtë dhe të shtatë të mësimi joformal të shkollës fillore.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e Ministrit.


Agim Yeliu, Ministër

PËRMBAJTJA

Udhëzime për zbatimin e planit dhe të programit

I. Hyrje, **7**

II. Qëllimet, **8**

III. Udhëzime metodologjike, **9**

IV. Vlerësimi, **10**

V. Burimet dhe mjetet mësimore, **13**

VI. Plami mësimor, **13**

Gjuhë shqipe, **17**

Gjuhë angleze, **35**

Matematikë, **61**

Fizikë, **87**

Biologji, **103**

Kimi, **131**

Gjeografi, **147**

Histori, **173**

Edukatë qytetare, **193**

Teknologji, **217**

Art figurativ, **235**

Edukatë muzikore, **245**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

I. HYRJE

Arsimi përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore, sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare MASHT-ti synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe i programit lëndor mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashikimi i rezultateve të të nxënimit, mjetet mësimore, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe të programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planeve dhe të programeve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjate të MASHT-it, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënimit, inkurajimit të nxënësve të angazhohen në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtë-

sive në jetën e përditshme, gjithmonë duke pasur parasysh karakteristikat e zhvillimit fizik dhe psikologjik në këtë moshë.

Realizimi i qëllimit të këtij Plani dhe programi do të varet nga puna e përkushtuar e mësimitdhënësve, të cilëve u kushtohet ky plan dhe program. Për ta lehtësuar zbatimin e këtij plani dhe programi mësimor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë do të organizojë kohë pas kohe cikle ligjëratash me mësimitdhënës të udhëhequr nga ekspertë fushash përkatëse me një udhëzim shtojcë të këtij plani dhe programi.

II. QËLLIMET

Plani dhe programi mësimor për klasën e gjashtë dhe të shtatë për mësimin joformal ka për qëllim që nxënësve:

- T'u ofrojë mundësi dhe njohuri bazike për zhvillimin intelektual, estetik, fizik, shoqëror, moral dhe shpirtëror të nxënësve;
- T'u sigurojë orientim dhe t'u ndihmojë në realizimin e interesave të tyre personale për plotësimin e aspiratave përmes nxënies;
- T'u bëjë konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathhtësive në ndërtimin e të ardhmes së tyre;
- T'u mundësojë shfrytëzimin e burimeve të shumta për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj informacioneve dhe fakteve që u ofrohen;
- T'u mundësojë që në mënyrë të pavarur të marrin iniciativë dhe veprim të pavarur, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.
- Arsimimi i të gjithë qytetarëve të Kosovës edhe të atyre që përdonjë arsye e kanë ndërprerë shkollimin.

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshme dhe specifike për sendërtimin e qëllimeve të lartshënuara, nga të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim të klasës së gjashtë dhe të shtatë të mësimi joformal.

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat, moshën dhe me kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimitdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimitnxënies. Mësimitdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- stuhi mendimesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjen zbatim edhe ligjërata ndërvepruese e kombinuar me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses mësimi në natyrë, ekskursione të ndryshme studimore, vizitat institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

IV. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizës dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikullë nxënësi ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në rezultatet e pritura të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të së cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

IV. 1. Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetësi (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);

- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
 - me përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapuar të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimit e vlerëson të nevojshëm.

IV. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërin prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë, të cilat bazohen në:

| Objektivat e përgjithshëm | Arritje shumë e lartë 90% | Arritje e lartë 80% | Arritje e kënaqshme 60% | Arritje e kufizuar 40% | Arritje e pamjaftueshme |
|---|--|--|--|--|--|
| <i>Njohja e lëndës</i> | Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. | Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta. |
| <i>Të kuptuarit e proceseve shkencore</i> | Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të iformacioneve, të gjykuarit e thjeshtë. | Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore | Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore |
| <i>Të menduarit kritik</i> | Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme. | Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme. | Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme. | | |
| <i>Shkathtësitë manovruese</i> | Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathtësitë manovruese. | | | Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathtësitë manovruese. | |

V. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore, sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlasë, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kopjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është në kompetencën e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

VI. PLANI MËSIMOR

| Nr. | Lëndët mësimore | Numri i orëve | |
|-----|-----------------|---------------|-----------|
| | | Klasa VI | Klasa VII |
| 1 | Gjuhë shqipe | 90 | 90 |
| 2 | Gjuhë angleze | 54 | 54 |
| 3 | Matematikë | 72 | 72 |

| | | | |
|----|---------------------------------|-------------------|-------------------|
| 4 | Biologji | 36 | 36 |
| 5 | Kimi | | 36 |
| 6 | Fizikë | 36 | 36 |
| 7 | Histori | 36 | 36 |
| 8 | Gjeografi | 36 | 36 |
| 9 | Edukatë qytetare | 18 | 18 |
| 10 | Edukatë muzikore | 18 | 18 |
| 11 | Edukatë figurative | 18 | 18 |
| 12 | Teknologji me TIK | 18 | 18 |
| 13 | Edukatë fizike dhe sportive (*) | (36) | (36) |
| | Gjithsej: | 432 + (36) | 468 + (36) |

(*) Zgjedhjen e bën shkolla a të organizohet kjo lëndë mësimore apo jo, varësisht prej kërkesave të nxënësve.

GJUHË SHQIPE

Klasa VI

5 orë në javë 90 orë në vit (mësimi realizohet për 18 javë)

HYRJE

Nëpërmjet lëndës së gjuhës amtare nxënësit aftëson të lexojnë tekste të ndryshme, të shprehen drejt dhe qartas me gojë dhe me shkrim në situata të ndryshme, pasurojnë fjalorin, fitojnë shprehje për përdorimin e drejtë të gjuhës, mësojnë si të hartojnë tregime, përshkrime, shpjegime, argumente, zhvillojnë imagjinatën dhe kreativitetin si dhe kultivojnë aftësitë e tyre për të gjykuar e vlerësuar. Nxënësit do të aftësohen të shprehin mendimet, qëndrimet, kërkesat dhe përvojat e tyre.

Në këtë nivel kërkesë themelore është aftësimi i nxënësve për zhvillimin e dijeve dhe të shkathtësive të komunikimit si dhe përdorimi i drejtë i gjuhës në situata përkatëse. Gjithashtu synohet formimi i mëtejme kulturor e gjuhësor, përvetësimi i dijeve dhe formimi i personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit. Në këtë nivel nxënësit do të zhvillojnë kulturën e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturën e të lexuarit dhe kulturën e të shkruarit, do të bëjnë analiza dhe përgjithësime të teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare dhe do të fitojnë njohuri gjuhësore të mjaftueshme për moshën e tyre.

QËLLIMET

Qëllimi i mësimi të gjuhës shqipe në klasën e gjashtë është:

- zhvillimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme;
- zhvillimi i kulturës gjuhësore dhe formimi kulturor;
- zhvillimi emocional, krijues dhe estetik përmes shkathtësive të komunikimit;

- zhvillimi i vetëbesimit dhe të menduarit e pavarur;
- zhvillimi i përdorimit të gjuhës letrare;
- përgatitja e nxënësit për të mësuar gjatë tërë jetës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të kuptojë:

- tekste të ndryshme letrare dhe joletrare;
- fjalët të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Të zbatojë:

- njohuritë e fituara gjuhësore: fonetike, gramatikore dhe leksikore;
- njohuritë e fituara për modelet e teksteve letrare dhe joletrare.

Të analizojë:

- fjali të thjeshta dhe të përbëra;
- tekste të ndryshme.

Të vlerësojë:

- tekste letrare dhe joletrare;
- situata praktike nga jeta e përditshme.

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:

- të mendojë në mënyrë kritike dhe të pavarur për atë që flet, lexon apo shkruan;
- të rrisë shkallën e zhvillimit emocional, krijues, estetik, moral dhe shoqëror;
- të fitojë shprehje për sjellje njerëzore në shoqëri.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

NËNKATEGORITË:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit;
- I. 2 Tekstet letrare dhe joletrare;
- I. 3 Njohuri gjuhësore.

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

NËNKATEGORITË:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit;
- II. 2 Tekstet letrare dhe joletrare;
- II. 3 Njohuri gjuhësore.

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

NËNKATEGORITË:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit;
- III. 2 Tekstet letrare dhe joletrare;
- III. 3 Njohuri gjuhësore.

Vërejtje: Përmbajtja e nënkategorive realizohet në funksion të të tri kategorive kryesore.

| | |
|-------------------------|---|
| I.1, I.2, I.3 | Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit, 25 |
| I.2, II.2, III.2 | Tekstet letrare dhe joletrare, 30 |
| I.3, II.3, III.3 | Njohuri gjuhësore, 35 |

| Nënkategoritë : I.1, II.1, III.1 | Përmbajtja | Rezultatet e pritura |
|--|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, • Kulture e të lexuari • Kulture e të shkruarit | <ul style="list-style-type: none"> • Tekste praktike: prezantime përshëndetje, urime, falënderime, ftesa, letra, kërkesa, lajmërimë, tregime, përshkrime, përshtypje, shqetësime, dëshira etj. • Biografi ,autobiografi ; • Informacione nga mediat (televizioni, radioja, shoqëria). | <p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkruan tekste të shkurtra praktike; • Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja; • pasuron kulturën e të shprehurit dhe të menduarit e pavarur; • përvetëson njohuritë themelore të gjuhës; • dallon biografi, autobiografi; • Komenton informacione të marra nga mediat. |
| Nënkategoritë: I.2, II.2, III.2 | Përmbajtja | Rezultatet e pritura |
| <ul style="list-style-type: none"> • Tekstet letrare dhe joletrare | <ul style="list-style-type: none"> • Poezi; • prozë; • tekst dramatik; • zhanret dhe kategoritë letrare: subjekti, kompozicioni, tema , komedia, tragjedia; • teksti figurshëm; • përshkrimi dhe analiza e pamjeve (ilustrimeve); • teksti edukativ,shëndetësor,të drejtat e njeriut; • Eseja dhe llojet e saj. | <p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon format tekstore; • Dallon zhanret dhe kategoritë letrare; • Dallon tekstet e figurshme nga tekstet jo të figurshme; • Dallon tekstet letrare dhe joletrare; • Kupton (analizon) tekste të ndryshme në bazë të ilustrimeve; • Shkruan ese kreative dhe përshkruese. |

| Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3 | Përmbajtja | Rezultatet e pritura |
|---|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri gjuhësore | <ul style="list-style-type: none"> • Emri (gjinia ,numri, trajta); • mbiemri (gjinia numri); • përemrat; • foljet e zgjedhimit të parë dhe të dytë në mënyrën dëftore, lidhore; • kohët themelore të foljes; • numërori (përcaktues i një emri); • Intonacioni; • shenjat e pikësimit; • fjalia foljore dhe jofoljore; • tipat kryesorë të fjalive; • kryefjala, kallëzuesori i kryefjalës; • kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë; • rrethanori (i vendit, i kohës, i shkakut) • ndajfolja (vendi, kohe, shkak); • parashtesat, prapashtesat, mbaresat; • sinonimet, antonimet; • regjistrat e gjuhës; • gjuha standarde dhe format dialektore. | <p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon gjininë, numrin dhe trajtat e emrit; • Dallon gjininë dhe numrin e mbiemrave; • përdor drejt llojet e përemrave; • dallon foljet nëpër zgjedhime në kohë dhe mënyrë; • Përdor drejt foljen nëpër kohët themelore; • Dallon numërorin si përcaktues të një emri; • Përdor drejt shenjat e pikësimit; • lexon me intonacionin e duhur; • përdor drejt fjalinë foljore dhe jofoljore; • identifikon tipat e fjalive; • identifikon kryefjalën dhe kallëzuesorin e kryefjalës; • dallon kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë; • dallon llojet e rrethanorëve dhe të ndajfoljes; • krijon fjalë të reja me parashtesa prapashtesa dhe mbaresa. • dallon fjalët me kuptim të njëjtë dhe të kundërt; • dallon regjistrat e gjuhës; • përshtat tekste të vjetra dialektore në gjuhën standarde |

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët, mirëpo lidhje të drejtpërdrejta vihen me historinë, gjeografinë, veçanërisht me historinë e kulturës, me edukatën qytetare, me artet etj. Disa tema nga këto lëndë do të ndikonin në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore, përmes gjuhës shqipe do të mund të zhvillohen edhe disa çështje ndërprogramore, p.sh., tema për shëndetësi, të drejtat e njeriut, çështjet gjinore, të jetojmë së bashku etj. Temat mund të zgjedhen nga mësimitdhënësi, varësisht prej rëndësisë dhe aktualitetit që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga rrethi).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodologjia e mësimitdhënies zë vend kryesor në realizimin e përmbajtjes programore. Gjatë realizimit të procesit mësimor, mësimitdhënësi duhet të ketë parasysh strategjitë më efektive, të cilat mundësojnë mësimin efektiv. Mësimitdhënësi duhet të jetë model për nxënësit në mënyrën e përdorimit të shkathtësive gjuhësore dhe vëmendja e tij duhet të përqendrohet në disa parime bazë.

- **Përqendrimi në komunikim** (shkathtësitë e komunikimit) e jo si deri më tash përqendrimi në strukturat gjuhësore. Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar e jo si deri më tash në gramatikën pa shkathtësi gjuhësore
- **Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënësit e tij.** Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Mësuesi duhet të bëjë përpjekje që ta njohë mirë karakterin e nxënësit, përparësitë dhe dobësitë e tij, ta verifikojë a është tip i hapur apo i mbyllur, frikacak apo guximtar, a merr vetë iniciativa apo duhet të nxitet nga mësuesi etj.

Roli i mësimitdhënësit është rol vendimtar që do të mund të ndihmonte në procesin e mësimitdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo do të varet nga planifikimi i orës mësimore: përdorimi i hapësirës në klasë, d.m.th mënyra e vendosjes së bankave si dhe aktivitetet që zhvillohen në klasë: mënyra e komunikimit, luajtja e roleve, puna në grupe etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi bëhet me qëllim të verifikimit se në ç'shikallë nxënësit i kanë zotëruar objektivat e përcaktuar, të identifikojmë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit, t'u mundësojmë nxënësve që t'i identifikojnë përparësitë dhe pengesat e tyre si dhe t'u ndihmojmë atyre në përmirësimin e pikave të dobëta.

Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç'shikallë kanë zotëruar ata fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathtësitë gjuhësore.
- Pengesat e nxënësve: vlerësohet shkalla e zotërimit të njohurive me qëllim të eliminimit të pengesave dhe të ndihmës së nxënësve për eliminimin e vështirësive.
- Integrimin e njohurive të fituara: vlerësohen aktivitetet apo projektet e ndryshme që nxënësit i realizojnë jashtë programit shkollor dhe integrimin e këtyre njohurive në situata brenda shkollës.

Gjatë procesit mësimor rëndësi të veçantë do të kenë mënyrat e ndryshme të vlerësimit, p.sh:

- Vlerësimi nga mësimdhënësi; vlerësimi i drejtpërdrejtë dhe i pandërprerë, përcjellja e vazhdueshme e rezultateve të nxënësve si dhe vlerësimi indirekt me anë të testeve.
- Vlerësimi nga nxënësi; gjatë punës në grupe ose gjatë përgjigjeve që japin, nxënësit mund ta plotësojnë njëri-tjetrin dhe njëkohësisht vlerësojnë mbi bazën e argumenteve.
- Vetëvlerësimi; vlerësimi i vetë nxënësit.

Theks të veçantë gjatë vlerësimit duhet t'i kushtojmë të shprehurit gojor në vazhdimësi, të shprehurit gojor përmes ndërveprimit dhe të shprehurit me shkrim p.sh.:

- të shprehurit gojor për ngjarje, tregime, shpjegime
- pyetjet dhe përgjigjet
- iniciativat

- mendimet e pavarura
- shqiptimin e fjalëve
- aktivitetet brenda punës në grup
- radhitja e fjalëve në fjali
- fjalori (leksiku)

LITERATURA

- Bahri Beci, Gjuha shqipe 6 Prishtinë, 2003.
- Rita Petro, Xhevat Syla, Leximi letrar 6, Prishtinë, 2004.
- Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
- Qendra për Arsimin e Kosovës (KEC), Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR, Prishtinë, 2003.
- Tekste të tjera alternative për realizimin e këtij programi.

GJUHË SHQIPE

Klasa VII

5 orë në javë 90 orë në vit (mësimi realizohet për 18 javë)

HYRJE

Nëpërmes lëndës së gjuhës amtare nxënësit pasurojnë fjalorin, fitojnë shprehje për përdorimin e drejtë të gjuhës, mësojnë si të hartojnë tregime, përshkrime, shpjegime, argumente, zhvillojnë imagjinatën dhe kreativitetin si dhe kultivojnë aftësitë e tyre për të gjykuar e vlerësuar. Gjithashtu, nxënësit do të aftësohen të shprehin mendimet, qëndrimet, kërkesat dhe përvojat e tyre.

Programi i klasës së shtatë është pjesë e programit të shkollës së mesme të ulët. Kërkesë themelore e gjuhës në këtë nivel është aftësimi i nxënësve për zhvillimin e dijeve dhe të shkathtësive të komunikimit si dhe përdorimi i drejtë i gjuhës në situata përkatëse. Gjithashtu, në këtë klasë, synohet formimi i mëtejshëm kulturor e gjuhësor, përvetësimi i dijeve dhe formimi i personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së shkathtësive të përdorimit të gjuhës amtare si dhe nivelit të përgjithshëm të formimit kulturor të nxënësit. Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë kulturën e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturën e të lexuarit dhe kulturën e të shkruarit, do të bëjnë analiza dhe përgjithësime të teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare dhe do të fitojnë njohuri gjuhësore të mjaftueshme për moshën e tyre.

QËLLIMET

Lënda e gjuhës shqipe, në klasën e shtatë, mësohet me qëllim që nxënësi:

- Të përvetësojë dhe të zgjerojë kulturën dhe mënyrën e përdorimit të shkathtësive të komunikimit;

- Të aftësohet për të bërë analiza dhe përgjithësime për tekste letrare dhe joletrare;
- Të thellojë dhe të zgjerojë njohuritë e sistemit gjuhësor.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të identifikojë

- Tekste të ndryshme;
- Elemente gjuhësore.

Të kuptojë

- Tekstet të ndryshme letrare dhe joletrare;
- Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Të zbatojë

- Njohuritë e fituara gjuhësore: fonetike, gramatikore dhe leksikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare.

Të analizojë

- Fjali të thjeshta dhe të përbëra;
- Tekste të ndryshme.

Të vlerësojë

- Tekste letrare dhe joletrare;
- Situata praktike nga jeta e përditshme.

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Të mendojë në mënyrë kritike dhe të pavarur për atë që flet, lexon apo shkruan;
- Të rrisë shkallën e zhvillimit emocional, krijues, estetik, moral dhe shoqëror;
- Të fitojë shprehje për sjellje njerëzore në shoqëri.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

NËNKATEGORITË:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekstet letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

NËNKATEGORITË:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekstet letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

NËNKATEGORITË:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekstet letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtja e nënkategorive realizohet në funksion të të tri kategorive kryesore

- | | |
|-------------------------|--|
| I.1, I.2, I.3 | Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit 25 orë |
| I.2, II.2, III.2 | Tekstet letrare dhe joletrare 30 orë |
| I.3, II.3, III.3 | Njohuri gjuhësore 35 orë |

| Nënkategoritë: I.1, II.1, III.1 | Përmbajtja | Rezultatet e pritshme |
|---|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, • Kulturë e të lexuarit • Kulturë e të shkruarit | <p>Dokumentet e para të shkrimit shqip; Subjekti (fabula) ideja kryesore, detaji; Argumentimi, paraqitja, përshkrimi, rrëfimi; Teknikat e të folurit – Modulimet e zërit : ritmi, shprehja, kontakti me sy, me gjeste; Format e ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu; Figurshmëria dhe jofigurshmëria; Ese kreative dhe analitike për tekste letrare dhe joletrare (argumentues, përshkrues, bindës).</p> | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kupton rëndësinë e dokumenteve të para të shkrimit shqip; - Kupton subjektin, idenë kryesore dhe detajin; - Njih teknikat e argumentimit; - Dallon tekstet e figurshme nga tekstet jo të figurshme; - Shkruan ese; - Shkruan sipas modeleve të ndryshme; |
| Nënkategoritë: I.2, II.2, III.2 | Përmbajtja | Rezultatet e pritshme |
| <ul style="list-style-type: none"> • Tekstet letrare dhe joletrare | <p>Teksti i figurshëm dhe jo i figurshëm; Teksti dhe konteksti; metafora, simboli, metonimia Tregimi i shkurtër; Llojet e poezisë lirike: (himni, ditirambi, odja, elegjia); Kulturë tradicionale (përralla, miti, figurat mitologjike, këngët e kreshnikëve, format e shkurtra); Përshkrimi dhe analiza e pamjeve (ilustrimeve); Gjuha letrare dhe gjuha e letërsisë; Eseja dhe llojet kryesore të saj;</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Dallon tekstet letrare dhe joletrare; - Dallon gjuhën e teksteve letrare dhe joletrare; - Komenton tekste të ndryshme letrare dhe joletrare; - Pasuron leksikun me fjalë dhe me shprehje të reja; - Njih kulturën tradicionale; - Analizon tekste të ndryshme; - Interpreton idetë dhe tiparet e veçanta të teksteve; |

| | | |
|--|---|---|
| | Romani : tema, subjekti, personazhi, kompozicioni, gjuha; Teksti joletrar: teksti gazetaresk informata, teksti edukativ, shëndetësor, reportazhi, intervista. | - Përshkruan dhe argumenton bindshëm. |
| Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3 | Përmbajtja | Rezultatet e pritshme |
| • Njohuri gjuhësore | Lakimi i emrit, i mbiemrit, i përemrave vetorë, dëftorë dhe lidhorë; Numërori; Mënyra dëftore dhe lidhore e foljes dhe kohët e tyre, zgjedhimi, diatezat; Ndajfolja (e mënyrës, e sasisë, Rrethanori: (i mënyrës, i sasisë, i qëllimit); Lidhëzat dhe llojet e tyre; Fjalitë e përbëra me bashkërenditje (shtuese, veçuese,); Fjalitë e përbëra me nënrenditje (vendore, mënyrore,); Nyjëtimi i drejtë, intonacioni, theksi, ritmi; Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj; Shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë; Përshtatja e teksteve të vjetra dhe dialektore në gjuhën standarde; Fjalëformimi: Fjala dhe përbërësit e saj, kompozitat; Fjalët me shumë kuptime Sinonimet, antonimet, homonimet – identifikimi dhe përdorimi i tyre në tekste të ndryshme | - Identifikon dhe përdor drejt fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjeratës; - Shpreh qartë idetë dhe mendimet, duke respektuar rregullat gramatikore; - Përdor drejt foljet në mënyrën dëftore dhe lidhore; - Njih dhe përdor diatezat veprorë dhe joveprorë; - Lexon me intonacionin e duhur - Shqipton drejt fjalët dhe kupton ndërtimin e tyre; - Bën analiza gramatikore; - Dallon gjuhën standarde nga format dialektore; - Përdor fjalorë të ndryshëm për të mësuar fjalë të panjohura; - Zbaton rregullat e drejtshkrimit; - Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja; |

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Mirëpo, lidhje të drejtpërdrejta vihen me historinë, me gjeografinë, me edukatën qytetare, me artet etj. Disa tema nga këto lëndë ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore, përmes gjuhës shqipe mund të zhvillohen edhe disa çështje ndërprogramore si p.sh., tema për shëndetësi, për të drejtat e njeriut, për çështjet gjinore, etj. Temat mund të zgjedhen nga mësimdhënësi, varësisht nga rëndësia dhe aktualitetit që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga rrethi dhe mjedisi i tyre).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodologjia e mësimdhënies zë vend kryesor në realizimin e përmbajtjes programore. Gjatë realizimit të procesit mësimor, mësimdhënësi duhet të ketë parasysh strategjitë më efektive, të cilat mundësojnë mësimin efektiv. Mësimdhënësi duhet të jetë model për nxënësit në mënyrën e përdorimit të shkathtësive gjuhësore. Vëmendja e tij duhet të përqendrohet në disa parime bazë

- **Përqendrimi në komunikimin** (shkathtësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit). E tërë përmbajtja është në funksion të zhvillimit të këtyre shkathtësive;
- **Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;**
- **Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij.** Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Mësuesi duhet të bëjë përpjekje të njohë mirë karakterin e nxënësit, përparësitë dhe dobësitë e tij, ta verifikojë a është tip i hapur apo i mbyllur, i ndrojtur apo i zgjuar, a merr vet nisëtiava apo duhet të nxitet nga mësuesi etj.

Roli i mësimdhënësit është vendimtar, i cili ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Kjo varet nga planifikimi i orës mësimore: përdorimi i hapësirës në klasë, d.m.th., mënyra e vendosjes së bankave si dhe aktiviteteteve që zhvillohen në klasë: mënyra e komunikimit, luajtja e roleve, puna në grupe, në çifte si dhe përdorimi i teknikave të reja të mësimdhënies.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç'shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- Shkallën e zotërimit të njohurive me qëllim eliminimi të pengesave dhe të vështirësive në nxënie;
- Integrimin e njohurive të fituara që nxënësit i realizojnë edhe jashtë programit shkollor.

Theks të veçantë gjatë vlerësimit duhet kushtuar:

- përdorimit të fjalorit
- pyetjeve dhe përgjigjeve
- nisëativave dhe mendimeve të pavarura
- përshkrimeve dhe shpjegimeve
- radhitjes së fjalëve në fjali
- aktiviteteve individuale dhe grupore
- fjalorit (leksiku)

LITERATURA

- Tekstet që do të hartohen mbi bazë të programit të ri
- Tekstet ekzistuese që i plotësojnë kërkesat e këtij programi
- Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR, Prishtinë 2003
- Tekste të tjera alternative për realizimin e këtij programi

ENGLISH LANGUAGE CURRICULUM

Grade VI

2 hours per week, 55 in total

INTRODUCTION

Learning is a complex process of discovery, collaboration, and inquiry facilitated by language. Composed of interrelated and rule governed symbol systems, language is a social and uniquely human way of representing, exploring, and communicating meaning. Language is an essential tool for forming interpersonal relationship, understanding social situations, extending experiences, and reflecting on thought and action. Language is the principal instrument of thought and the primary basis of all communication.

PHILOSOPHY

The program of English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Learners' background knowledge, skills and attitudes will be used as means of developing communicating abilities. As the learners develop communication skills, they also increase their linguistic accuracy and develop language learning strategies. In the English language program learners will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

- 1.** interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).
- 2.** Sounds, written symbols, vocabulary, structure and discourse (language).
- 3.** Cognitive, socio-cognitive and meta-cognitive process (general language education).

4. Patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artefacts and symbols (culture).

THE AIMS

- Students will reinforce their language knowledge and language skill, gained at the previous level, and will broaden them gradually, aiming at increasing language awareness and broadening their communicative ability.
- They will deepen their understanding of their own culture and other cultures, where English is spoken as a first, second, or an international language.

The Scope of Grade Six English Language Curriculum

| COMMUNICATION | | |
|--|--|---|
| Learners' should give the opportunity to develop their language skills and gain self confidence in communication; | | |
| Listening | | |
| Specific objectives | Language activities | Attainment targets |
| <p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Use active listening in familiar situations; • Try to understand basic structure expressions and vocabulary. • Listen carefully and show some understanding of what they see and hear; | <ul style="list-style-type: none"> • Role play; • Group work; • Listening; • Fill in charts | <p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Recognize familiar words concerning themselves, their families and relationship between people; • Understand and use forms of greetings and leave-takings; • Understand and follow simple instructions; • |
| Speaking | | |
| Specific objectives: | Suggested language activities | Attainment targets |
| <p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Try to use English for basic communication; • Give directions and instructions; • Describe shortly people, objects and places; • Try to participate in short discussions based on classroom, and school themes. • Express feelings and wishes; | <ul style="list-style-type: none"> • Role play; • Dialogues; • Matching activities; • Fill in charts | <p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Introduce themselves, their family and their friends; • Exchange personal feelings and wishes in English; • Demonstrate awareness of formal and informal greeting, leave-takings and expressions of politeness. • Follow and give directions and instructions; |

| Reading | | |
|---|--|---|
| Specific objectives: | Suggested language activities | Attainment targets |
| <p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Read simple written English; • Understand the description of feelings and wishes; • Begin to show some fluency in oral reading; • Read simple notices, signs; | <ul style="list-style-type: none"> • Matching activities; • Reading rhymes, • Short stories; • Fairy tales. | <p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Understand simple written messages; • Understand information within known areas such as personal information; • Understand simple notices, signs and information, for example at the airport, bus (railway) station. • Understand simple instructions about health, shopping and simple directions to places. |
| Writing | | |
| Specific objectives: | Suggested language activities | Attainment targets |
| <p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Use simple sentence structures to express feelings and wishes; • Begin to use simple forms of writing (eg. notes, dialogues); • Exchange written information with peers; • Describe people, objects and places; • Exchange information using time and date; | <ul style="list-style-type: none"> • Matching activities; • Jigsaw sentences; • Dictation; • Filling in forms; | <p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Write short, simple informal notes or messages about themselves, families and school activities; • Complete simple forms related to personal information; • Write letters on a limited range on topics related to personal experiences and express |

| | | |
|--|--|---|
| | | opinions; • Copy blackboard notes and texts ; |
| UNDERSTANDING AND USING ENGLISH Learners should be given the opportunity to understand and use the sound system of English and the vocabulary related to familiar topics; | | |
| Specific Objectives | Suggested language activities | Attainment targets |
| Learners should be able to: <ul style="list-style-type: none"> • Begin to understand and recognize sound / spelling system; • Begin to understand some rules of pronunciation; • Begin to use spelling, capitalisation and punctuation with some accuracy; • Spell familiar words correctly; • Try to understand and use new vocabulary items; | <ul style="list-style-type: none"> • Spelling exercises; • Rhymes and songs; • Scrabble words; • Alphabet games. | Learners can: <ul style="list-style-type: none"> • Pronounce the most frequently used words correctly; • Recognise the letters and symbols; • Use punctuation marks correctly in their writing; • Understand frequently used classroom vocabulary; |
| ENGLISH IN THE WORLD Enable learners to make connections within and between learning areas and use English for real-life purposes . | | |
| Specific objectives | Suggested language activities | Attainment targets |
| Learners should be able to: <ul style="list-style-type: none"> • Demonstrate, and transfer skills of mother tongue to the first language; | <ul style="list-style-type: none"> • Listening different materials; | Learners can: <ul style="list-style-type: none"> • Take part in conversations about sports, music, fashion; |

| | | |
|--|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Begin to relate information about climate, geography, art etc. of countries; | <ul style="list-style-type: none"> • Role play; | <ul style="list-style-type: none"> • Try to use words associated with specific occasions (greetings, celebrations); • Show some understanding of messages found on pictures, signs, posters. • Try to express some knowledge of music, art and sport; • Identify food on a menu; |
| <p>English in the World Increase learners' awareness of cultural similarities and differences in order to develop respect and tolerance</p> | | |
| <p>Specific objectives</p> | <p>Suggested language activities</p> | <p>Attainment targets</p> |
| <p>Learners should be able to :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Begin to understand information related to culture, manifestations and holidays; • Respect other cultures; • Understand appropriate behaviour/norms; • Understand cultural events, celebrations and national and religious holidays; | <ul style="list-style-type: none"> • Clothes; • Holidays; • Family relations; • Describe pictures. | <p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Compare simple patterns of behaviour; • List activities that take place in your daily life; • Identify food on a menu |

Grade Six Topical Content

- 1. Personal identification**
 - Introducing people
 - Describing people
 - Personal information (feelings, emotions, likes and dislikes)
- 2. House and environment**
 - Types of accommodation
 - Furniture
 - Garden and school yard
- 3. Travel**
 - Public and private transport
 - Traffic
 - Holidays
- 4. Health and body care**
 - Parts of the body
 - Hygiene
 - Medical services
- 5. Shopping**
 - Shopping facilities
 - Shopping for food and clothes
 - Household articles
- 6. Weather**
 - Climate
 - Weather forecast
 - Seasons

Note to the teachers: In order to achieve the targeted aims and objectives of **Grade six Curriculum**, and cover the topical content of **Grade seven syllabus**, teachers should select teaching materials from course-book(s) and other sources of **elementary level**. These materials should primarily be age-appropriate, which means that they should be dedicated to young teenagers.

On the other hand, teachers should use supplementary materials according to the time available and dedicated to the English language within the school curriculum, in order to suit their learners' needs and to meet the attainment requirements.

Although it is estimated that within a school year, approximately 6 content areas should be covered, it is the teachers' responsibility to plan the number of topical areas (units) and the composition of it, in accordance with the total amount of hours dedicated to English.

METHODOLOGY

The Communicative Approach and Task – Based Learning

The overall aim of the English Language Curriculum is to enable learners to communicate successfully. Successful communication means

getting our message across to others effectively. The communicative approach to language learning aims at facilitating genuine interaction with others, regardless whether they live in the neighbourhood, in a distant place, or on another continent.

In language learning, the attention of the learners may be focused on particular segments, or on the language as a whole. In cases when we want to focus learners' attention on particular segments, then a segment may be a grammatical structure (a tense), a language function (expressing gratitude), a vocabulary area (food and drinks), or a phonological feature (stress or particular sounds).

On the other hand, when attention is focused on the language as a whole, learners, through a wide range of language activities, use the language for practical and realistic purposes. In other words, they act as genuine users of the language. Participating actively in communicative language activities, they in fact play roles, simulate situations related to real life, and learn through personalisation. In the earlier stages of learning, learners should be allowed to use gestures, body language, facial expressions, mime, drawings and so on. When they learn by doing, they realise that language is a powerful means of communication and will use it as such.

Since communication basically means sending and receiving messages, learners should develop the four language skills, which are the core of communication. Development of *receptive skills*, that is of *listening* and *reading* skills, will enable learners to receive messages and, depending on tasks they are expected to fulfil, select essential information. However, since language skills do not occur in isolation, but are normally integrated for communicative purposes, after having received a message, learners should be able to make decisions, and respond appropriately. In a situation which involves language, their response is a communicative function, which is performed by one of the *productive skills* either by *speaking* or by *writing*.

The Learning - Centred Classroom

The objective of learning centred teaching is to make teachers aware of the importance of learner autonomy in the classroom. The teacher is required to do more preparation before the lesson, and less stand up teaching in the classroom. But it doesn't mean that the teacher should sit back and relax. The teacher has a role, to support and help learners. The learners learn more actively and with enjoyment. The environment

requires a learning centred approach that relies on participant's share in the learning, and responsibility for furthering discussion. In all cases learners need clear guidelines and preparation for effective discussion participation.

The major aims, or set of aims will relate to the development of learning skills. Such aims may include the following:

- To provide learners with efficient learning strategies;
- To assist learners identify their own preferred ways of learning;
- To develop skills to negotiate the curriculum;
- To encourage learners to adopt realistic goals and a timetable to achieve these goals;
- To develop learners' skills in self-evaluation.

The Use of the Mother Tongue in the Classroom

Contrary to the principles of the direct method and natural approach in language learning, which favour exclusive use of the target language, excluding the mother tongue completely from the classroom, most recent approaches today suggest that the use of the mother tongue at particular stages of foreign language learning may prove useful.

While there is clearly a place for the mother tongue in the classroom, teachers should make efforts to keep the use of the mother tongue to a minimum. Instead of translating words and/or asking learners to translate, they should demonstrate, act, use simple drawings and/or pictures, explain, and give simple definitions. If teachers readily intervene with translation, as soon as learners are provided with an 'equivalent' word or expression, as soon as their curiosity is satisfied, they may lose interest in that particular item. In consequence, the English word or expression is easily forgotten and cannot be easily recalled. This method is easiest for teacher and learner, but may be the least memorable.

The Role of Grammar

If we see language as a building, the words as building blocks or bricks, and grammar as the architect's plan, than we must admit that without a plan, even a million bricks do not make a building. Similarly,

one may know a million English words, but if s/he does not know how to put them together, s/he cannot speak English (Sesnan, 1997).

In the light of this statement, the question is not whether to teach grammar or not, but *how* to teach it. We should consider which approach to adopt in teaching grammar, whether to teach form before meaning, or meaning before form, and what strategies and techniques to use in order to enable learners to put their knowledge of grammar into use and communicate effectively. It is the teacher's responsibility to estimate which approach would yield best effects at a particular stage of learning, or with a particular class.

| I.1. NUMRAT | I.1.1. Numrat me shenjë. Drejtëza numerike; I.2.11. Numrat dhjetorë (kuptimi, krahasimi, rrumbullakësimi, mbledhja dhe zbritja) I.1.2. Numrat e plotë. Vlera absolute; I.1.3. Rrënja katrore e numrit natyror; I.1.4. Përdorimi i kalkulatorit për gjetjen e rrënjës katrore; I.1.5. Krahasimi i numrave të plotë; I.1.6. Mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave të plotë | Nxënësi do të jetë në gjendje të: - njehsojë rrënjën katrore të numrave (dri në 1000) me tentativë dhe duke e përdorur kalkulatorin; - paraqesë numrat e plotë në boshtin numerik; - krahasojë numrat e plotë; - kryejë veprimet themelore me numra të plotë; - kryejë veprimet themelore me numra racionalë; - zbatojë radhën e veprimeve aritmetike në shprehje numerike; - zgjidhë probleme të thjeshta nga jeta e përditshme | Gjeometri, fizikë, kimi, gjeografi, kulturë fizike etj. |
| I.2. PËRQINDJA | I.2.1. Kuptimi i përqindjes; I.2.2. Gjetja e përqindjes së një numri; I.2.3. Zbatimi i përqindjes në zgjidhjen e problemeve. | Nxënësi do të jetë në gjendje të: - njehsojë përqindjen duke përdorur edhe kalkulatorin; - zbatojë përqindjen në zgjidhje të problemeve të thjeshta nga jeta e përditshme. | Gjeografi, kimi, biologji etj. |
| I.3. FUQIA | I.3.1. Kuptimi i fuqisë. Fuqia me tregues numër natyror; I.3.2. Vlerat e fuqisë; | Nxënësi do të jetë në gjendje: - të lexojë dhe të shkruajë fuqitë me eksponent numër | Gjeometri, fizikë, kimi etj. |

| | | | |
|--|---|---|---|
| | | <p>naturor;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njehsojë vlerën e fuqisë me eksponent numër naturor; - të përdorë kalkulatorin për gjetjen e fuqisë | |
| I.4. SHPREHJET ME SHKRONJA (NDRYSHORE) | <p>I.4.1. Shprehjet që përmbajnë shkronja;</p> <p>I.4.2. Njehsimi i vlerës së shprehjes për vlera të caktuara të shkronjave;</p> <p>I.4.3. Veprimet elementare me shprehje shkronjore (mbledhja dhe zbritja);</p> <p>I.4.4. Ekuacionet lineare me një të panjohur;</p> <p>I.4.5. Inekuacionet lineare me një të panjohur;</p> | <p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - modelojë marrëdhëniet numerike, duke përdorur shkronjat; - bëjë përkthime të thjeshta nga shkrimi i zakonshëm në shkrim me simbole matematike; - zbatojë radhën e veprimeve aritmetike dhe kllapave në shprehjet me shkronja; - zgjidhë ekuacionet dhe inekuacione lineare të thjeshta me një të panjohur; - zbatojë ekuacionet për zgjidhjen e problemeve | Fizikë dhe kimi |
| I.5. FUNKSIONI | <p>I.5.1. Funkzioni si rregull e lidhjes së dy bashkësive</p> <p>I.5.2. Paraqitja e pikave të funksionit në rrjetin e koordinatave (katër kuadrante)</p> | <p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - caktojë vlerën e funksionit $y = f(x)$ për vlera të ndryshme të argumentit x; - paraqesë pikat e funksionit me anë tabelës, dyshës së renditur dhe në rrjetin e koordinatave; - ndërtojë grafikun e funksionit, duke bashkuar pikat. | Fizikë , biologji, kulturë fizike |

II. GJEOMETRIA DHE MATJET

Përfytyrimi hapësinor është një vetëdije intuitive për mjedisin që na rrethon dhe për objektet në të. Gjeometria na ndihmon t'i paraqesim dhe t'i përshkruajmë, në mënyrë sistematike, objektet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre në hapësirë. Të kuptuarit e marrëdhënieve hapësinore dhe

zotësia për të shfrytëzuar konceptet dhe gjuhën e gjeometrisë ndikon në përmirësimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve për numrat dhe matjet.

Karakteristikat e figurave dydimensionale dhe atyre tredimensionale si dhe marrëdhëniet e lidhjet mes tyre janë aspekte të rëndësishme për të kuptuarit intuitiv e logjik të hapësirës në përgjithësi. Nxënësit duhet të imagjinojnë, vizatojnë dhe të krahasojnë figurat në pozita të ndryshme. Ata duhet të analizojnë dhe të mësojnë gjuhën formale të gjeometrisë për të paraqitur dhe argumentuar pikëpamjet e tyre.

Konceptet e aftësitë për matje janë të lidhura drejtpërdrejt me botën reale. Përvoja konkrete dhe shfrytëzimi i veglave dhe i formulave janë bazë për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e shkathtësive të nxënësve.

| Nënkategoritë | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritshme | Lidhja ndërlëndore |
|----------------------------------|---|--|---|
| II.1. KËNDET | II.1.1.Këndet suplementare dhe komplementare II.1.2. Konstruktimi i këndeve 60° , 30° , 15° , 90° , 45° , 120° etj. | Nxënësi do të jetë në gjendje: - të gjejë këndin suplementar (komplementar) të këndit të dhënë, me njehsim dhe konstruktim - të konstruktojë këndet 60° , 30° , 15° , 90° , 45° dhe 120° , duke shfrytëzuar metoda të ndryshme (p.sh, fletët palosëse, vizoren, kompasin dhe këndmatësin etj.) | Fizikë, arsim teknik, kulturë fizike etj. |
| II. 2. FIGURAT GJEOMETRIKE | II.2.1. Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe II.2.2. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes trekëndëshe II.2.3. Shuma e këndeve të trekëndëshit II.2.4. Klasifikimi i trekëndëshave sipas brinjëve dhe | Nxënësi do të jetë në gjendje: - të konstruktojë figurat dydimensionale me madhësi të caktuara të këndeve dhe brinjëve, duke shfrytëzuar metoda të ndryshme; - të përdorë saktë gjuhën matematike për të përshkruar konceptet gjeometrike (perimetër, syprinë, deltoid etj.); | Fizikë, arsimim teknik etj. |

| | | | |
|---------------|---|---|-------------|
| | <p>këndeve</p> <p>II.2.5. Teorema e Pitagorës – kuptimi</p> <p>II.2.6. Rrethi i brendashkruar dhe jashtëshkruari i trekëndëshit</p> <p>II.2.7. Shumëkëndëshat dhe sipërfaqja shumëkëndëshe</p> <p>II.2.8. Shumëkëndëshat e rregullt.</p> <p>Konstruktimi</p> <p>II.2.9. Shuma e këndeve të shumëkëndëshit</p> <p>II.2.10. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes shumëkëndëshe (paralelegrami, trapezi, deltoidi)</p> | <ul style="list-style-type: none"> - të zbulojë marrëdhëniet e këndeve të brendshme të trekëndëshit (shuma e tyre është 180^0) me metoda të ndryshme (duke i renditur qoshet e letrës, duke përdorur këndmatësin); - të gjejë perimetrin e të gjitha figurave dydimensionale me formula dhe matje; - të njehsojë syprinën e sipërfaqes shumëkëndëshe (paralelegrami, trekëndëshi, trapezi, deltoidi), duke i shfrytëzuar formulat; - të zbërthejë figurat jo të rregullta në figura të thjeshta dydimensionale për të gjetur perimetrin dhe syprinën e tyre; - të zgjedhë njësitë standarde për matje dhe t'i përdorë drejt ato; - të hulumtojë dhe të raportojë për shfrytëzimin e instrumenteve matëse në projekte të ndryshme, në shtëpi, vendpunime dhe komunitet. | |
| II. 3. RRETHI | <p>II.3.1. Rrethi-kuptimi dhe elementet e tij</p> <p>II.3.2. Perimetri dhe syprina e sipërfaqes rrethore-numri π</p> | <p>Nxënësi do të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë rrezen nga diametri dhe të bëjë matjet e tyre duke përdorur mjete konkrete; - të vlerësojë se (π) është numër konstant dhe se vlera e saj është përafërsisht 3.14; - të përdorë formulat për njehsimin e perimetrit dhe të syprinës së sipërfaqes rrethore në detyra praktike. | Fizikë etj. |

| | | | |
|--|---|---|-----------------------------------|
| II.4. TRUPAT GJEOMETRIKË - PRIZMI DHE PIRAMIDA | II.4.1. Kubi dhe kuboidi II.4.2. Prizmi II.4.3. Piramida | Nxënësi do të jetë në gjendje: - të skicojë objektet tridimensionale nga modelet dhe vizatimet ; - të modelojë figurat dy dhe tridimensionale; - të identifikojë figurat dydimensionale në rrjetin e prizmit dhe të piramidës; - të hetojë formulat për gjetjen e sipërfaqes së prizmit dhe të piramidës, duke shfrytëzuar rrjetet përkatëse. | Fizikë, arsimim teknik etj. |
|--|---|---|-----------------------------------|

III. STATISTIKA DHE PROBABILITETI

Sistemi i grumbullimit, paraqitjes tabelare dhe grafike i të dhënave, përdorimi i metodologjisë dhe i mjeteve bashkëkohore në hulumtimin dhe grumbullimin e informatave për dukuritë shoqërore, ekonomike dhe natyrore është objekt studimi i statistikës.

| Nënkategoritë | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritshme | Lidhja ndërlëndore |
|--|--|--|---|
| III.1. NJOHURI NGA STATISTIKA | III.1.1. Paraqitja e të dhënave statistikore III.1.2. Ndërtimi i diagrameve III.1.3. Vlerat mesatare III.1.4. Moda dhe mediana. | Nxënësi duhet të jetë në gjendje të: - grumbullojë të dhënat statistikore dhe t'i paraqesë grafikisht ato; - gjejë mesataren aritmetike, modën dhe medianën. | Projekte të ndryshme hulumtuese nga: kultura fizike, biologjia, ed. qytetare, gjeografia. |

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësi duhet të veçojë konceptet dhe shkathtësitë e domosdoshme që duhet t'i mësojë nxënësi me qëllim të arritjes së rezultateve të të nxënës që parashikohen në objektiva.

Praktikat mësimore kanë treguar se jo të gjithë nxënësit mësojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë dhe me ritëm të njëjtë. Për këtë arsye, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme dhe t'u përshtaten nevojave dhe interesit të nxënësve. Ato duhet të nxisin bashkëpunimin mes nxënësve me qëllim të përfundimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënës.

Shpjegimi është një prej metodave që në raste të veçanta është i domosdoshëm, por, megjithatë, mësimdhënësia ndërvepruese ka përparësi në nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve.

Mësimdhënësia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësive për ndërtimin e të kuptuarit të koncepteve, zgjerimin e njohurive, zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme.

Zgjidhja e problemeve është tipar i të menduarit, që në matematikë zë një vend të rëndësishëm. Ajo është pjesë e integruar në të gjitha kategoritë e përmbajtjeve mësimore. Në vitet e para të mësimin të matematikës nxënësit shfrytëzojnë teknika të thjeshta, kurse në klasën e shtatë mbi bazën e njohurive të fituara ata vlerësojnë cilësinë dhe rrjedhimet e metoda komplekse të zgjidhjes së problemeve.

Zgjidhja e problemeve është një proces "provues" që përmban fillime e mbarime, suksese e dështime, dhe verifikime e mospranime të disa përfundimeve. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të provojnë këtë proces në klasat e tyre dhe të bashkëpunojnë me nxënësit për kërkime të përgjigjeve. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit inkurajojnë nxënësit që të bëjnë të njëjtën gjë dhe u ndihmojnë atyre të fitojnë përvoja të reja e të vlerësojnë sukseset dhe dështimet e strategjive të ndryshme të zgjidhjes së problemeve. Veprimtaritë që organizohen në klasë gjatë zgjidhjes së problemeve duhet të gërshetojnë punën individuale, në çifte dhe në grupe me qëllim të rritjes së përgjegjësisë së nxënësit për të ndërtuar të kuptuarit.

Pyetjet dhe teknika e pyetjeve zë një vend parësor në planifikimin e mësimdhënies. Nëse dëshirojmë të nxisim të menduarit e nxënësve, si pjesëmarrës aktiv në procesin e të nxënës, është e domosdoshme të planifikohen pyetje të të gjitha niveleve. Kur të gjitha pyetjet janë të

nivelit riprodhues, atëherë ndodh pak ose aspak të menduarit. Pyetjet e nivelit të lartë, që zakonisht fillojnë me “Si...?”, “Pse...?” dhe “Çfarë...?”, janë pyetje nxitëse që kërkojnë nga nxënësi të mendojë dhe të reflektojë për atë që ka mësuar.

Komunikimi si një nga qëllimet më të rëndësishme të programit të matematikës u mundëson nxënësve të përdorin saktë gjuhën e matematikës. Është me rëndësi që gjatë procesit të të nxënit, nxënësit të dëgjojnë, të pyesin, të diskutojnë, të lexojnë dhe të shkruajnë. Shprehja e ideve matematike dhe diskutimi i tyre luan rol të rëndësishëm në të kuptuarit e koncepteve. Simbolet dhe diagramet e pasurojnë gjuhën e zakonshme të nxënësve, e zgjerojnë fjalorin shprehës dhe u mundësojnë atyre të komunikojnë në të gjitha fushat.

Lidhja ndërlëndore paraqet një aspekt të rëndësishëm në edukimin matematik. Përvojat që sjellin në klasa mësimdhënësit, u mundësojnë nxënësve të shohin se si konceptet dhe shkathtësitë nga një kategori e matematikës janë të lidhura me ato të kategorive të tjera. Në rastet e tilla, nxënësit ndihmohen të zotërojnë parimet e përgjithshme matematike. Po ashtu, lidhja e matematikës me lëndët e tjera dhe me situatat e jetës së përditshme, paraqet një tjetër fakt, që e bënë matematikën më shumë se një shkencë të izoluar.

Edukata fizike ofron raste të panumërta të matjeve si pjesë të natyrshme të aktiviteteve, për shembull kohëmatjet ose matjet e gjatësive gjatë kërcimeve. Krijimi i figurave simetrike dhe asimetrike në mësimet e gjimnastikës gjithashtu paraqesin shfrytëzimin real të koncepteve matematike. Gjuha matematike haset në të gjitha fushat, për shembull leximi i notave muzikore apo përshkrimi i figurave në aktivitetet e artit pamor. Kështu, lidhjet dhe zbatimi i njohurive matematike në fusha të ndryshme e rrit interesimin e nxënësve për mësimin e matematikës.

VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit është pjesë e integruar e mësimdhënies dhe e të nxënit. Përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjykohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësit, por edhe vlefshmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi. Mësimdhënësi duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësit dhe shqyrtimin e aftësive dhe shkathtësive të ndryshme të tyre. Në klasën e shtatë nxënësit pësojnë ndryshime të mëdha në arritjet matematike, ndryshime të shpejta në rritjen e tyre intelektuale dhe në zhvillimin emocional. Prandaj, gjatë

vlerësimi përcaktohet jo vetëm çfarë dinë nxënësi dhe çfarë mund të bëjnë ata, por edhe çfarë ndiejnë dhe çfarë besojnë ata. Këto informata i mundësojnë mësimitdhënësit të organizojë orët mësimore në mbështetje të nevojave dhe interesave të ndryshme të nxënësve. Të dhënat dhe mbledhja e informatave ndihmojnë gjithashtu në marrjen e vendimeve të vlefshme për motivimin dhe inkurajimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve.

Ndonëse aftësitë në llogaritje janë qenësore, vlerësimi duhet të përfshijë edhe verifikimin e aftësive të nxënësve për përdorimin e saktë të gjuhës e të simboleve matematike gjatë komunikimit matematik, si dhe vlerësimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve. Për këto arsye në orët e matematikës shfrytëzohen teknika të ndryshme vlerësimi si:

Vrojtimi dhe regjistrimet në klasë vlerësojnë shkathtësitë e manifestimit dhe sjelljet e ndryshme të nxënësve.

Detyrat kontrolluese shërbejnë për kontrollimin e përparimit të nxënësve dhe identifikimin e vështirësive në të mësuar.

Dosja dhe projektet paraqesin koleksione të punimeve të përzgjedhura të mbajtura në një folder, të cilat sigurojnë një model të punës së nxënësve, të kryerë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Vlerësimi i dosjes bëhet nga mësimitdhënësi, prindi dhe nga vetë nxënësi.

Rubrikat janë shumë efikase për klasifikimin e rezultateve të nxënësve.

Testimi është një procedurë që i shërben vlerësimi për qëllime të shumëfishta. Testet e ndërtuara nga mësimitdhënësi janë instrumentet më të përdorshme për vlerësimin e nxënësve. Llojet e ndryshme të testeve mundësojnë sigurimin e informacioneve për çdo nxënësi në përmbushje të rezultateve të pritshme dhe objektivave të lëndës së matematikës, identifikimin e vështirësive në të mësuar dhe tejkalimin e tyre dhe vlerësimin e gatishmërisë së nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Për shënimin e përparimit të nxënësve dhe vënien e notave, mësimitdhënësi mund të përdorë modele të ndryshme, që janë më të përshtatshme dhe që japin informacione të pasura. Këto shënime dhe informacione kanë rëndësi të madhe për të kontribuar në motivimin dhe përparimin e mëtejshëm dhe për të komunikuar me prindërit dhe të gjitha institucionet e interesuara.

FIZIKË

Klasa VI dhe klasa VII

HYRJE

Lënda e fizikës, që do të mësohet në klasën VI dhe VII, përfshin njësitë mësimore më të kondenzuara, por gjithnjë duke pasur parasysh aftësitë psiko-fizike të nxënësve. Nxënësit këtu do të fitojnë njohuri elementare për dukuritë dhe ligjet e fizikës. Nëpërmjet lëndës së fizikës nxënësit njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e dukurive të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathtësi jetësore e shprehi të punës.

Po ashtu, nxënësit marrin një bazë të mirë për njohjen e dukurive dhe të ligjeve, të cilat mësohen në lëndet e tjera si kimi, biologji etj.

Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat e tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut si dhe ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së fizikës ka për qëllim që nxënësi:

1. Të dallojë, identifikojë dhe të përshkruajë dukuritë fizike;
2. Të fitojë shprehi dhe shkathtësi për matje të madhësive të ndryshme fizike;
3. Të fitojë shprehi për punë demonstruese dhe eksperimentale;
4. Të zhvillojë shprehi pune në grupe dhe në ekipe;
5. Të krijojë qëndrim të drejtë në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të kursimit të energjisë dhe të shfrytëzimit racional të saj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nga përmbajtja programore e klasës VI dhe VII nxënësi do të jetë në gjendje:

1. Të përshkruajë dukuritë fizike, përbërjen e lëndës, vetitë karakteristike të lëndës, që i ndërlidhin ato dhe njësitë matëse të tyre.

- Të tregojë se lënda është e ndërtuar prej grimcave (*molekulave, atomeve, elektroneve, joneve* etj.) dhe se ka disa veti karakteristike të cilat lidhen me përbërjen dhe strukturën e saj.
- Të tregojë vetitë e vrojtuar të lëndës në modelet e thjeshta (p.sh. duke përdorur modelin e grimcave të sqarohet tretshmëria, difuzioni, përqëndrimi dhe dendësia e lëndës).
- Të tregojë se forcat mund të shkaktojnë ndryshime në trupa dhe në sisteme fizike, por, ashtu që vetitë e përgjithshme të lëndës dhe energjia mbetën të pandryshuara.
- Të përshkruajë se energjia paraqitet në lloje të ndryshme, e cila mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje të tjera.

2. Të shpjegojë se shumë dukuri fizike (*termike, periodike dhe elektrike*) mund të sqarohen duke u bazuar në ndërtimin grimcor të lëndës

- Të ilustrtojë dhe të sqarojë se gjendjet agregate, dukuritë sipërfaqësore dhe kapilare janë pasojë e veprimit të forcave molekulare.
- Të shpjegojë se energjia paraqitet në lloje të ndryshme, e cila mund të bartet dhe të shndërrohet në lloje të tjera.
- Të japë shembuj nga jeta e përditshme për lëvizjet periodike (lëkundjet dhe valët).
- Të paraqesë në mënyrë simbolike shprehjen e punës ($A = F \cdot s$), të fuqisë ($P = \frac{A}{t}$), të shtypjes ($p = \frac{F}{S}$), të ligjit të Ohmit ($U = I \cdot R$), të shpejtësisë së valëve ($c = \lambda f$), të energjisë së rrymës elektrike ($E = U \cdot I \cdot t$) etj., dhe t'i zbatojë këto shprehje për zgjidhjen e detyrave praktike.
- Të shpjegojë lidhjet kualitative dhe kuantitative, duke u shërbyer me vrojtimet dhe të dhënat për bartjen dhe shndërrimin e energjisë (p.sh., *varësia e shpejtësisë së trupave dhe e valëve nga dendësia e mjedisit ose varësia e shpejtësisë së trupave*

nga lartësia – niveli referent, vartësia e intensitetit të zërit nga gjatësia e telit të përforcuar në skajet e tij).

3. Të zbatojë njohuritë e fituara për të matur madhësitë e ndryshme fizike dhe zgjidhjen e detyrave praktike nga jeta e përditshme

- Të përdorë njësitë dhe veglat për matjen e forcës dhe të shtypjes (*dinamometrat, manometrat dhe barmometrat*); instrumentet për matjen e intensitetit, tensionit, rezistencës dhe fuqisë së rrymës si dhe ta ilustrojë degëzimin e rrymës në një qark elektrik.
- Të matë (*p.sh., kohën, masën, gjatësinë, forcën, punën dhe fuqinë*) dhe të llogaritë madhësitë fizike që karakterizojnë lëvizjet e trupave dhe bashkëveprimin e tyre brenda sistemit fizik (*p.sh., shpejtësinë, forcën, energjinë e lartësisë dhe të lëvizjes*).
- Të demonstrojë punën mekanike dhe fuqinë që zhvillon një forcë, prodhimin e zërit në shembuj praktikë etj.
- Të matë madhësitë që kanë të bëjnë me llojet e energjisë (*p.sh., temperaturën, masën, shpejtësinë, largësinë, sasinë e elektricitetit, intensitetin, tensionin dhe rezistencën elektrike*).

4. Të kombinojë njohuritë teorike, demonstrimet dhe matjet eksperimentale për të shpjeguar në mënyrë të drejtë dukuritë fizike

- Të vënë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, duke marrë parasysh ndriçimin molekular të lëndës.
- Të identifikojë dhe të klasifikojë faktorët që shkaktojnë ndryshime brenda një sistemi fizik (*p.sh., forca, shtypja dhe nxehtësia*).
- Të identifikojë dhe të parashikojë se çka do të ndërrohet dhe çka do të mbetet e pandryshuar kur lënda i nënshtrohet veprimit të forcave të jashtme ose ndërrimit të energjisë (*p.sh., krahasimi i forcave, i largësive dhe i punës të makinat e thjeshta*).

5. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Të kuptojë përparësitë dhe kufizimet që i ofron lënda.
- Në ndikimin e sjelljeve personale (*të jetë i ndershëm, tolerant, i hapur, të ketë vullnet, të jetë kooperativ, kritik, krenar etj.*).

**PËRMBAJTJET PROGRAMORE
KLASA VI**

| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | PËRMBAJTJET PROGRAMORE | REZULTATET E PRITSHME | LIDHJA NDËRLËNDORE |
|--|--|--|---|--|
| I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE | I.1. TRUPAT DHE VETITË E TYRE | <p>I.1.1.Lënda dhe trupat në natyrë</p> <p>1.Lënda dhe ndërtimi grimcor i saj 2.Gjendjet e lëndës: a) trupat e ngurtë dhe vetitë e tyre b) lëngjet, gazet dhe vetitë e tyre 3.Matja e trupave dhe gabimet në matje: a) matja e gjatësisë, b) matja e sipërfaqes, c) matja e vëllimit, d) matja e masës.</p> | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>1. Të njihet me nocionet, fjalorin dhe terminologjinë e fizikës. 2. Të mësojë se lënda është e ndërtuar prej grimcave të vogla-molekulave. 3. Të njihet me lëndën dhe gjendjet e saj si dhe të dallojë trupat e ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. 4. Të mësojë të matë disa madhësi fizike (gjatësinë sipërfaqen, vëllimin dhe masën e trupave). 5. Të tregojë se çdo matje përcillet me gabime dhe të dijë të njehsojë vlerën mesatare të gabimeve.</p> | <p>Koncepti i ndërtimit grimcor të lëndës (molekular dhe atomik i lëndës) përdoret me të madhe në sqarimin e shumë dukurive në kimi, biologji, mjekësi, astronomi etj.</p> |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| <p>I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</p> | <p>I.1. LËVIZJA E TRUPAVE NË NATYRË.</p> | <p>I.1.2. Forca dhe lëvizjet në natyrë 1. Lëvizja dhe qetësia. 2. Rruga dhe trajektorja. 3. Shpejtësia e lëvizjes . 4. Matja e kohës.</p> | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të dallojë lëvizjen e trupave nga qetësia 2. Të kuptojë se lëvizja e trupave përshkruhet me tri madhësi fizike: rrugën, shpejtësinë dhe kohën 3. Të dijë se trajektorja e lëvizjes së trupave mund të jetë vijë e drejtë ose e lakuar 4. Të dijë të matë kohën dhe t'i njohë njësitë e kohës.</p> | <p>Koncepti i lëvizjes, edhe pse mekanik i definuar në mënyrë të thjeshtë, është me rëndësi për shkencat biologjike dhe shkencat natyrore-teknike. Lidhja me biologjinë qëndron në faktin se edhe procesi i rritjes është proces i lëvizjes. Koncepti i forcës është i rëndësishëm dhe ka lidhje si për shkencat natyrore dhe ato teknike dhe në jetën e përditshme.</p> |
| <p>I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</p> | <p>I.1. VEPRIMI NDËRVEPRIMI NDËRMJET TRUPAVE - FORCA.</p> | <p>I.1.3. Forca dhe lëvizjet në natyrë 1. Forca deformon trupat. Matja e forcës me dinamometër. 2. Forca ndryshon shpejtësinë e trupave dhe drejtimin e lëvizjes. 3. Veprimi dhe kundërveprimi i forcave 4. Rënia e lirë.</p> | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të kuptojë se ekziston forca që njihet sipas veprimit të saj. 2. Të dijë të matë forcën me dinamometër. 3. Të dijë se forca e ndërron formën, shpejtësinë dhe drejtimin e lëvizjes së trupit.</p> | <p>Koncepti i forcës është i rëndësishëm dhe ka lidhje si për shkencat natyrore dhe ato teknike dhe në jetën e përditshme.</p> |

| | | | | |
|---|---|---|--|--|
| I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE | I.2. TRUPAT DHE VETITË E TYRE | I.2.4. Puna dhe energjia 1. Kur kryhet punë 2. Makinat e thjeshta (Ilozi, rrafshi i pjerrët, rrotullat) 3. Forcat e fërkimit 4. Si shndërrohet puna në nxehtësi 5. Fuqia e një force 6. Puna, nxehtësia dhe energjia 7. Burimet dhe llojet e energjisë 8. Shndërrimet e energjisë në lloje të ndryshme | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të kuptojë konceptin elementar për punën, energjinë dhe nxehtësinë si dhe lidhjen mes tyre 2. Të dijë të ndërtojë ndonjë makinë të thjeshtë dhe të demonstrojë se si punohet me to. 3. Të demonstrojë me shembuj të ndryshëm se kur kryhet punë mekanike 4. Të ilustrojë mënyrat e shndërrimit të energjisë në lloje të tjera. | Këto koncepte janë aq shumë të rëndësishme saqë i hasim në të gjitha shkencat natyrore dhe teknike si dhe kudo në jetën e përditshme. Pra, këto koncepte lidhen me shkencën e biologjisë, të kimisë si dhe ndikon në mjedisin jetësor të njeriut, të cilin duhet ta ruajmë. |
| II. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE | II.1. STRUKTURA MOLEKULARE KINETIKE E LËNDËS | II.1.5. Dukuritë e nxehtësisë 1. Burimet e nxehtësisë. 2. Temperatura e trupave. Matja e temperaturës së trupave (termometrat). 3. Bymimi dhe tkurrja e trupave të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. 4. Avullimi, vlimi dhe kondensimi i ujit. Puna e avullit të ujit dhe energjia e tij. 5. Përcjellja e nxehtësisë. | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të dallojë trupat e nxehtë dhe të ftohtë dhe të matë temperaturën e disa trupave me termometër 2. Të mësojë për burimet e nxehtësisë 3. Të mësojë se nxehtësia kalon prej trupit më të nxehtë në trupin më të ftohtë 4. Të kuptojë se kur ndryshimi i temperaturës është më i madh, atëherë edhe këmbimi i | Dukuritë termike ndikojnë në dukuritë meteorologjike duke kushtëzuar që disa pjesë të Tokës të bëhen më të nxehta ose më të ftohta. Kjo ka për pasojë dukurinë e erës dhe të të reshurave atmosferike. Po ashtu, dukuritë e nxehtësisë janë të lidhura me biologjinë, kiminë dhe me mbrojtjen e ambientit. Këto dukuri |

| | | | | |
|---|---|--|--|--|
| | | | <p>nxehtësisë është më i madh</p> <p>5. Të dijë se disa trupa e përcjellin më mirë nxehtësinë e disa të tjerë jo (izolatorët termikë)</p> | <p>lidhen edhe me bujqësinë, industrinë ushqimore etj.</p> |
| <p>III. DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS</p> | <p>III.1. VETITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS</p> | <p>III.1.6. Dukuritë elektrike dhe magnetike</p> <p>1. Elektrizimi i trupave. Matja e elektricitetit me elektroskop dhe elektrometër</p> <p>2. Tërheqja dhe refuzimi elektrik</p> <p>3. Burimet e rrymës elektrike (elementet galvanike, bateria, akumulatori, elementi i Voltës)</p> <p>4. Qarku elektrik.</p> <p>5. Veprimet e rrymës elektrike. Përdorimi i rrymës elektrike në pajisjet shtëpiake dhe mbrojtja nga rryma elektrike</p> <p>6. Elektriciteti në atmosferë. Rrufeja</p> <p>7. Energjia dhe fuqia e rrymës elektrike.</p> <p>8. Magnetet e përhershme</p> <p>a) Busolla dhe fusha magnetike e Tokës</p> | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>1. Të emërtojë mënyrat e elektrizimit të trupave (me fërkim, prekje dhe ndikim)</p> <p>2. Të dijë se ekzistojnë dy lloje të elektricitetit (pozitiv dhe negativ) si dhe tërheqjen dhe refuzimin e trupave të elektrizuara.</p> <p>3. Të kuptojë se sasia e elektricitetit matet me elektroskop dhe të ndërtojë elektroskopin dhe elektrometrin</p> <p>4. Të emërtojë burimet e rrymës (bateria, centrali elektrik etj.)</p> <p>5. Të dallojë përçuesit e mirë nga përçuesit e këqinj të rrymës.</p> <p>5. Të vizatojë dhe të ndërtojë qarkun elektrik sipas skemës së dhënë si dhe të identifikojë pjesët kryesore të tij.</p> <p>6. Të demonstrojë shndërrimin e energjisë elektrike në nxehtësi nëpërmjet rezistencës elektrike.</p> | <p>Këto njësi mësimore janë të lidhura me shkencat natyrore, teknike si dhe me jetën e përditshme aq shumë saqë sot nuk mund të mendohet jeta pa to.</p> |

KLASA VII

| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | PËRMBAJTJET PROGRAMORE | REZULTATET E PRITSHME | LIDHJA NDËRLËNDORE |
|--|--------------------------------------|---|--|---|
| I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE | I.1. TRUPAT DHE VETITË E TYRE | I.1.2. Gazet dhe lëngjet në qetësi <ol style="list-style-type: none"> 1. Forca e shtypjes. Shtypja 2. Shtypja atmosferike e ajrit. Matja e shtypjes 3. Përcjellja e shtypjes në lëngje dhe gaze 4. Shtypja hidrostatike 5. Enët komunikuese 6. Forca e shtytjes. Ligji i Arkimit 7. Shtypja e gazeve të mbyllura. Matja e shtypjes në enë të mbyllura 8. Dukuritë sipërfaqësore në lëngje (lagia dhe dukuria kapilare) | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojë forcën e shtypjes dhe ta identifikojë atë në disa shembuj që i jepen. 2. Të përshkruajë një eksperiment që demonstron varësinë e shtypjes nga sipërfaqja dhe forca pingule. 3. Të shpjegojë varësinë e shtypjes hidrostatike nga thellësia e trupit të zhytur dhe dendësia e lëngut 4. T'i përdorë veglat për matjen e shtypjes (barometrat dhe manometrat) dhe t'i lexojë drejt vlerat që tregojnë ato 5. Të dallojë kuptimin e zhytjes, notimit dhe hundimit në jetën e përditshme. | <p>Koncepti i shtypjes është me rëndësi të posaçme për teknikën, astronominë dhe në shkencat natyrore, si në biologji e kimi. Po ashtu është më rëndësi edhe në gjeologji dhe agronomi. Në biologji, me anën e shtypjes osmotike sqarohet si materiet ushqyese bashkë me ujin ngriten lart në bimë.</p> |

| | | | | |
|---|---|---|--|---|
| <p>I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</p> | <p>I.1. TRUPAT DHE VETITË E TYRE)</p> | <p>I.1.3. Puna dhe energjia</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Forca 2. Puna, nxehtësia dhe energjia 3. Fuqia. Motorët. | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojë konceptin elementar për punën, energjinë dhe nxehtësinë si dhe lidhjen mes tyre 2. Të demonstrojë me shembuj të ndryshëm, se kur kryhet punë mekanike 3. Të tregojë me shembuj konkretë lidhjen e punës me energjinë. | <p>Këto koncepte janë aq shumë të rëndësishme saqë i hasim në të gjitha shkencat natyrore dhe teknike si dhe kudo në jetën e përditshme. Pra, këto koncepte lidhen me shkencën e biologjisë, kimisë si dhe ndikon në mjedisin jetësor të njeriut, të cilin duhet ta ruajmë.</p> |
| <p>I. POZITA DHE LËVIZJA E TRUPAVE</p> | <p>I.2. DUKURITË PERIODIKE NË MJEDISE TË VAZHDUARA</p> | <p>I.2.4. Lëkundjet dhe valët. Zëri</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Valët dhe llojet e tyre. Disa veti kryesore të valëve 2. Përhapja dhe shpejtësia e valëve 3. Reflektimi dhe thyerja e valëve 4. Si formohet zëri. Burimet e zërit 5. Vetitë kryesore të zërit | <p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojë mënyrën e krijimit të lëkundjeve dhe valëve në mjedise lëndore, llojet e valëve si dhe karakteristikat e tyre (frekuencën, shpejtësinë, periodën dhe gjatësinë valore). 2. Të shpjegojë se valët mund të thyhen dhe të reflektohen. 3. Të shpjegojë se përhapja e zërit bëhet në formë të valëve | <p>Këto njësi mësimore lidhen me të gjitha shkencat natyrore dhe teknike e sidomos me informatikën dhe me jetën e përditshme. Komunikimi ndërmjet njerëzve dhe gjallesave të ndryshme vendoset pikërisht me anë të</p> |

| | | | | |
|---|--|--|---|--|
| | | | ngjashëm me valët në sipërfaqen e ujit. 4. Të shpjegojë se kur largohemi nga burimi, zëri fillon të dobësohet dhe anasjelltas. | valëve. Po ashtu, me anë të valëve bëhen edhe studimet tekniko-shkencore të materialeve që përdoren në ndërtimtari, industri dhe bujqësi. |
| II. LËVIZJA KAOTIKE DHE DUKURITË TERMIKE | II.1. STRUKTURA MOLEKULARE KINETIKE E LËNDËS | II.1.1. Ndërtimi i lëndës. 1. Ndërtimi grimcor i lëndës (molekulat dhe atomet) 2. Bashkëveprimi ndërmjet molekulave 3. Përqendrimi dhe dendësia e lëndës 4. Dukuria e difuzionit. | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të njihet me ndërtimin grimcor të lëndës (se lënda është e ndërtuar prej molekulave, atomeve dhe grimcave të tjera përbërëse). 2. Të përshkruajë një dukuri që tregon se molekulat lëvizin dhe se ndërmjet tyre ka hapësira të lira. 3. Të përshkruajë dukurinë e difuzionit si pasojë e lëvizjes së molekulave. | Koncepti i ndërtimit grimcor të lëndës (molekular dhe atomik i lëndës) përdoret me të madhe në sqarimin e shumë dukurive në kimi, biologji, mjekësi, astronomi etj. Po ashtu edhe koncepti i difuzionit aplikohet në mjekësi, kimi, biologji, bujqësi etj. |
| III. DUKURITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE | III.1. VETITË ELEKTRIKE DHE MAGNETIKE TË LËNDËS | III.1.5. Rryma elektrike. 1. Struktura elektrike e lëndës (struktura e atomit) 2. Rryma elektrike njëkahore | Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. Të vizatojë dhe të ndërtojë qarkun elektrik sipas skemës së | Këto njësi mësimore janë të lidhura me shkencat |

| | | | | |
|-------------------------|--|--|--|---|
| <p>TË LËNDËS</p> | | <p>3. Intensiteti i rrymës elektrike. Matja e intensitetit (Ampermetri) 4. Tensioni i rrymës elektrike. Matja e tensionit (Voltmetri) 5. Rezistenca e rrymës elektrike. Lidhja e resistorëve. 6. Ligji i Omit për një pjesë të qarkut elektrik. 7. Intensiteti i rrymës në qarkun e degëzuar (Rregullat e Kirkofit) 8. Puna dhe fuqia e rrymës elektrike.</p> | <p>dhënë si dhe të identifikojë pjesët kryesore të tij. 2. Të demonstrojë shndërrimin e energjisë elektrike në nxehtësi nëpërmjet rezistencës elektrike. 3. Të matë madhësitë elektrike me ndihmën e instrumenteve matëse (voltmetri, ampermetri, ommetri dhe vatmetri) si dhe të shprehë me gojë dhe me shkrim lidhjen ndërmjet tensionit, rezistencës dhe intensitetit të rrymës. ($U = I \cdot R$). 4. Të demonstrojë lidhjen serike dhe paralele të resistorëve në mënyrë skematike dhe praktike si dhe të përdorë formulën për energji të rrymës elektrike $E = Q = U \cdot I \cdot t$.</p> | <p>natyrore, teknike si dhe me jetën e përditshme aq shumë sa që sot nuk mund të mendohet jeta pa to.</p> |
|-------------------------|--|--|--|---|

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvoja ka treguar se realizimi i procesit të mësimdhënies me metoda të ndryshme është shumë më efektiv dhe i suksesshëm. Prandaj, edhe mësimi i fizikës duhet të bëhet duke i shfrytëzuar dhe kombinuar metodat e ndryshme të mësimit. Këtu do t'i numërojmë vetëm ato metoda të cilat më shpesh dhe më shumë përdoren, e këto janë:

- Metoda e të shprehurit me gojë
- Metoda e bashkëbisedimit (këtu hyn edhe metoda aktive e mësimdhënies).
- Metoda e demonstrimit
- Metoda e punës eksperimentale.

Përveç këtyre metodave, përdoren edhe metoda dhe teknika të tjera të mësimdhënies, p.sh., **metoda interaktive**, e cila është mjaft produktive me punën në grupe dhe ekupe të nxënësve. Arsimitari i fizikës duhet t'i përdorë të dy këto metoda, edhe atë **aktive** edhe atë **interaktive**.

Mirëpo, kombinimi i këtyre metodave mësimore është më i suksesshëm, sepse zgjon kureshtjen dhe nxit interesimin e nxënësve. Mandej, pason zbatimi konkret dhe praktikë i njohurive në zgjidhjen e detyrave, që të nxënësi krijon kujtesë të pashlyeshme.

VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike dhe të vazhdueshme, analizimit dhe interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit se në ç'shikallë nxënësi i ka zotëruar objektivat e përgjithshëm dhe specifike të lëndës së fizikës.

Qëllimi i vlerësimit tregon cakun përfundimtar të një lloji vlerësimi, rezultatit përfundimtar që shtrohet për t'u arritur me një metodë të caktuar të vlerësimit

Në mënyrë që arsimtarit t'i lehtësohet puna e tij me nxënësit, i sugjerohet të punojë me këto teknika dhe lloje të vlerësimit:

- **Vlerësimi sipas aktivitetit**

Arsimtari duhet ta pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyçë në bashkëbisedim gjatë procesit të mësimit, njëkohësisht do ta vlerësojë sa është në gjendje të përvetësojë njësine mësimore. Në këtë mënyrë, nxënësi do të jetë vazhdimisht aktiv në marrjen e përfundimeve për ligjshmërit që zotërojnë një dukuri fizike. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë, mund të arrijnë në përfundime të ndryshme.

- **Vlerësimi me gojë (intervista)**

Ka nxënës që janë mjaft të përgatitur, por janë të tërhequr, jo aq aktivë dhe nuk marrin pjesë në bashkëbisedim. Për këtë arsye arsimtari duhet këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i pyetë me gojë në mënyrë klasike, në mënyrë që arsimtari të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Edhe kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi me tërë nxënësit e klasës.

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste të pyetjeve, arsimtarit i ofron pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit, të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo njërin gjysmëvjetor përpilohet nga një test me qëllim që arsimtari të krijojë një përfytyrim për dituritë e përvetësuar.

- **Vlerësimi nga zgjidhja e detyrave në klasë dhe në shtëpi**

Në programin e fizikës për klasën VII janë paraparë zgjidhje detyrash, detyra për përsëritje dhe detyra kontrolli. Në këtë rast nxënësit duhet vazhdimisht të kyçen në zgjidhjen e këtyre detyrave në tabelë apo në fletore. Ky aktivitet i nxënësve duhet të merret si parametër për vlerësimin e diturisë.

- **Vlerësimi me anë të testeve**

Mënyra e vlerësimit të njohurive të nxënësve të tërë klasës me teste arsimtarit i ofron pasqyrë për nivelin e zotërimit të lëndës mësimore. Kjo metodë do të jetë aq më e saktë sa më tepër kohë që arsimtari do t'i

kushtojë mënyrës së drejtë të përpilimit të testeve, duke pasur parasysh kriteret e hartimit të testeve sipas taksonomisë së Blumit, të cilat janë: niveli i njohjes (kognitiv), kuptimi, zbatimi, analiza dhe sinteza. Në çdo gjysmëvjetor përpilohet nga një test vlerësues dhe nga një test i pëparimit dhe në fund të vitit një test përfundimtar (përmbledhës).

- **Vlerësimi sipas aktivitetit në laboratorin e shkollës**

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës arsimitari sipas programit do të demonstrojë ose do të kryejë ndonjë matje të ndonjë madhësie ose dukurie fizike. Pikërisht gjatë këtij angazhimi të arsimitarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktiv se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimitarit në procesin e demonstrimit apo të matjes apo do ta kryejnë në mënyrë të pavarur ashtu që ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre.

- **Vlerësimi i punës së pavarur praktike të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi**

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimitari detyra konkrete të cilat do t'i realizojnë në mënyrë praktike.

BIOLOGJI

Klasa VI

2 orë në javë, 36 orë në vit

HYRJE

Elementet e lëndës së biologjisë fillojnë të mësohen në kuadër të lëndës së integruar të shkencave të natyrës “Njeriu dhe natyra” në arsimin fillor, kurse si lëndë e veçantë fillon të mësohet në klasën VI të shkollës së mesme të ulët. Programi mësimor i lëndës së biologjisë për këtë klasë është vazhdimësi e programit mësimor të pjesës biologjike të lëndës “Njeriu dhe natyra”.

Përmes mëimit të biologjisë nxënësit marrin njohuri themelore për jetën, ndërtimin, funksionin, shumimin dhe zhvillimin e qenieve të gjalla. Detyrë e mëtejme e mëimit të biologjisë është: zhvillimi i aftësive vrotuese dhe të menduarit kritik që në të vërtetë është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht proces njohës, veprues dhe ndërveprues.

Baza e biologjisë qëndron në shpjegimin e marrëdhënieve të ndërtimit dhe funksionimit të organizmave si dhe të përshtatshmërisë ndaj kushteve të mjedisit.

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një ecurie të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, metodat dhe instrumentet e vlerësimit.

QËLLIMET

Mësimet teorike të gërshetohen me metodat e vrotimit të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në terren. Kjo u mundëson nxënësve që aktivisht të fitojnë njohuri dhe në saje të kërkimeve dhe zbulimeve të kuptojnë ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Nxënësit, nga informatat e shumta që marrin, zbulojnë thelbin e problemit, zbatojnë të menduarit kritik në radhitjen e të dhënave dhe informatave. Mësohen të analizojnë, lidhin dhe përgjithësojnë të dhënat. Kjo u mundëson nxënësve kuptimin më të thellë të temave si dhe ndërlidhjen e biologjisë me shkencat e tjera natyrore dhe shoqërore.

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën VI siguron mundësi për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e: aftësive për të njohur strukturën e qelizës, **shkathtësive** për të zbatuar parimet e biosistematikës, **njohurive** për laramaninë e madhe të llojeve – mikrogjallesave, bimëve jovaskulare dhe vaskulare, **qëndrimin përgjegjës** gjatë punës eksperimentuese në laborator dhe në natyrë, shkathtësive për të konsultuar literaturën adekuate, në të mbledhurit e informatave shkencore në mënyrë të pavarur dhe **klasifikimit të** materialit biologjik, **motivimit** për të manovruar me aparatet dhe instrumentet në laboratorin e biologjisë. Me një fjalë, të bëhen mendimtarë kritikë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

- të kuptojë ngjashmëritë dhe dallimet mes natyrës së gjallë dhe jo të gjallë;
- të njihet me pikëpamjet e disa filozofëve natyralistë për biologjinë;
- të njohë ndërtimin e qelizës, si njësi elementare e jetës;
- të njohë përdorimin e pajisjeve elementare në laboratorin e biologjisë;
- të kuptojë varshmërinë reciproke midis natyrës së gjallë dhe jo të gjallë;
- të kuptojë varshmërinë reciproke ndërmjet qenieve të gjalla;
- të njohë termat, kuptimet, konceptet, proceset dhe ligjshmëritë biologjike;
- të zhvillojë aftësitë për hulumtim të proceseve dhe të dukurive jetësore;
- të zhvillojë aftësitë për zbatimin e njohurive të përgjithshme në përfitimin e njohurive të reja;
- të dijë se njeriu dallohet nga qeniet e tjera, por njëkohësisht ai duhet të marrë përgjegjësinë për qeniet e tjera;

- të zhvillojë aftësitë për hulumtim efektiv, të saktë dhe të sigurt. Të dijë çka duhet të arrijë gjatë një vrojtimi, përkatësisht hulumtimi, përmes punës praktike në laborator, natyrë;
- të mbajë qëndrim etik dhe përgjegjës ndaj mjedisit;
- të dijë se njeriu është i varur nga natyra dhe është pjesë përbërëse e saj;
- të vlerësojë ndikimin negativ të njeriut në natyrë si dhe ambiciet e tij për ndryshimin e saj;
- të zbatojë njohuritë në rastet konkrete në jetën e përditshme;
- të përfitojë njohuri në mënyrë aktive dhe të formojë qëndrim pozitiv për natyrën.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Përmbajtja e lëndës është organizuar sipas kategorive, nënkategorive dhe temave mësimore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm të lëndës.

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin pesë tërësi mësimore, me anë të të cilave përfshihet fondamenti i lëndës. Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara sipas rëndësisë së temave mësimore.

| PËRMBAJTJA PROGRAMORE | | | |
|---|---------------------------------------|-------------|------------|
| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | Orët | % |
| I. NDËRTIMI I QENIEVE TË GJALLA DHE PROCESET JETËSORE | I 1. QELIZA, INDET DHE ORGANET BIMORE | 9 | 24.32 |
| II. QENIET E GJALLA DHE MJEDISI | II. 1. BIODIVERSITETI | 21 | 58.33 |
| | Punë praktike | 4 | 10.81 |
| | Orë në dispozicion | 2 | 5.4 |
| | Gjithsej | 36 | 100 |

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për 37 orë mësimi sipas kësaj forme:

- **Kategoritë, nënkategoritë dhe temat mësimore**
- **Objektivat**
- **Përmbajtja programore**
- **Rezultatet e pritshme**
- **Ndërlidhja**

BIOLOGJIA E QELIZËS

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të dinë për ndërtimin themelor të qelizës;
- të kuptojnë pse qeliza është njësi themelore e jetës;
- të kuptojnë ndarjen e biologjisë sipas përmbajtjes së lëndës;
- të njihen me rëndësinë e biologjisë në jetën e përditshme;
- të njihen me punën laboratorike;
- të dinë për formën e qelizës;
- të dinë për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet qelizës prokariote dhe eukariote;
- të jenë në gjendje të kuptojnë dallimin ndërmjet qelizës bimore dhe shtazore;
- të dallojnë pjesët e qelizës në fotografi, vizatim dhe mikroskop.

Përmbajtja programore

- Qeniet e gjalla janë të ndërtuara nga njësia themelore e jetës – qeliza;
- Qeliza – veçoritë themelore të qelizës bimore dhe shtazore;
- Qelizat prokariote dhe eukariote;
- Vrojtimi i qelizës me mikroskop.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi në fund të klasës VI nga kjo përmbajtje mësimore:

- Kupton ndërtimin dhe përshkruan funksionin themelor të qelizës;
- Dallon qelizën bimore nga ajo shtazore;
- Dallon organizmat prokariotë nga ata eukariotë;
- Kupton se në qelizë vazhdimisht kryhet shkëmbimi i materies dhe i energjisë;
- Kupton se nga qelizat formohen indet, nga indet organet dhe nga organet formohen sistemet e organeve.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Kiminë: në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës;

Fizikën: në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike, qarkullimit të materieve.

BIOSISTEMATIKA, KATEGORITË SISTEMATIKE

Objektivat

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë metodat themelore që zbatohen në biosistematikë;
- të dinë se bota e gjallë është ndarë në pesë mbretëri;
- të dallojnë kategoritë themelore sistematike;
- të klasifikojnë gjallesat në kategoritë më të larta sistematike;
- të dinë për kontributin e Lineut në zhvillimin e sistematikës;
- të njohin zhvillimin evolutiv të grupeve kryesore të bimëve.

Përmbajtja programore

- Metodat e biosistematikës;
- Kategoritë sistematike;
- Klasifikimi i botës së gjallë në pesë mbretëri: 1. Prokariotëve 2. Parashazorëve 3. Kërpudhave dhe likeneve 4. Bimëve 5. Shtazëve

Rezultatet e pritshme

Nxënësit duhet të:

- Kuptojnë se klasifikimi i gjallesave bëhet në bazë të afrisë filogjenetike, ndërsa emërtimi sipas rregullave të nomenklaturës;

- Emërtojnë kategoritë dhe njësitë sistematike;
- Klasifikojnë disa lloje kërpudhash dhe bimësh me farë në mjedisin ku jetojnë;
- Zbatojnë njohuritë e biosistematikës në jetën e përditshme;
- Njohin kategoritë kryesore të botës së gjallë.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me: *Anatominë*, në aspektin e njohjes së ndërtimit të gjallesave; *Paleontologjinë*, gjeologjinë, gjenetikën, biokiminë, ekologjinë, embriologjinë etj.

BAKTERET, ALGAT BLU NË TË GJELBËR

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të zhvillojnë njohuri për formën, ndërtimin, madhësinë, shumëzimin dhe përhapjen e gjallesave pa bërthamë të diferencuar qelizore;
- të përshkruajnë veçoritë e përgjithshme të prokariotëve, rëndësinë e baktereve;
- të vlerësojnë rolin e baktereve në natyrë dhe në ekonominë e njeriut;
- të emërtojnë disa sëmundje që shkaktojnë bakteret;
- të zhvillojnë njohuri themelore për gjallesat pa bërthamë të diferencuar qelizore.

Përmbajtja programore

- Organizmat pa bërthamë qelizore të diferencuar. Bakteret dhe algat e gjelbra blu;
- Bakteret në shërbim të njeriut (bakteret saprofite dhe parazite);

Rezultatet e pritshme

Nxënësit duhet të:

- Dinë se bakteret dhe algat e gjelbra blu bëjnë pjesë në organizma prokariotë;

- Dallojnë bakteret autotrofe dhe heterotrofe (saprofite, parazite);
- **Emërtojnë** disa sëmundje bakteriale;
- **Sqarojnë** pse nganjëherë shfaqet “lulesa ujore”;
- **Zbatojnë** njohuritë e fituara për parandalimin e sëmundjeve bakteriale;
- **Zhvillojnë** rrjet mendimesh për dobitë dhe dëmet që mikroorganizmat i sjellin njeriut dhe ekonomisë së tij.

Ndërlidhja

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Sistematikën - në kuptim të njohjes dhe emërimit të llojeve të bakte-reve patogjene dhe dobiprurëse;

Bioteknologjinë - në kuptim të shfrytëzimit të bakte-reve në bujqësi, në industrinë ushqimore, farmaci, energjetikë, mbrojtje të mjedisit;

Imunologjinë - në kuptim të njohjes së zhvillimit të mekanizmave mbrojtës të organizmit ndaj mikrogjallesave patogjene.

EUKARIOTËT –

ALGAT, KËRPUDHAT, LIKENET DHE MYSHQET

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të njohin ndërtimin e talusit të algave dhe rolin e pigmenteve;
- të dinë për përhapjen e algave në natyrë dhe rolin e tyre;
- të njohin kërpudhat, të dinë se ato paraqesin grup të veçantë të bimëve;
- të dinë ndërtimin, mënyrën e të ushqyerit, madhësinë dhe përhapjen e kërpudhave në natyrë;
- të kuptojnë rolin e kërpudhave për natyrën;
- të dallojnë kërpudhat helmuese nga ato me vlerë ushqyese për nje-riun;
- të kuptojnë se likenet janë simbiozë e algave dhe kërpudhave;
- të njohin likenet më të shpeshta dhe rolin bioindikator të tyre;
- të njohin ndërtimin e myshqeve;
- të kuptojnë përhapjen dhe rëndësinë e myshqeve.

Përmbajtja programore

- Llojlojshmëria e algave dhe roli i tyre për natyrën edhe për ekonominë;
- Kërpudhat - mënyra e të ushqyerit, shumimi, përhapja dhe roli i tyre në natyrë;
- Bashkëjetesa midis kërpudhave dhe algave-likenet;
- Myshqet - përhapja, mënyra e të ushqyerit dhe llojlojshmëria.

Rezultatet e pritshme

Në fund të kësaj përmbajtje programore nxënësit:

- Kuptojnë ndërtimin e talusit të algave eukariote, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve;
- Analizojnë mënyrën e të ushqyerit të algave, kërpudhave, likeneve dhe myshqeve;
- Dinë t'i dallojnë algat, kërpudhat, likenet dhe myshqet;
- Kuptojnë se likenet janë simbiozë e kërpudhave dhe algave;
- Vrojtijnë me mikroskop mykun e bukës, algën e gjelbër etj.

Ndërlidhja

Përmbajtja e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Ekologjinë - në kuptim të njohjes së përhapjes së bimëve jo vaskulare në planet;

Farmacinë - përdorimi i bimëve jovaskulare për prodhimin e antibiotikëve;

Paleontologjinë - në kuptim të njohjes së filogjenisë së bimëve jo vaskulare;

FIERNAT

BIMËT ME LULE OSE ME FARË (SPERMATOPHYTA)

Objektivat:

Nxënësit duhet:

- të kuptojnë ndërtimin e indeve dhe organeve bimore;
- të kuptojnë veçoritë themelore të mbretërisë së bimëve;
- të dallojnë përfaqësuesit e farëzhveshurave nga përfaqësuesit e farëveshurave;

- t'i përshkruajnë bimët më të përhapura në mjedisin ku jetojnë;
- të kuptojnë përhapjen dhe zhvillimin e fiernave;
- të njihen me disa përfaqësues të fiernave të vdekur;
- të njihen me veçoritë e përgjithshme të bimëve me farë;
- të njihen me ndërtimin e rrënjës, kërcellit, gjethes, lules dhe frutave;
- të kuptojnë ndërlidhjen e shtazëve dhe bimëve gjatë përhapjes së frutave;
- të zbatojnë parimet themelore të biosistematikës gjatë klasifikimit të farëzhveshurave dhe farëveshurave;
- të kuptojnë, dinë se farëveshurat ndahen në: njëthelbore dhe dythelbore.

Përmbajtja programore

- Indet dhe organet bimore (rrënja, kërcelli, gjethi);
- Përhapja dhe zhvillimi i fiernave;
- Veçoritë e përgjithshme të bimëve me farë;
- Farëzhveshurat – familjet më kryesore – veçoritë e përgjithshme dhe ndarja e farëveshurave në njëthelbore dhe dythelbore;
- Lulja dhe ndërtimi i saj;
- Polenizimi, frytnimi, fara, fryti.

Rezultatet e pritshme

Nxënësit:

- kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes myshqeve, fiernave, farëzhveshurave dhe farëveshurave;
- dinë për zhvillimin e fiernave, farëzhveshurave dhe farëveshurave;
- dallojnë lulet e bimëve farëveshura nga ato të farëzhveshurave;
- dallojnë monokotiledonet nga dikotiledonet;
- kuptojnë si formohet fryti dhe dallojnë llojet e fryteve;
- dallojnë ndërtimin e organeve vegjetative dhe reproduktive të bimëve njëthelbore dhe dythelbore;

- dallojnë disa nga bimët mjekuese dhe helmuese të mjedisit ku jetojnë.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

Anatominë, morfologjinë, mjekësinë, pylltarinë, bujqësinë – në kuptim të njohjes së bimëve mjekuese me rëndësi të veçantë ushqyese.

PUNËT PRAKTIKE

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet, të cilat i kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim konkretizimi të pjesës teorike të lëndës. Detyrat dhe ushtrimet për punë praktike (që duhet të kryhen në grupe ose individualisht) janë të lidhura me përmbajtjen e lëndës, prandaj për kryerjen e tyre nuk kërkohen njohuri jashtë përmbajtjes së lëndës së paraparë për këtë vit. Ushtrimet janë relativisht të thjeshta dhe të realizueshme për një orë. Nuk është vështirë të udhëhiqet me veglërinë e paraparë për ushtrime.

Punët praktike, të cilat do të realizohen:

- Njohja me veglërinë laboratorike (mikroskopi, qelqi zmadhues);
- Vrojtimi mikroskopik i epidermës së qepës, micelit të mykut, algës së shiut;
- Njohja dhe vrojtimi i rrënjës, kërcellit, gjethit, lules dhe fryteve;
- Në bazë të luleve të mbledhura të qershisë, mollës, dardhës, ftoit etj., të caktohet lloji, gjinia dhe familja e këtyre bimëve. Në mungesë të materiali të freskët mund të përdoren edhe bimët e herbarit, e në rastin e fundit edhe fotografitë e luleve të këtyre bimëve;
- Nxënësit të udhëzohen për determinimin e farëzhveshurave dhe farëveshurave

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji, si dhe në çdo lëmë tjetër, mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th., mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim që realizohet me metoda të ndryshme, ku secila prej tyre ka rëndësi dhe vlerë të veçantë.

Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë, përmendim:

- **Metodën e shpjegimit;**
- **Metodën e kuvendimit (bashkëbisedimit);**
- **Metodën e leximit dhe punës me tekst;**
- **Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet);**
- **Metodën e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues (në kompjuter, programe simuluese kompjuterike për proceset fiziologjike - fotosinteza, transpiracioni, qarkullimi i materieve dhe energjisë, ndërtimi i organeve bimore, etj.).**

Format e punës

- individuale,
- në çifte,
- në grupe,
- me të gjithë nxënësit,
- brainstormingu, etj.

Arsimtari gjithmonë ka parasysh se nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes, me qëllim që tek ai të zhvillohen të menduarit kritik dhe aftësitë kognitive.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në: klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrotjnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: **prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.**

VLERËSIMI

Vlerësimi është pjesë përbërëse e mësimet, prandaj si i tillë ai kërkon objektiva të qarta mësimore. Arsimtari cakton qartas çfarë duhet mësuar nxënësit. Ky përcaktim tregon atë që duhet të vlerësohet.

Vlerësimi realizohet gjatë tri etapave:

- **Kontrolli**
- **Matja** - nxënësi ka nevojë të dijë për rezultatin e kontrollit. Matjen e bën arsimtari, me: pikë, simbole, shenja dalluese etj.
- **Vlerësimi** – nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi cilësor ose sasior të mbështetur në matjen. Vlerësimin e bën arsimtari me notë, simbol ose shprehje.

Arsimtari parashikon disa vlerësime përmblledhëse gjatë vitit. Vlerësimi mbështetet në atë se ç' thonë, ç' shkruajnë dhe ç' bëjnë nxënësit.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe sjelljeve të nxënësve ka një sërë teknikash:

- **Vlerësimi me shkrim;**
- **Vlerësimi me gojë;**
- **Vlerësimi me anë të dëgjimit;**
- **Vlerësimi praktik;**
- **Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve;**
- **Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në terren;**
- **Testimi** - është ecuria e matjeve sipas një synimi ose objektivi të caktuar.

Ekzistojnë lloje të ndryshme testesh, si:

Testet me përgjigje alternative;

Testet me kombinime;

Testet me alternativa të shumta;

Testet me përgjigje të shkurtra dhe me plotësim.

Vlerësimi duhet të jetë:

- **I vlefshëm;**
- **I besueshëm;**

- **I barabartë;**
- **I paanshëm;**
- **Formues.**

NJOHJA DHE TË KUPTUARIT

Nxënësit njohin dhe kuptojnë:

- Dukuritë, ligjshmëritë, veprimet, përkufizimet, kuptimet dhe teoritë;
- Teknikën, aparaturën bazë dhe atë ndihmëse;
- Sjelljet gjatë punës në klasë, laborator të biologjisë dhe terren;
- Çrregullimet në mjedis, pasojat për shoqërinë dhe mënyra e tejkalimit të tyre.

Pyetjet që parashtrihen për verifikim të qëllimit, të bazuar në njohje dhe të kuptuar, zakonisht fillojnë me fjalët: **përkufizo, shëno, përshkruaj, skico, arsyeto, apliko, sqaro, cakto, emërto, etj.**

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Nxënësit janë të aftë që njohuritë e fituara t'i shprehin në forma të ndryshme (**skematike, grafike, numerike**):

- të organizojnë t'i mbledhin informatat në mënyra të ndryshme;
- të riformulojnë informatat prej një forme në tjetrën;
- të përdorin të dhënat në mënyrë logjike;
- të sqarojnë dukuritë, ligjshmëritë si dhe ndërlidhjet e tyre në mënyrë logjike;
- të japin supozime dhe parashtrojnë hipoteza, duke lidhur njohuritë nga kaptina të ndryshme të biologjisë dhe lëndëve të tjera;
- të përdorin njohuritë në situata të reja, zgjidhin probleme, i analizojnë problemet në mënyrë kritike.

Pyetjet me të cilat verifikohen këto qëllime fillojnë me: **propozo, përdor, ndërlidh, përmend, etj.**

SHKATHTËSITË EKSPERIMENTUESE

Nxënësit dinë:

- të dizajnojnë eksperimente të thjeshta;
- të përgatisin p.sh., mostrën biologjike, vrojtojnë, përshkruajnë dhe masin;
- Të zbatojnë të dhënat në praktikë;
- Të përdorin teknikën, mjetet ndihmëse si dhe aparaturën në laborator dhe në terren.

Gjatë përgjigjes në pyetje ose gjatë zgjidhjes së problemeve në lëmin e verifikimit të aftësive dhe të shkathtësive, nxënësi duhet që njohuritë e tij **logjikisht t'i përdorë në situata të reja, në formë deduktive.**

BIOLOGJI

Klasa VII

2 orë në javë, 36 orë në vit

HYRJE

Kërkesë imediate e mileniumit të ri është integrimi në shumë nivele, duke përfshirë edhe atë shkencor. Prandaj, biologjia bashkëkohore synon të gjejë rrugë të reja të parashtrimit të integruar të njohurive nga fushat specifike të biologjisë me shkencat e tjera natyrore e shoqërore.

Në këtë kontekst përmbajtja e programit mësimor të biologjisë (si qeniet e gjalla dhe mjedisi - zoodiversiteti, ndërtimi i qenieve të gjalla – indet, organet dhe sistemet e organeve, proceset jetësore – metabolizmi, cikli jetësor) i kontribuon zhvillimit të mendimit kritik, aftësive kognitive dhe shkathtësive psikomotorë të nxënësve.

Zbatimi i qasjeve dhe i strategjive të reja të mësimdhënies zhvillon te nxënësi prirje për aplikim dhe ndërlidhje të njohurive me botën reale, hapin dyert për orientim të ardhshëm profesional në lëmin e mjekësisë, të veterinarisë, të bujqësisë etj.

Në këtë kontekst edhe zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënësve, metodave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Përmbajtja programore e lëndës së biologjisë e nxit kërkuesin e nxënësve për botën e gjallë me njeriun në të, zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë për natyrën, qeniet e gjalla, ndërgjegjëson ata se njeriu duhet të ketë qëndrim tjetër ndaj natyrës dhe mjedisit. Të gjitha këto me synim që nxënësi si qytetar i ardhshëm të ballafaqohet me sukses me sfidat e mileniumit të ri.

QËLLIMET

- ❖ Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, organizimin, ndërtimin dhe zhvillimin e botës së gjallë.
- ❖ Zhvillimin e njohurive për biodiversitetin e gjallesave dhe aftësive për të vlerësuar rolin e tij në ruajtjen e baraspeshës ekologjike në natyrë.
- ❖ Zhvillimin e shkathtësive, përpunimin e të dhënave relevante shkencore dhe zbatimin e shkathtësive të fituara konkrete për të mirën e njeriut dhe të mjedisit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**
 - Në kontest të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së përgjegjësimit etik ndaj botës së gjallë dhe mjedisit jetësor me qëllim të ruajtjes së baraspeshës ekologjike në natyrë;
 - Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperative, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik).
- **Të njohë:**
 - Fjalorin (terminologjinë biologjike);
 - Faktet, konceptet dhe parimet biologjike;
 - Procedurat dhe metodat në biologji.
- **Të kuptojë**
 - Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre;
 - Relacionin shkak – efekt;
 - Arsyetimin e metodave dhe të procedurave.
- **Të zbatojë në situata të reja**
 - Faktet dhe parimet biologjike;
 - Procedurat dhe metodat nga biologjia;
 - Zgjedhjen e problemeve të natyrës biologjike.
- **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme**
 - Të shkruajë raportet nga një punë praktike ose hulumtim;

- Të prezantojë rezultatet e hulumtimit, duke konsultuar shumë burime të informacionit;
- Të kontribuojë në debate dhe diskutime për çështje biologjike.
- **Të zhvillojë të menduarit kritik nga biologjia**
 - Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante;
 - Të dallojë faktin nga gjykimi;
 - Të zbatojë parimet biologjike në zgjidhjen e problemeve;
 - Të interpretojë materialin ilustrues.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Organizimi i përmbajtjes përfshin: ndërtimin, balancimin dhe mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin tri kategori kryesore me të cilat përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara të përmbajtjes sipas rëndësisë së tërësive mësimore.

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për 74 orë mësimi, sipas trajtës.

- Kategoria;
- Nënkatëgoria;
- Përmbajtja programore;
- Rezultatet e pritshme;
- Lidhja ndërlëndore.

| PËRMBAJTJA PROGRAMORE | | | |
|----------------------------------|---|------|-----------|
| KATEGORIA | NËNKATEGORIA | Orët | % |
| I. QENIET E GJALLA DHE MJEDISI | II. ZOODIVERSITETI | 13 | 35.13 |
| II. NDËRTIMI I QENIEVE TË GJALLA | II. 1. INDET, ORGANET DHE SISTEMET E ORGANEVE | 11 | 30.55 |
| III. PROCESET JETËSORE | III.1 METABOLIZMI | 3 | 8.1 |
| | III. 2. CIKLI JETËSOR | 3 | 8.1 |
| | Punë praktike në laborator dhe në terren | 5 | 13.51 |
| | Orë në dispozicion | 1 | 2.7 |
| | Gjithsej | | 36 |

| KATEGORIA | NËN-KATEGORIA | PËRMBAJTJA PROGRAMORE | REZULTATET E PRITSHME | LIDHJA NDËRLËNDORE |
|-----------------------------------|-------------------------|--|--|---|
| I. Qeniet e gjalla dhe mjedisi | I. 1. Zoodiversiteti | <p>Organizma me numër më të madh të botës shtazore - Parruazorët</p> <ul style="list-style-type: none"> • organizmat shtazorë pa inde të diferencuara-sfungjerët, • shtazët me trup dyshtresor-knidariat, • krimbat e shtypur dhe cilindrikë • shtazët me trup të butë-butakët, • shtazët me segmentim të trupit-krimbat unazorë, • gaforret, • shtazët me tri palë këmbë-insektet, • shtazët tipike të detit me trup të mbuluar me gjemba-lëkurëgjemborët. <p>Në mbretërinë e shtazëve ekzistojnë organizma shtazorë që kanë bosht primitiv skeletor-chorda dorsalis, i cili te format adulte të kurrizorëve shndërrohet në shtyllë rruazore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • shtazët me skelet boshtor primitiv-kordatet; | <p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje programore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin dhe të zbatojnë përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me zoodiversitetin. - Të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e njeriut në zoodiversitet. - Të përshkruajnë historikun e zhvillimit të shumëllojshmërisë së jokurrizorëve dhe të kurrizorëve. - Të krahasojnë dhe të dallojnë përfaqësuesit e klasave të ndryshme të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve. - Të emërtojnë jokurrizorë dhe kurrizorë të ndryshëm të mjedisit ku jeton. - Të observojë modele ose të përdorë organizma të | <p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjeografinë, në kuptimin e njohjes së përbërjes së shtresave të ndryshme të dheut; • Ekologjinë, në kuptimin e njohjes së faktorëve të ndryshëm të mjedisit jetësor në procesin e zhvillimit evolutiv dhe diversitetit; • Gjenetikën, në aspektin e njohjes së ligjshmërive të trashëgimit në procesin e krijimit të llojeve. |

| | | | | |
|---|---|--|---|---|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • shtazët me shtyllë kurrizore të vërtetë-kurrizorët; • kurrizorët pa nofulla-gojërrumbullakët; • kurrizorët tipikë uJORË-peshqit; • kurrizorët e parë tokësorë-ujëtokësorët; • kurrizorët e mbuluar me pllakëza të brirëzuara-zvarranikët; • kurrizorët me trup të mbuluar me pupla-shpendët; • kurrizorët me qime dhe me gjëndra qumështore-gjitarët; | ndryshëm-përfaqësues të grupeve të ndryshme të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve për të krijuar pasqyrë të rritjes së ndërlikueshmërisë së ndërtimit të organizmave. | |
| II. Ndërtimi i qenieve të gjalla | II.1. Indet, organet dhe sistemet e organeve | <p>II. 1.1. Qeniet e gjalla që të kryejnë funksionet e ndryshme jetësore janë të ndërtuara nga indet, organet dhe sistemet e organeve.</p> <p>II. 1.2. Shtazët sikur edhe bimët kanë nevoja të ndryshme jetësore, të cilat i plotësojnë në rrugë të ndryshme nëpërmjet funksionit të indeve, të organeve dhe të sistemeve të organeve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbulesa trupore-lëkura • Sistemi i lëvizjes • Sistemi skeletor | <p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje programore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe me funksionin e indeve, të organeve dhe të sistemeve të organeve të kafshëve. - Të përshkruajnë ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme. | <p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kiminë, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve. • Fizikën, në aspektin e njohjes |

| | | | | |
|-------------------------------|----------------------------|--|---|--|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi muskolor • Sistemi nervor • Shqisat • Sistemi i tretjes • Sistemi i frymëmarrjes • Sistemi i qarkullimit të gjakut • Sistemi urogjenital | <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë se organizmat janë në gjendje të mirëmbajnë mjedisin e brendshëm të tyre nga infeksionet, ndotësit etj. - Të parashikojnë ç'do të ndodhë nëse një organ nuk funksionon, çrregullohet puna e tij ose e humb funksionin. - Të analizojnë, të sintetizojnë dhe të shfrytëzojnë parimet themelore të ndërtimit dhe të funksionit të sistemeve të gjalla në jetën e përditshme të tij. | së ligjshmërive fizike, si qarkullimi i materieve. |
| III. Proceset jetësore | III. 1. Metabolizmi | <p>III.1. 1. Qeniet e gjalla kryejnë funksione të ndryshme jetësore si fotosinteza, frymëmarrja etj.</p> <p>III.1. 2. Qeniet e gjalla kanë nevojë për ujë, oksigjen, dioksid karboni dhe materie të ndryshme organike dhe joorganike.</p> | <p>Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojnë rolin e proceseve thelbësore jetësore – fotosintezës dhe frymëmarrjes, për qarkullimin e materies dhe rrjedhjen e energjisë. - Të përshkruajnë ndërlidhjen e procesit të fotosintezës dhe të frymëmarrjes. - Të kuptojnë rëndësinë e procesit të frymëmarrjes dhe | <p>Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biokiminë, në aspektin e strukturës, aktivitetit dhe rolit të komponimeve kimike në metabolizëm në përgjithësi. • Kiminë, në aspektin e madhësisë |

| | | | | |
|-------------------------------|------------------------------|--|---|--|
| | | | të fotosintezës për funksionimin e organizmave. - Të aplikojnë fermentimin në jetën e përditshme | së molekulave, gjendjes agregate të përbërsëve qelizorë etj. |
| III. Proceset jetësore | III. 2. Cikli jetësor | III. 2.1. Cikli jetësor – ndarja qelizore III. 2.2. Procesi i fekondimit; Zigota, zhvillimi embrional (drejtpërdrejt dhe tërthorazi), lindja, rritja, lënia e pasardhësve dhe vdekja. | Nxënësit në fund të klasës së shtatë nga kjo përmbajtje mësimore duhet: - Të përshkruajnë ndarjen qelizore - Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor. - Të kuptojnë dhe të përshkruajnë procesin e formimit të qelizave seksuale. - Të përshkruajë ndarjen qelizore - ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mitozës dhe mejozës. - Të hulumtojnë dhe të demonstrojnë fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës). | Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me: • Kiminë, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të materialit trashëgues. • Anatominë, fiziologjinë, biokiminë. |

PUNËT PRAKTIKE

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim konkretizimi të pjesës teorike të lëndës.

Në mungesë të laboratorëve, punët praktike mund të kryhen edhe në klasë, me kusht që materiali dhe mjetet e punës praktike paraprakisht të sillen në klasë.

Punët laboratorike nuk janë ndonjë metodë e veçantë e mësimi, por janë formë e organizimit të punës mësimore, gjatë së cilës nxënësit në bashkëpunim me arsimtarin vrojtojnë strukturat, proceset dhe fenomenet e ndryshme jetësore gjatë eksperimentit, diseksionit dhe teknikës së mikroskopimit.

Punët praktike, të cilat do të duhej të realizoheshin në mësimin e biologjisë për klasën e shtatë, janë:

- Të demonstrojnë fermentimin nëpërmjet mufatjes së brumit të bukës pas shtimit të kërpudhës së tharmit.
- Të vrojtojnë me thjerrë ose me mikroskop parashazorët: paramociumin, amebën ose kërbazorin e gjelbër në ujin e gjelbër të ndonje moçali ose të materialit të përgatitur nga ju me ndihmën e arsimtarit.
- Të vrojtojnë me mikroskop qelizën shtazore.
- Të përcjellin zhvillimin embrional te bretkosa ose te pula.
- Të determinojnë përfaqësues të caktuar të ujëtokësorëve, zvarranikëve ose të gupeve të tjera të shtazëve që jetojnë në mjedisin e tyre.

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra d.m.th. mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim, i cili realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike.

Çdo lëndë përpos metodave të përgjithshme mësimore, ka edhe metodat e veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë po përmendim:

- Metodën e të shprehurit me gojë (monologu);

- Metodën e bashkëbisedimit (dialogu);
- Metodën e leximit dhe të punës me tekst;
- Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet);
- Metodën e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues (p.sh., programe simuluese kompjuterike).

Çdo metodë mësimore i ka anët pozitive dhe negative. Kjo do të thotë se me zbatimin e një metode të vetme mësimore nuk mund të realizohen të gjitha qëllimet dhe detyrat e mësimit të lëndës së biologjisë. Prandaj, ajo patjetër duhet të kombinohet në vartësi nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat të cilët synohen të realizohen.

Prandaj, është kompetencë e arsimtarit, duke zbatuar strukturën ERR të orës, të zgjedhë materiale të shumëllojshme didaktike, metoda dhe strategji më të përshtashme të mësimdhënies dhe nxënies, me synim të realizimit të qëllimeve dhe të objektivave specifike, me nxënësin në qendër. (si p.sh., **Kllaster, Kubimi, Insert, Tabela e koncepteve, Diagrami i Venit, Brainstorming, Xhigsou I dhe II etj.**).

Për hollësi të këtyre formave të punës me nxënës dhe të teknikave të mësimdhënies shih tekstet:

B. Musai; Modele të mësimdhënies së suksesshme, Tiranë, e-mail:rwct_ara@aedp-soros.al.

M. Mula. Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR të orës, Prishtinë, 2003. Email: office @ kec-ks.org,http://www. kec-ks. org

Plani dhe programi mësimor për kl. 9 dhe 10, Prishtinë, 2002 dhe 2003, f. 11 –14 dhe f.167-169.

Në praktikë thuaja nuk ekziston orë e biologjisë në të cilën përdoret vetëm një metodë mësimore. Me zbatimin e disa metodave mësimore në të njëjtën orë të mësimit, ora bëhet më dinamike, thyhet monotonia dhe ngritet interesimi i nxënësve për mësim.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore, e freskon mësimin, e bën shumë më interesant, me çka arrihet që rezultatet në nxënie të jenë më të mira.

Për realizimin sa më të mirë të qëllimeve të parashtruara në orën mësimore duhet të punojmë në frymën e parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja, prej makronivelit kah mikroniveli.(p.sh., organi, indi, qeliza, infrastrukturat qelizore).

Me fjalë të tjera, arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, në shkollë, në laborator, në natyrë etj., jo vetëm të memorizojnë, por të mund të njohin, të vrojtojnë, të radhisin, të masin, të shënojnë, të mbledhin të dhënat, të eksperimentojnë, të mbikqyrin. Pra, të kuptojnë përmbajtjet programore, duke vërtetuar e punuar. Ajo që dëgjohet harrohet, ajo që shihet mbahet në mend, ajo që shihet dhe punohet kuptohet. Për të realizuar këtë synim, arsimtari i ndihmojnë vivariumet, akuariumet, terrariumet, puna në terren-ekskursionet shkencore dhe puna në laborator. Për klasifikim të bimëve dhe të shtazëve të mjedisit ku jeton nxënësi, arsimtari e udhëzon atë si duhet të përdoren çelësat për determinim.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vërtetimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikullë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e prituara) të programit të lëndës së biologjisë për klasën VII.

Ky proces mbështet në disa parime themelore, siç janë:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me të cilat bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

Instrumentet e vlerësimit

Është me rëndësi që për veçoritë që duam t'i vlerësojmë duhet të përdorim mjetin apo instrumentin përkatës të matjes. Me çfarëdo mjeti që

përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësit, andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundshme mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetësi (vetëvlerësimi);
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo i një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathhtësitë manovruese të nxënësit);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe në objektiva;
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetjet) me
 - përgjigje alternative të shumta;
 - përgjigje të hapura të shkurtra;
 - përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor, çdo nxënës duhet të arrijë njëren prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumëmirë (arritje e lartë)
- mirë (arritje mesatare)
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të biologjisë për klasën VII rekomandohet përdorimi i:

- Atlasi i përgjithshëm i zoologjisë, I. Zeneli, Prishtinë 2000,
- Atlasi i anatomisë D. Rexhepi, H. Qerimi Prishtinë 2002,
- Atlas i biologjisë, A. Gashi, K. Abdullahu.

Fjalor me shpjegime terminologjike dhe përkufizime të zgjeruara

- Fjalor i biologjisë, E. Ruka, Zyri Bajrami, Botime Toena, Tiranë, 1999.
- Fjalor i emrave të bimëve, F. Krasniqi et.al. 2004, Tiranë-Prishtinë.
- Çelësi i ilustruar me fotografi për determinimin e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve

Koleksione të literaturës së rëndësishme lidhur me temat e veçanta

- Gazeta, revista profesionale dhe shkencore, pastaj fotografi, posterë, skema, diagrame, harta, tabela, preparate, CD, videokaseta, burime nga interneti etj.

GJEOGRAFIA E PËRGJITHSHME DHE E KOSOVËS

Klasa VI

HYRJE

Gjeografia për klasën VI ka për objekt studimit Tokën, popullsinë, raportet e ndërsjellta dhe Kosovën si regjion. Gjeografia i mëson nxënësit të krijojnë kuptim të plotë dhe të drejtë për objektet dhe dukuritë natyrore e shoqërore (humane) në përgjithësi dhe në rastin e Kosovës në veçanti si hapësirë e jetës për popullsinë e cila jeton në të.

QËLLIMET

1. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **njohur** gjeografinë si shkencë, Tokën dhe Gjithësinë, lëvizjet e Tokës, sistemet fizike, humane dhe Kosovën.
2. Zhvillimin e aftësive për të **kuptuar** pozitën e Tokës në Gjithësi, karakteristikat e Tokës si trup qiellor, përbërësit e mjedisit fizik e human, karakteristikat fizike e humane të Kosovës.
3. Të zhvillojë **shkathtësitë** dhe **shprehitë** e nevojshme për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave të ndryshme në situata konkrete.
4. Zhvillimin e gatishmërisë për të **përdorur drejt** dhe me **përgjegjësi** njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë.
5. Zhvillimin e **qëndrimeve** dhe të **vlerave** për llojllojshmërinë e veçorive natyrore, njerëzore në përgjithësi dhe në veçanti për Kosovën.
6. Zhvillimin e aftësive për **respektimin** e të drejtave njerëzore për të gjithë njerëzit në botë e në Kosovë, pa marrë parasysh përka-

tësinë kombëtare, fetare, gjuhësore dhe angazhimin për të kërkuar zgjidhje të problemeve të nivelit lokal, regional e botëror.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të njohë:**
 - Faktet dhe konceptet për veçoritë e Tokës, të Sistemit Diellor, relacionet në mes tyre.
 - Karakteristikat themelore të Gjithësisë, Sistemit Diellor, Tokës dhe Kosovës si regjion.
- **Të kuptojë:**
 - Formën e trupave qiellorë, lëvizjet dhe pasojat e tyre për botën e gjallë në Tokë, përbërësit e mjedisit fizik e human dhe raportet mes sferave në Tokë.
 - Specifikat dhe ngjashmëritë e trupave qiellorë, të trupave të tjerë qiellorë, të sferave të Tokës dhe të Kosovës si regjion.
- **Të zbatojë:**
 - Njohuritë për leximin dhe shfrytëzimin e hartave, sistemin e koordinatave, shenjat hartografike, grafikonet, diagramet, hartat etj.
 - Të përdorë të dhëna verbale sasiore dhe simbolike, fotografi, tabela, diagrame, harta etj.
- **Të analizojë:**
 - Rëndësinë e formës, madhësisë së Tokës dhe lëvizjeve të saj në dukuritë natyrore.
 - Rritjen dhe shpërndarjen e popullsisë në botë dhe veçoritë e ndryshme të saj.
 - Rolin e pozitës gjeografike të Kosovës, kushteve natyrore, veçorive sociale e ekonomike në zhvillimin e Kosovës dhe specifikat e saj.
- **Të vlerësojë:**
 - Rolin e formës, madhësisë, largësisë nga Dielli në dukuritë e ndryshme natyrore në Tokë.

- Shkaqet e dukurive dhe proceseve, si ngrohjen globale, problemin e ujit, erozionit, ndotjes së ajrit, ujit e tokës, të rritjes së shpejtë të popullsisë në disa pjesë të botës, problemin e refugjatëve, zhvillimin e pabarabartë ekonomik në botë etj.
- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:**
 - Për llojllojshmërinë e mjedisit fizik e human, për kushtet e ndryshme të jetës dhe të veprimtarive njerëzore.
 - Për barazinë gjinore, etnike, fetare, sociale, për bashkëpunim mes komuniteteve dhe krijimin e vlerave kulturore të veçanta dhe të përbashkëta.

**Struktura e përmbajtjeve programore
2 orë në javë, 90 ditë mësimi- 18 javë- 36 orë gjithsej.**

| Kategoritë | Numri i orëve | % |
|------------------------------|---------------|-------------|
| Hapësira dhe sistemet fizike | 12 | 33.33% |
| Sistemet humane | 5 | 13.88% |
| Regjioni-Kosova | 12 | 33.33% |
| Vlerësim | 2 | 5.55% |
| Përsëritje | 5 | 13.88% |
| Gjithsej orë | 36 | 100% |

| Kategoria | Nënkategoria (përmbajtjet programore) | Rezultatet e pritshme | Lidhjet ndërlëndore |
|-------------------------------------|---|--|---|
| Hapësira dhe sistemet fizike | Gjeografia, lënda e studimit, lidhja me shkencat e tjera. | Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e gjeografisë, t'i dallojë disiplinat e saj dhe t'i bëjë ndërlidhjet me shkencat tjera. | Ndërlidhjet mes disiplinave të gjeografisë fizike, gjeologjisë, biologjisë, fizikës |
| | Toka dhe gjithësia | Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e Gjithësisë dhe të trupave qiellorë së bashku me Tokën. | Ndërlidhjet me fizikën, matematikën, gjeologjinë |
| | Forma dhe madhësia e Tokës | Nxënësi duhet të dijë për formën dhe madhësinë e saj. | Ndërlidhja me fizikën, astronominë, matematikën |
| | Lëvizjet e Tokës dhe rrjedhimet | Nxënësi duhet të shprehë ç'është rotacioni, revolucioni dhe cilat janë pasojat e tyre për botën e gjallë. | Lidhja me matematikën, astronominë, biologjinë |
| | Paraqitja e sipërfaqes së Tokës në glob dhe në hartë. | Nxënësi duhet të shprehë ç'është harta, globi, ç'janë paralelet e meridianet, shkalla e hartës, si paraqiten lartësitë e thellësitë. Ç'është lartësia absolute e relative. T'i njohë shenjat themelore hartografike. | Lidhja me hartografinë, matematikën, gjeodezinë |
| | Harta, elementet, përmbajtja dhe përdorimi. | Nxënësi duhet të jetë në gjendje të përdorë hartën, t'i dallojë llojet e hartave. | Lidhja me hartografinë, gjeodezinë, matematikën |
| | Shpërndarja e masave tokësore dhe ujore në Tokë | Nxënësi duhet të krahasojë dhe të dallojë pjesën nën ujë dhe nën tokë dhe proporcionet e tyre. | Lidhja me gjeologjinë, hidrologjinë, fizikën, biologjinë. |

| | | | |
|------------------------|---|--|---|
| | Përbërja dhe ndërtimi i Tokës. Relievi, krijimi dhe format e relievit | Nxënësi duhet të dijë ç'është korja e Tokës, mbështjellësi, bërthama, kontinentet, oqeanet, format kryesore të relievit, vullkanet, tërmetet, si krijohen format kryesore të relievit. | Lidhjet me gjeologjinë, hartografinë |
| | Roli i relievit në jetën dhe në veprimtarinë e njerëzve | Nxënësi përmes shembujve të njohur të tregojë rolin e relievit në shpërndarjen, jetën e njerëzve dhe veprimtarinë. | Lidhjet me gjeomorfologjisë, popullsisë, vendbanimeve dhe ekonomisë |
| | Atmosfera, moti dhe klima | Nxënësi duhet të dijë ç'është atmosfera, cilat janë gazrat kryesor, ç'është moti e klima. Cilët janë brezat e nxehtësisë në Tokë. | Lidhjet me fizikën, kiminë, hartografinë. |
| | Ujërat tokësore dhe nëntokësore | Nxënësi duhet të dijë për format e ndryshme të ujit, objektet ujore, shpërndarjen jo të barabartë, ç'është salaniteti, batica, zbatica, si krijohen valët, ç'është ishulli, gadishulli, gjiu, fjordi, ngushtica detare, lumi, rrjeti lumor, liqenet, ujërat nëntokësore. | Lidhjet me fizikën, kiminë, gjeofizikën |
| | Biosfera | Nxënësi duhet të jetë në gjendje të shprehë formacionet kryesore bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë në botë. | Lidhjet me biologjinë, bio dhe zoogjeografinë |
| Sistemet humane | Numri i banorëve në Tokë, dendësia e banimit | Nxënësi duhet të dijë sa është numri i banorëve në botë, cilat kontinente kanë më shumë banorë dhe cili është më i dendur. | Lidhjet me hartografinë, sociologjinë |
| | Shtimi natyror dhe mekanik i popullsisë dhe politika popullore | Nxënësi duhet të dijë ç'është nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror, ku është shtimi më i lartë dhe pse. Pse njerëzit migrojnë, ç'është imigrimi, emigrimi. Si mund të rregullohet shtimi i popullsisë me politikën popullore. | Lidhjet me sociologjinë, ekonominë, statistikën, matematikën |

| | | | |
|------------------------|--|--|---|
| | Vendbanimet, fshatrat dhe qytetet, dallimet mes tyre | Nxënësi duhet të shprehë ç'është vendbanimi, çfarë janë vendbanimet, çfarë forme e madhësi kanë, cilat po rriten më shpejt, kush e shkakton zhvillimin e tyre. | Ndërlidhja me historinë, arkitekturën, ekonominë |
| | Ekonomia, faktorët e zhvillimit | Nxënësi duhet të shprehë ç'është ekonomia, si zhvillohet ajo, kush e ndihmon zhvillimin dhe kur ngec ajo. | Lidhjet me ekonominë, sociologjinë |
| | Veprimtaritë, degët dhe veçoritë e ekonomisë | Nxënësi duhet të dijë ç'janë veprimtaritë, si ndahen, ç'janë degët e ekonomisë, cila degë tregon zhvillim më të lartë. | Lidhjet me ekonominë, sociologjinë, politikën |
| Regjioni Kosova | Pozita, kufijtë dhe madhësia e Kosovës | Nxënësi duhet të kuptojë çfarë pozite ka Kosova, me kë kufizohet, sa është sipërfaqja e saj. | Lidhja me hartografinë, matematikën, gjeodezinë |
| | Natyra e Kosovës, relievi, veçoritë e tij, pasuritë minerale dhe struktura e tyre. | Nxënësi duhet të shprehë cilat janë malet më të njohura, fushat, luginat, grykat, shpellat, çfarë pasuri ka dhe ku gjenden ato. | Lidhja me gjeologjinë, gjeomorfologjinë, toponomistikën, hartografinë |
| | Veçoritë klimatike dhe hidrografike të Kosovës. | Nxënësi duhet të dallojë sa lloj klima i ka Kosova, me cilat veti dallohen. Të dijë t'i numërojë lumenjtë më të njohur, ku burojnë dhe ku derdhen. | Lidhja me gjeologjinë, gjeomorfologjinë, biogjeografinë |
| | Veçoritë pedologjike dhe biogjeografike të hapësirës së Kosovës | Nxënësi duhet të dijë për llojet më të njohura të tokave, bimët dhe kafshët karakteristike të Kosovës. | Lidhja me pedologjinë dhe biogjeografinë |
| Regjioni Kosova | Popullsia dhe vendbanimet. | Të dijë numrin e banorëve, sa është rritja natyrore, çfarë janë lëvizjet migruese, pse po ndodhin ato, ku shkojnë migruesit. Nxënësi duhet të dijë t'i dallojë | Lidhja me demografinë, urbanistikën |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | tipat e vendbanimeve në Kosovë, cilat janë qytetet më të njohura. | |
| | Ekonomia dhe veçoritë e saj në Kosovë | Nxënësit të tregojnë fazat e zhvillimit ekonomik, situatën e tanishme dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik. | Lidhjet me ekonominë |
| | Veprimtaritë dhe degët e ekonomisë në Kosovë | Nxënësi duhet të shprehë kuptimin e veprimtarive, sektorëve dhe degëve të ekonomisë, të interpretojë grafikët dhe diagramet në lidhje me të dhënat ekonomike. | Lidhjet me ekonominë |
| | Ekonomia bujqësore dhe degët e saj. | Nxënësi duhet të dallojë degët e ekonomisë bujqësore, shpërndarjen e tyre në hapësirën e Kosovës, kushtet dhe faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e tyre. | Lidhjet me pedologjinë, klimatologjinë, hidrologjinë |
| | Xehetaria dhe burimet e energjetikës | Nxënësi duhet të dijë se cilat xehe i ka, ku gjenden, cilat janë shfrytëzuar e shfrytëzohen. | Lidhjet me gjeologjinë |
| | Industria dhe degët e saj në Kosovë | Nxënësi duhet të dallojë degët e industrisë dhe përhapjen e tyre në Kosovë, kur filloi industrializimi, kur u ndërpre dhe çfarë janë tani shansat për zhvillim. | Lidhjet me gjeologjinë, pedologjinë, ekonominë |
| | Organizimi administrativo-politik | Nxënësit duhet të kuptojnë ndarjen administrativo-politike të Kosovës, njësitë e ndarjes, nivelet e ndarjes dhe të organizimit. | Lidhjet me jurisprudencën e politikën |
| | Regjionet e Kosovës dhe veçoritë specifike të tyre | Nxënësit duhet të kuptojnë se Kosova përbëhet prej disa regjioneve të cilat dallohen për nga veçoritë natyrore, sociale, kulturore, ekonomike. | Lidhjet me gjeologjinë, morfologjinë, etnografinë |

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e gjeografisë mund të mësohet dhe të interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Zgjedhja e metodave dhe e teknikave të mësimi varet nga aftësitë psiko-motorike të nxënësve.

Baza materiale e mësimi të gjeografisë

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë mund të realizohet në tërësi duke përdorur:

- objektet mësimore (shkollën, klasën, kabinetin dhe natyrën);
- mjetet mësimore (vizuele dhe audiovizuele);
- mjetet teknike ndihmëse (dërrasa e zezë, aparatet projektuese, TV, radio etj.);
- mjetet e punës së nxënësve (libri mësimor, libër leximi i gjeografisë, fletorja e punës, atlasit gjeografik, hartat, skemat etj.);

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë kanë rëndësi të madhe, ngase lënda e gjeografisë ka karakter vizuel. Paraqitja e së vërtetës gjeografike më së shpeshti përcillet me **fjalën e gjallë** dhe me **mjete mësimore**. Kjo do të thotë se **demonstrimi** është detyrë e arsimtarit, kurse **vëzhgimi** është obligim i nxënësit. Nxënësit duhet t'i mundësohet vëzhgimi indirekt me përdorimin e:

- ❖ fotografive, filmit, emisioneve televizive, kompjuterit, modeleve, maketave, globit, hartave me shkallë të madhe (plane), të mesme, të vogël, gjeografike, fizike, shoqërore, ekonomike, memece etj.;
- ❖ vizatimeve gjeografike (vizatime lëndore, diagrame, grafikone, hartograme);
- ❖ vlerave numerike (përmes tabelave etj.);
- ❖ librave mësimorë, librave të leximit, revistave gjeografike etj.

Format e punës në mësimin e gjeografisë

Në procesin mësimor përdoren disa forma të punës e këto janë:

- forma individuale, frontale, kolektive, në grupe, në çifte;
- format e veçanta, si mësimi i programuar, mësimi i shtuar, mësimi vazhdues, aktivitetet e lira, mësimi ekipor etj;
- ekskursionet mësimore gjeografike.

Metodat dhe teknikat e punës në mësimin e gjeografisë

Varësisht nga natyra e lëndës së gjeografisë, metodat mësimore ndahen:

- **metodat verbale** (metoda parafolëse, bashkëbiseduese, dialogu dhe diskutimi);
- **metoda tekstuale;**
- **metoda demonstrative ilustrative;**
 - a) demonstrimi në mjedisin jetësor;
 - b) demonstrimi në klasë apo në kabinetin gjeografik;
 - c) vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjeografik.

Përveç metodave mësimore të lartpërmendura, gjatë procesit mësimor mund të përdoren edhe **teknika të ndryshme të mësimdhënies**, si:

- ❖ brainstormingi (stuhi mendimesh);
- ❖ diskutimi që zgjedh problemin;
- ❖ pema e mendjes (harta e mendimit, teknika klaster);
- ❖ gjuha grafike e komunikimit;
- ❖ inserti;
- ❖ tabela (harta) e koncepteve;
- ❖ grupet e ekspertëve (xhikso me ndërthurje);
- ❖ rrjeti i diskutimit;
- ❖ di-dua të diç – mësoi;
- ❖ ditari dypjesësh;

- ❖ termat paraprakë;
- ❖ diagrami i Venit.

Verifikimi i diturive të nxënësve

Verifikimi, vlerësimi dhe notimi janë ndër detyrat më të vështira të punës pedagogjike. Çdo efekt dhe rezultat i nxënësve duhet vlerësuar, por jo edhe notuar. Përkitazi me verifikimin e diturive të nxënësve duhet trajtuar këto çështje: funksionin, kohën, format, mënyrën e notimit.

Funksioni i verifikimit të diturive gjeografike

Ç’duhet verifikuar? Pa mëdyshje **sasia dhe cilësia e diturive** janë kriteri më i pranueshëm. **Nxënësi duhet të disponojë sasi të caktuar diturish gjeografike.** Nga nxënësit kërkohet të njohin:

- **faktet, objektet, dukuritë, proceset, ligjshmëritë gjeografike.**

Funksionet e verifikimit dhe të vlerësimit janë:

Verifikimi, zbulimi i zbrazësive në dijen e nxënësve, informatat kthyesë për arsimtarin. Dituritë e nxënësve **duhet verifikuar për çdo orë.** Në fazën e verifikimit **kontrollimi** mund të bëhet frontalisht duke i nxitur nxënësit më pyetje të shkurta, të shpejta, që kërkojnë dije faktike, gjeturi topografike, njohje të disa shënimeve.

Format e verifikimit

Gjatë vitit shkollor duhet zbatuar disa forma të kontrollit:

- **verifikimi me gojë** mund të jetë individual dhe grupor në çdo orë mësimore;
- **verifikimi me shkrim** mund të jetë **frontal** dhe **individual**, pastaj **përmes detyrave tekstuale-grafike.**
- Për notim veçanërisht janë të përshtatshme punimet e pavarura, referatet, zgjidhja e ndonjë problemi praktik në mënyrë të pavarur.

Vlerësimi dhe notimi

Vlerësimi dhe notimi duhet të jetë i drejtë, çdo shprehje e nxënësit me gojë, me shkrim apo praktik do të duhej vlerësuar. Vlerësimi përfshin notimin për punën dhe dijen e shfaqur. Pas vlerësimit pason notimi.

Kushtet për notim të mirë janë: besimi reciprok, koka e qetë, drejtësia, objektiviteti dhe konsekuenca e arsimit, qëndrimi vetkritik i nxënësve. Notimi duhet të jetë **publik dhe me nota të plota**. Puna duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike.

Tipat e vlerësimit

- Vlerësimi formues, përmbledhës, në bazë të kriterëve, diagnostifikues.
- Vlerësimi i brendshëm, i jashtëm, i përditshëm, paraprak, përfundimtar.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

Format e testeve janë:

- **Me gojë**
- **Me shkrim**
- **Përmes paraqitjes grafike etj.**
- Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdoren edhe mënyra të tjera, p.sh.:

Vlerësimi i eseve

Vlerësimi me dosje

Vetëvlerësimi... etj.

GJEOGRAFIA REGJIONALE E EVROPËS

Klasa VII

HYRJE

Gjeografia e Evropës ka për objekt studimi hapësirën e Evropës në tërësi, regjionet e saj në veçanti dhe shtetet veç e veç, për të nxjerrë mësim për rolin e pozitës gjeografike të regjionit dhe të vendeve, funksionin e kushteve natyrore dhe të resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik dhe jetën e njerëzve, për t'i dalluar specifikat populative, kulturore e politike.

QËLLIMET

1. Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të **njohur** pozitën gjeografike, veçoritë natyrore dhe humane të Evropës.
2. Zhvillimin e aftësive për të **kuptuar** pozitën gjeografike, veçoritë natyrore e humane, ndikimin e tyre në aktivitetin njerëzor, sfidat dhe perspektivat e ndërvarësisë regjionale.
3. Zhvillimin e **shkathtësive** dhe të **shprehive** për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave të ndryshme në situata konkrete.
4. Zhvillimin e gatishmërisë për të **përdorur** drejt dhe me **përgjegjësi** njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë.
5. Zhvillimi i **qëndrimeve** dhe i **vlerave** për laramaninë e veçorive natyrore, kushteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarive njerëzore.
6. Zhvillimin e aftësive për **respektimin e të drejtave njerëzore** për të gjithë popujt që jetojnë në Evropë, pa marrë parasysh përka-

tësinë kombëtare, fetare, gjuhësore dhe angazhimin për të kërkuar zgjidhje të problemeve lokale, regjionale, kombëtare etj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

1. Të njohë:

Faktet dhe konceptet për veçoritë natyrore dhe humane të Evropës.

Karakteristikat themelore natyrore dhe humane të Evropës, regjioneve dhe të shteteve.

2. Të kuptojë:

Specifikat gjeografike të Evropës, natyrore, sociale, ekonomike, politike.

Ngjashmëritë dhe dallimet e veçorive natyrore e humane mes regjioneve të Evropës.

3. Të zbatojë:

Grafikone, diagrame, harta etj. për elemente klimatike, hidrografike, numrin, shtimin natyror, shpërndarjen strukturat e popullsisë dhe veprimtaritë ekonomike.

Të përdorë të dhëna verbale sasiore dhe simbolike.

4. Të analizojë:

Rëndësinë e veçorive natyrore dhe humane të Evropës, regjioneve dhe shteteve.

Shkaqet e vërteta të dukurive fizike dhe humane të Evropës së sotme, si: ngrohjen globale, problemin e ujit, erozionit, ndotjes, rritjes së shpejtë të popullsisë ose të plakjes së saj, problemin e refugjatëve, zhvillimin e pabarabartë ekonomik etj.

5. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:

Për laramaninë e veçorive natyrore, të kushteve të ndryshme të jetesës dhe të veprimtarive njerëzore.

Në kuptimin e sjelljeve personale për të qenë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.

Struktura e përmbajtjeve programore
2-orë në javë- 90 ditë mësimi- 18 javë -36 orë gjithsej.

| Kategoria:Regjioni | | Numri i orëve | % |
|---|---|------------------------------|---------------|
| Nënkategoria (temat mësimore):Evropa | | | |
| Gjeografia regionale e Evropës | | | |
| Nr. i temave | | | |
| 1. | Vështrim i përgjithshëm për kontinentin e Evropës | 4 | 11.11% |
| 2. | Evropa Jugore - Veçoritë natyrore, popullore dhe ekonomike. Shtetet e Evropës Jugore | 8 | 22.22% |
| 3. | Evropa e Mesme - Tiparet natyrore, popullore dhe ekonomike. Shtetet e Evropës së Mesme. | 6 | 16.66% |
| 4. | Evropa Perëndimore - Karakteristikat popullore dhe ekonomike. Shtetet e Evropës Perëndimore | 5 | 13.88% |
| 5. | Evropa Veriore dhe Verilindore - Specifikat e natyrës, të popullsisë dhe të ekonomisë. Shtetet e Evropës Veriore dhe Verilindore | 3 | 8.33% |
| 6. | Evropa Lindore dhe BSHP, natyra, popullsia dhe ekonomia. Shtetet e Evropës Lindore dhe BSHP | 4 | 11.11% |
| | Vlerësim diturish | 2 | 5.55% |
| | Përsëritje | 4 | 11.11% |
| | Gjithsej orë | 36 | 100% |

| Kategoria | Nënka- tegoria | Përmbajtjet programore | Rezultatet e pritshme | Lidhjet ndërlëndore |
|------------------|---------------------------|---|---|--|
| Regjioni | Evropa | Kuptimi i regjionit | - Nxënësi duhet t'i kuptojë dhe t'i zbatojë kriteret për ndarjen e regjioneve. | Regjioni i ndërlidh të gjitha disiplinat gjeografike |
| | | Evropa si tëresi regjionale. - Pozita, madhësia, përkufizimi - Veçoritë relievore, klimatike, hidrografike, biogjeografike. - Karakteristikat demografike, kulturore, ekonomike dhe politike. | - Të dijë t'i përcaktojë kufijt e Evropës dhe t'i tregojë përparësitë e pozitës. - T'i identifikojë gatishujt dhe ishujt e mëdhenj. - T'i gjejë në hartë sistemet malore, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura. - T'i dallojë tipat e klimës në kontinent dhe shtrirjen e tyre. - T'i gjejë lumenjtë dhe liqenet më të njohura. - T'i dallojë grupet dhe popujt e mëdhenj, gjuhët, fetë dhe racat. - T'i dallojë shtetet unitare, federale, publikane dhe mbretëritë. | Ndërlidhja me disiplinat fizike dhe humane - gjeografike, kulturore, ekonomike e politike. |
| | | Evropa Jugore - Pozita gjeografike, shtrirja territoriale. - Veçoritë relievore, seizmike, klimatike, hidrografike dhe biogjeografike. | - T'i tregojë gatishujt dhe shtetet e Evropës Jugore. - T'i gjejë në hartë sistemet malore, fushat më të njohura. - Të arsyetojë praninë e vullkaneve dhe tërmeteve. | Ndërlidhja mes disiplinave gjeografike, gjeologjisë, biologjisë, ekologjisë. |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat populatave, kulturore, ekonomike dhe politike. - Shtetet e Evropës Jugore: Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Bullgaria, Bosna & Hercegovina, Serbia & Mali i Zi, Kroacia, Rumania, Italia, Spanja & Portugalia, Malta, Qipro. | <ul style="list-style-type: none"> - T'i njohë veçoritë themelore të klimës mesdhetare. - Të arsyetojë mungesën e lumenjve dhe gjatësinë e vogël të tyre. - Të tregojë llojet e bimëve rreth Mesdheut. - T'i dallojë popujt që banojnë rreth Mesdheut. - T'i gjejë në hartë qytetet më të njohura. - T'i dallojë qendrat më të njohura turistike. - T'i njoh shtetet e Evropës Jugore, kufizimin e tyre, veçoritë tipike të natyrës, popujt që i banojnë dhe tiparet kryesore ekonomike. | <p>Njohja e problemeve populatave, kulturore, politike e juridike, kërkon njohuri historike, juridike, ekonomike.</p> |
| | <p>Evropa e Mesme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita gjeografike. - Tërësitë relievoe. - Klima kalimtare. - Hidrografia e pasur dhe zonat biogjeografike. - Veçoritë populatave, kulturore e ekonomike. - Shtetet e Evropës së Mesme: Sllovenia, Austria, Zvicra, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Gjermania, Polonia. | <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi të kuptojë pozitën qendrore. - Të numërojë malet dhe ultësirat. - T'i veçojë specifikat e klimës. - Të tregojë lumenjtë dhe liqenet më të njohura. - Të tregojë në hartë vendburimet e xeheve më të njohura. - T'i radhisë popujt më të mëdhenj. - Të tregojë në zhvillimin ekonomik përmes të ardhurave për banor. - T'i shprehë specifikat natyrore, populatave, kulturore e ekonomike të shteteve të Evropës së Mesme. | <p>Për t'i gjetur specifikat regjionale, nevojitet kombinimi i njohurive gjeografike, gjeologjike, demografike, kulturore, ekonomike e politike.</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | <p>Evropa Perëndimore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita e rëndësishme gjeografike. - Relievi kryesisht i ulët. - Klima e lagët. - Pasuria me ujëra. - Peizazhi i gjelbër. - Regjioni i banuar dendur, shtimi i ulët. - Niveli i lartë kulturor e ekonomik. <p>Shtetet e Evropës Perëndimore: Britania e Madhe, Irlanda, Franca, Belgjika, Holanda, Luksemburgu.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë pse pozita është e mirë. - Të arsyetojë pse relievi është kryesisht i ulët. - Të sqarojë rolin e oqeanit në klimë dhe vegetacion. - Të shpjegojë rrjetin e lumenjve me ujë, që rrjedhin ngadalë, që janë të lundrueshëm. - Të identifikojë pasuritë natyrore. - Të arsyetojë dendësinë e lartë të popullsisë dhe nivelin e lartë të zhvillimit ekonomik e kulturor. - T'i përshkruajë specifikat natyrore, popullore, kulturore, ekonomike të vendeve të Evropës Perëndimore. | <p>Ndërlidhja gjeologji, geomorfologji, klimatologji, hidrografi, bio e zoogjeografi, ekonomi, kulturë e politikë.</p> |
| | <p>Evropa Veriore dhe Verilindore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita skajore me lidhje të mira. - Relievi karakteristik. - Klima specifike. - Pasuria me ujëra. - Vegetacioni tipik. - Specifikat kulturore, popullore dhe ekonomike. <p>Shtetet e Evropës Veriore dhe Verilindore: Danimarka, Islan-</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Të përkufizojë regjionin dhe shtetet. - Të shquajë rolin e akullnajave në transformimin e relievit. - Të ilustrojë dallimet në klimë në perëndim dhe në lindje të regjionit. - Të tregojë rolin e lumenjve dhe të liqeneve në ekonomi. - T'i veçojë tipat e vegetacionit. - T'i dallojë popujt dhe kulturat e tyre. - Të arsyetojë nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik. - Të tregojë në dallimet dhe ngjashmëritë e | |

| | | | |
|--|---|---|--|
| | da, Norvegjia, Suedia, Finlanda, Estonia, Letonia, Lituania. | natyrës, kulturave dhe nivelit të zhvillimit mes shteteve të regjionit. | |
| | <p>Evropa Lindore me BSHP</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozita skajore, madhësia e territorit, lidhjet e dobëta. - Sistemet e mëdha malore, ultësirat e mëdha. - Klima nën ndikimin e viseve polare, deteve të ftohta, sipërfaqeve të mëdha. - Hidrografia me shumë dete, liqene, lumenj të gjatë e të mëdhenj. - Breza tipikë vegjetativë dhe zoogeografikë - Pasuri e madhe mineralesh. - Regjion me shumë popuj e kultura të ndryshme. - Ekonomia me shumë probleme. <p>Shtetet e Evropës Lindore dhe BSHP-ja</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rusia, Bellorusia, Ukraina, Moldavia, Armenia, Gruzia, Azerbejxhani, Turkmenia, Uzbekistani, Taxhikistani, Kirgistani dhe Kazakistani. | <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi të bejë përkufizimin e Evropës Lindore dhe grup-shteteve në Kaukaz dhe Azinë Qendrore. - Të emërtojë tërësitë e mëdha relievore, sistemet malore e ultësirat. - T'i dallojë specifikat klimatike në pjesët e ndryshme të këtij territori. - T'i numërojë lumenjtë dhe liqenet më të njohura. - T'i dallojë brezat vegjetativë në lidhje me klimën. - T'i radhisë popujt më të mëdhenj dhe të tregojë në dallimet dhe ngjashmëritë e tyre. - Të tregojë në hartë qendrat më të mëdha urbane të kësaj hapësire. - T'i radhisë shtetet sipas lartësisë së të ardhurave dhe shkallës së urbanizimit. - Të tregojë në specifikat natyrore, populative, kulturore e ekonomike të shteteve të Evropës Lindore dhe BSHP-së. | |

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e gjeografisë mund të mësohet dhe të interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Zgjedhja e metodave dhe e teknikave të mësimi varet nga aftësitë psiko-motorike të nxënësve.

Baza materiale e mësimi të gjeografisë

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë mund të realizohet në tërësi duke përdorur:

- objektet mësimore (shkollën, klasën, kabinetin dhe natyrën);
- mjetet mësimore (vizuele dhe audiovizuele);
- mjetet teknike ndihmëse (dërrasa e zezë, aparatet projektuese, TV, radio etj.);
- mjetet e punës së nxënësve (libri mësimor, libër leximi i gjeografisë, fletorja e punës, atlasit gjeografik, hartat, skemat etj.);

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë

Mjetet e konkretizimit në mësimin e gjeografisë kanë rëndësi të madhe, ngase lënda e gjeografisë ka karakter vizuel. Paraqitja e së vërtetës gjeografike më së shpeshti përcillet me **fjalën e gjallë** dhe me **mjete mësimore**. Kjo do të thotë se **demonstrimi** është detyrë e arsimtarit, kurse **vëzhgimi** është obligim i nxënësit. Nxënësit duhet t'i mundësohet vëzhgimi indirekt me përdorimin e:

- ❖ fotografive, filmit, emisioneve televizive, kompjuterit, modeleve, maketave, globit, hartave me shkallë të madhe (plane), të mesme, të vogël, gjeografike, fizike, shoqërore, ekonomike, memece etj.);
- ❖ vizatimeve gjeografike (vizatime lëndore, diagrame, grafikone, hartograme);
- ❖ vlerave numerike (përmes tabelave etj.);
- ❖ librave mësimorë, librave të leximit, revistave gjeografike etj.

Format e punës në mësimin e gjeografisë

- Në procesin mësimor përdoren disa forma të punës e këto janë:
- forma individuale, frontale, kolektive, në grupe, në çifte;

- format e veçanta, si mësimi i programuar, mësimi i shtuar, mësimi vazhdues, aktivitetet e lira, mësimi ekipor etj;
- ekskursionet mësimore gjeografike.

Metodat dhe teknikat e punës në mësimin e gjeografisë

Varësisht nga natyra e lëndës së gjeografisë, metodat mësimore ndahen:

- **metodat verbale** (metoda parafolëse, bashkëbiseduese, dialogu dhe diskutimi);
- **metoda tekstuale;**
- **metoda demonstrative ilustrative;**
 - a) demonstrimi në mjedisin jetësor;
 - b) demonstrimi në klasë apo në kabinetin gjeografik;
 - c) vëzhgimi i drejtpërdrejtë gjeografik.

Përveç metodave mësimore të lartpërmendura, gjatë procesit mësimor mund të përdoren edhe **teknika të ndryshme të mësimdhënies**, si:

- ❖ brainstormingi (stuhi mendimesh);
- ❖ diskutimi që zgjidh problemin;
- ❖ pema e mendjes (harta e mendimit, teknika klaster);
- ❖ gjuha grafike e komunikimit;
- ❖ inserti;
- ❖ tabela (harta) e koncepteve;
- ❖ grupet e ekspertëve (xhikso me ndërthurje);
- ❖ rrjeti i diskutimit;
- ❖ di-dua të diç – mësoi;
- ❖ ditari dypjesësh;
- ❖ termat paraprakë;
- ❖ diagrami i Venit.

Verifikimi i diturive të nxënësve

Verifikimi, vlerësimi dhe notimi janë ndër detyrat më të vështira të punës pedagogjike. Çdo efekt dhe rezultat i nxënësve duhet vlerësuar, por jo edhe notuar. Përkitazi me verifikimin e diturive të nxënësve duhet trajtuar këto çështje: funksionin, kohën, format, mënyrën e notimit.

Funksioni i verifikimit të diturive gjeografike

Ç'duhet verifikuar? Pa mëdyshje **sasia dhe cilësia e diturive** janë kriteri më i pranueshëm. **Nxënësi duhet të disponojë sasi të caktuar diturish gjeografike.** Nga nxënësit kërkohet të njohin:

- **faktet, objektet, dukuritë, proceset, ligjshmëritë gjeografike.**

Funksionet e verifikimit dhe vlerësimit janë:

Verifikimi, zbulimi i zbrazësive në dijen e nxënësve, informatat kthyesë për arsimtarin. Dituritë e nxënësve **duhet verifikuar për çdo orë.** Në fazën e verifikimit **kontrollimi** mund të bëhet frontalisht duke i nxitur nxënësit me pyetje të shkurta, të shpejta, që kërkojnë dije faktike, gjeturi topografike, njohje të disa shënimeve.

Format e verifikimit

Gjatë vitit shkollor duhet zbatuar disa forma të kontrollit:

- **verifikimi me gojë** mund të jetë individual dhe grupor në çdo orë mësimore;
- **verifikimi me shkrim** mund të jetë **frontal** dhe **individual**, pastaj **përmes detyrave tekstuale-grafike.**
- Për notim veçanërisht janë të përshtatshme punimet e pavarura, referatet, zgjidhja e ndonjë problemi praktik në mënyrë të pavarur.

Vlerësimi dhe notimi

Vlerësimi dhe notimi duhet të jetë i drejtë, çdo shprehje e nxënësit me gojë, me shkrim apo praktik do të duhej vlerësuar. Vlerësimi përfshin notimin për punën dhe dijen e shfaqur. Pas vlerësimit pason notimi.

Kushtet për notim të mirë janë: besimi reciprok, koka e qetë, drejtësia, objektiviteti dhe konsekuenca e arsimtarit, qëndrimi vetëkritik i nxënësve. Notimi duhet të jetë **publik dhe me nota të plota.** Puna duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike.

Tipat e vlerësimit

- *Vlerësimi formues, përmbledhës, në bazë të kritereve, diagnostifikues.*
- *Vlerësimi i brendshëm, i jashtëm, i përditshëm, paraprak, përfundimtar.*

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë
- Detyrat e shtëpisë
- Testet

Format e testeve janë:

- **Me gojë**
- **Me shkrim**
- **Përmes paraqitjes grafike etj.**
- Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdoren edhe mënyra të tjera, p.sh.:
 - Vlerësimi i eseve**
 - Vlerësimi me dosje**
 - Vetëvlerësimi... etj.**

HISTORI

Klasa VI

HYRJE

Mësimi intensiv mbështetet në kriteret e përcaktuara për këtë formë të mëimit, për nxënësit të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të përfshihen në arsimin e rregullt. Lënda e historisë edhe në këtë formë të mëimit ka rëndësinë e saj të veçantë.

Me lëndën e historisë në klasën VI synohet që nxënësit të njohin të kaluarën e shoqërisë njerëzore nga kohërat më të lashta e deri në mesjetën e zhvilluar (shekullin XI). Përmes lëndës së historisë mundësohet zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të nxënësve si nga aspekti human, ekonomik, shoqëror, kulturor, politik etj.

Përmes lëndës së historisë në klasën VI pretendohet të zhvillohet të menduarit kritik të nxënësit si dhe të nxitet përvetësimi dhe përdorimi i informacioneve historike në situatat e jetës së përditshme.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën VI, arsimit intensiv, ka për qëllim:

- Aftësimin e nxënësve për të njohur dhe për të kuptuar rrjedhojat dhe ligjshmëritë e zhvillimeve shoqërore historike të shoqërisë njerëzore nga parahistoria e deri në mesjetën e zhvilluar (shekulli X).
- Zhvillimin e aftësive për të kuptuar mënyrën e jetesës dhe të menduarit e njerëzve, rolin e personaliteteve të njohura, ngjarjet e rëndësishme historike, zhvillimin e vendeve, kulturave të ndryshme si dhe besimin e popujve të ndryshëm, që nga lindja e shoqërisë njerëzore e deri në mesjetën e zhvilluar.
- Zhvillimin e autonomisë, tolerancës, vetërespektit dhe respektit për të tjerët, duke përdorur informacionet historike në jetën e përditshme.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të njohin:

- Domethëniet e termave dhe të koncepteve themelore historike nga parahistoria e deri te feudalizmi i zhvilluar si nga historia kombëtare ashtu edhe nga ajo botërore.
- Kuptimin e ndërlidhjeve dhe të ndikimeve të ndërsjellta në shoqëri.

Të kuptojnë:

- Ecuritë e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, kulturore të shoqërisë njerëzore gjatë atyre periudhave historike.
- Të arriturat kryesore tekniko-shkencore që pati njerëzimi në atë kohë.

Të identifikojnë:

- Mënyrën e jetesës dhe të menduarit të njerëzve dhe rolin e personaliteteve kyësore politike, ushtarake, kulturore e shkencore nga historia kombëtare dhe ajo botërore.

Të zbatojnë:

- Shprehitë dhe shkathtësitë për shfrytëzimin e dokumenteve, burimeve, materialeve, hartave historike, fotografive, albumeve, teksteve historike, historisë gojore etj.
- Njohuritë dhe përvojat e fituara për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri.

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera:

- Të çmojnë të arriturat e shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave.
- Të respektojnë vlerat kombëtare dhe vlerat e popujve të tjerë.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen dhe kujdesin për trashëgiminë arkeologjike, monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE 18 x 2 = 36 orë (25 orë zhvillim, 3 orë në dispozicion dhe 8 orë përsëritje)

| Kategoria | Nënkategoritë | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritura | Ndërlidhja lëndore |
|----------------------------|---------------------------------------|---|--|---|
| I. PARA-HISTORIA | 1. Bashkësitë e para njerëzore | <i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i> Njerëzit e parë - Ç` farë studion historia ? Njesimi i kohës dhe Periodizimi i historisë. - Njerëzit e parë (Koha e gurit dhe Koha e metaleve). (2 orë) | <i>Nxënësi:</i> Të dallojë specifikat kryesore të lëndës së historisë dhe të dijë për llogaritjen e kohës Krijojë koncepte të qarta për jetën e njerëzve në kohën e gurit dhe të metaleve. | <i>Me:</i> Arkeologjinë, artet, matematikën, gjeografinë, etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 1. Lindja e Lashtë | Lindja e Lashtë - Shtetet e Lindjes së Lashtë (Egjipti, Mesopotamia, Kina, India dhe Persia) (1 orë) | Të dallojë karakteristikat kryesore të shteteve të para. Të përshkruajë jetën shoqërore-ekonomike të kohës. | Arkeologjinë, mitologjinë, gjeografinë, artet, matematikën, letërsinë etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 3. Kultura dhe besimi | Kultura dhe besimi - Kultura dhe besimi te popujt e Lindjes së Lashtë. (1 orë) | Njohin kulturën dhe format e besimit të këtyre popujve. | Letërsinë, arkeologjinë, mitologjinë, gjeografinë etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 2. Mesdheu në Antikitët | Greqia e Vjetër - Greqia në kohët më të her shme. - Qytet-shtetet greke, Athina dhe Sparta (2 orë) | Të dallojë specifikat kryesore të organizimit shoqëror e shtetëror grek. Të kuptojnë dallimet e organizimit shtetëror të Athinës | Filozofinë, letërsinë, artin, edukatën fizike, arkitekturën, edukatën qytetare, |

| | | | | |
|----------------------------|--------------------------------|---|---|--|
| | | | dhe të Spartës, Luftërat e Peleponezit etj. | matematikën, gjeografinë etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 2. Mesdheu në Antikitët | Maqedonia e Lashtë - Maqedonia - Filipi II dhe Leka i Madh (1 orë) | Dallon pikëpamjet për origjinën e maqedonasve të lashtë. Njeh specifikat e shtetit në kohën e Filipit II dhe Lekës së Madh. Dallon karakteristikat kryesore të kulturës helene. | Arkeologjinë, artet, gjeografinë, arkitekturën, letërsinë, filozofinë etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 2. Mesdheu në Antikitët | Roma e Vjetër - Roma nga kohët më të hershme e deri te shpallja Perandori. - Historia e Perandorisë Romake - Kriza dhe shthurja e Perandorisë (2 orë) | Njohin fazat e zhvillimit të Romës. Dallon ndryshimet dhe progresin shoqëror dhe shtetëror. Dallon raportet mes shtresave shoqërore. Mund të shpjegojnë për betejat dhe zgjerimet e shtetit romak. | Artin, gjeografinë, edukatën qytetare, filozofinë, letërsinë etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 3. Kultura dhe besimi | Kultura dhe besimi - Kultura dhe besimi të grekët e vjetër. - Kultura dhe besimi romak. (2 orë) | Dallojnë karakteristikat themelore të kulturës dhe të besimit grek. Dinë për Lojërat Olimpikë antike greke. Njohin personalitetet kryesore greke. Njohin karakteristikat kryesore të besimit dhe të kulturës romake. Dinë për paraqitjen dhe përhapjen e krishterimit të romakët. Njohin oratorët, filozofët, | Artin, gjeografinë, edukatën qytetare, filozofinë, letërsinë etj. |

| | | | | |
|----------------------------|--|--|--|---|
| | | | poetët dhe personalitetet e tjera me rëndësi romake. | |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 2. Mesdheu në Antikit | Iliria - Ilirët, origjina, vendbanimet dhe fiset kryesore - Mbretëria e Enkeleasve, e Taulantëve dhe e Epirit - Mbretëria Ardiane - Mbretëria Dardane - Jeta ekonomike dhe shoqërore të Ilirët - Ilirët nën sundimin romak, Kryengritja e madhe ilire e viteve 6-9. (6 orë) | Dinë për origjinën dhe fiset kryesore ilire. Njohin shtetet ilire dhe shtrirjen e tyre. Njohin dhe kuptojnë kushtet ekonomike dhe shoqërore tek ilirët. Kuptojnë pozitën e ilirëve nën sundimin romak dhe mund të interpretojnë rrjedhojat e kryengritjeve ilire. | Arkeologjinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj. |
| II. PERIUDHA ANTIKE | 3. Kultura dhe besimi | Kultura dhe besimi - Kultura dhe besimi tek ilirët (1 orë) | Dallojnë karakteristikat themelore të kulturës dhe besimit ilir, njohin perënditë kryesore ilire. Njohin personalitetet e shquara ilire dhe rolin që kanë luajtur ato. | Arkeologjinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj. |
| III. MESJETA | 1. Jeta ekonomike, politike dhe institucionet shtetërore në Evropën Perëndimore | Mesjeta e hershme - Dyndjet e popujve në Evropë dhe krijimi i shtetit të frankëve. (1 orë) | Dijnë për ndryshimet shoqërore të feudalizmit të hershëm. Kuptojnë rrethanat e formimit dhe të zhvillimit të shtetit frank. | Gjeografinë, artet, letërsinë, gjuhët evropiane. |

| | | | | |
|---------------------|---|--|--|---|
| III. MESJETA | 2. Bizanti, arabët dhe turqit në mesjetë | Bizanti, arabët - Perandoria Bizantine deri në shek. XI - Arabët-Lindja e islamizmit (2 orë) | Kuptojnë veçoritë themelore të Perandorisë Bizantine. Dijne për arabët në mesjetë, kulturën e tyre dhe shfaqjen e islamizmit. | Gjeografinë, artet, letërsinë, muzikën, matematikën, edukatën qytetare etj. |
| III. MESJETA | 3. Ballkani gjatë mesjetës | Ballkani gjatë mesjetës - Arbërit nën Perandorinë Bizantine. - Ardhja e sllavëve në Ballkan. - Shtetet e sllavëve të Jugut në mesjetën e hershme dhe kultura e tyre. (3 orë) | Dinë për pozitën e arbërve nën sundimin bizantin. Organizimin administrativ të tokave arbërore. Për kulturën e arbërit dhe rolin e personaliteteve arbërore në Perandorinë Bizantine. Kuptojnë mënyrën dhe pasojat e vendosjes së sllavëve në Ballkan. Krahasojnë shtetet sllave të asaj kohe. | Arkeologjinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj. |
| III. MESJETA | 3. Kultura dhe besimi | Kultura - Kultura arbërore. (1 orë) | Analizojnë veçoritë kryesore të kulturës arbërore në mesjetën e hershme. | Gjeografinë, gjuhën dhe letërsinë, artin, muzikën etj. |

Vërejtje: 3 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të zgjedhë ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohen edhe vizita në ndonjë institucion ose vend kulturor-historik (arkiva, muze, biblioteka, institute, monumente etj.).

HISTORI

Klasa VII

HYRJE

Mësimi intensiv mbështetet në kriteret e përcaktuara për këtë formë të mëimit, për nxënësit të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të përfshihen në arsimin e rregullt. Lënda e historisë edhe në këtë formë të mëimit ka rëndësinë e saj të veçantë.

Me programin e lëndës së historisë, për arsimin intensiv, në klasën VII pretendohet të bëhet njohja e nxënësve për rrjedhojat e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore nga shekulli XI deri në fillim të shekullit XIX (1814).

Përmes lëndës së historisë mundësohet zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të nxënësve si nga aspekti human, ekonomik, shoqëror, kulturor, politik etj.

Lënda e historisë në klasën VII, të arsimit intensiv, synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe hulumtimin dhe përdorimin e burimeve historike, duke dalluar rëndësinë e tyre.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën VII, arsimit intensiv, ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të njohur dhe kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore prej shekullit XI deri më 1814.
- Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe kuptuar mënyrat e jetesës, të menduarit, personalitetet historike, vendet dhe institucionet shoqërore e shtetërore, besimet, të arriturat ekonomike, shkencore, kulturore etj.

- Zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive të nevojshme për njohjen, kuptimin, përpunimin dhe zbatimin e të dhënave të ndryshme historike në situata të caktuara.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të njohin:

- Domethëniet e termave historikë nga mesjeta dhe koha e re.

Të kuptojnë:

- Karakteristikat e feudalizmit të zhvilluar dhe karakteristikat e kapitalizmit.
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze etj., nga shekulli XI e deri më 1814.

Të identifikojnë:

- Mënyrën e jetesës dhe të menduarit të njerëzve dhe rolin e personaliteteve kryesore politike, ushtarake, kulturore e shkencore nga historia kombëtare dhe ajo botërore.

Të zbatojnë:

- Informacionet historike për zgjidhjen e situatave të ndryshme që paraqiten në shoqëri.
- Format e mundshme për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri.

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera:

- Çmuarjen e të arriturave të shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen dhe kujdesin për trashëgiminë arkeologjike, monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE 18 x 2 = 36 orë (25 orë zhvillim, 3 orë në dispozicion dhe 8 orë përsëritje)

| Kategoria | Nënkategoria | Përmbajtja programore | Rezultatet e pritshme | Ndërlidhjet programore |
|---------------------|--|---|---|--|
| III. MESJETA | 1. Jeta ekonomike, politike dhe institucionet shtetërore në Evropën Perëndimore | Nxënësit duhet të mësojnë për: Shoqëria në mesjetën e zhvilluar - Shoqëria, zhvillimi i qyteteve mesjetare. - Luftërat kryqtare. (2 orë) | Nxënësit: Dinë karakteristikat e shoqërisë në feudalizmin e zhvilluar, mënyrën e organizimit të jetës në qytetet e fshatra. Kuptojnë shkaqet dhe pasojat e luftërave kryqtare, zhvillimin kulturor etj. | Me: Gjeografinë, edukatën qytetare, artin, letërsinë etj. |
| III. MESJETA | 1. Jeta ekonomike, politike dhe institucionet shtetërore në Evropën Perëndimore | Evropa në shekujt XI - XV - Shtetet kryesore të Evropës Perëndimore: Franca, Anglia, shtetet gjermane. - Shtetet italiane, Spanja dhe Portugalia gjatë kësaj periudhe. (2 orë) | Dinë për shtetet kryesore të Evropës, zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror, marrëdhëniet e ndërsjella mi dis tyre si dhe specifika të tjera. Identifikojnë personalitetet më të njohura të kohës, të arriturat ekonomike, kulturore, shkencore etj. | Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë etj. |
| III. MESJETA | 4. Lindja e Largët gjatë mesjetës | Peradoritë e Mëdha të Lindjes Krijimi dhe zhvillimi i Shtetit Osman. (1 orë) | Kuptojnë veçoritë shoqërore, ekonomike dhe kulturore të fazës së krijimit të Shtetit Osman. | Letërsinë, artin, gjeografinë etj. |

| | | | | |
|----------------------|---|--|---|---|
| | 3. Ballkani gjatë mesjetës | <p>Arbëria në shekujt XI - XV</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i Shtetit të Arbërit. - Pushtimet e Rashës. - Principatat shqiptare në shekujt XII- XIV. - Pushtimet osmane dhe Beteja e Kosovës (1389). Pengmarrja dhe rekrutimi i fëmijëve nga osmanët. - Lufta e Skënderbeut kundër osmanëve, Kuvendi i Lezhës. - Marrëdhëniet e Skënderbeut me Evropën, Skënderbeu si personalitet historik. <p>(6 orë)</p> | <p>Dinë për zhvillimet në Arbëri, Shtetin e Arbërit, Principatat shqiptare, Pushtimet e Rashës. Kuptojnë rrethanat në të cilat u zhvillua dhe ndryshimet që solli në Ballkan Beteja e Kosovës (1389). Njohin sistemin e pengmarrjes së fëmijëve dhe rekrutimin e tyre nga ushtria osmane. Dinë për qëndresën e popullit shqiptar, shtetin e Skënderbeut, figurën dhe rolin e tij në historinë kombëtare dhe botërore.</p> | <p>Letërsinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj.</p> |
| III. MESJETA | 5. Arsimi dhe kultura në mesjetë | <p>Kultura</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kultura dhe monumentet kulturoro-historike të periudhës bizantine në Arbëri. <p>(1 orë)</p> | <p>Dallojnë monumentet kryesore kulturoro-historike të periudhës bizantine në trojet shqiptare</p> | <p>Letërsinë, artin, muzikën, gjeografinë, edukatën qytetare etj.</p> |
| IV. KOHA E RE | 1. Rilindja, Reforma dhe Kundërreforma | <p>Humanizmi dhe Rilindja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Humanizmin dhe Rilindja, humanistët kryesorë evropianë e shqiptarë të kësaj periudhe. <p>(1 orë)</p> | <p>Dinë raportet dhe faktorët që ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e ideve humaniste dhe të Rilindjes. Dinë për përfaqësuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje në Evropë dhe te shqiptarët.</p> | <p>Letërsinë, artin, edukatën qytetare etj.</p> |
| | | | | |

| | | | | |
|---------------|---|---|---|---|
| | | Reforma dhe Kundërreforma katolike - Reforma dhe Kundërreforma katolike (1 orë) | Dinë shkaqet që ndikuan në fillimin e reformave kishtare. Dinë karakteristikat themelore të procesit të reformave dhe kundërreformave. Dinë pasojat e fushatës së kundërreformacionit. | Gjeografinë, letërsinë, artin, edukatën qytetare etj. |
| IV. KOHA E RE | 2. Zbulimet e mëdha gjeografike | Zbulimet e mëdha gjeografike - Zbulimet e mëdha gjeografike. (1 orë) | Dinë për zbulimet e mëdha dhe rëndësinë e tyre, për rrjedhat e mëvonshme të zhvillimit shoqëror që sollën ato. | Gjeografinë, artin, teknologjinë, fizikën, matematikën etj. |
| IV. KOHA E RE | 3. Evropa gjatë kohës së re | Mbretëritë e mëdha evropiane - Anglia dhe Franca gjatë shekujve XV – XVII. (1 orë) | Dinë për zhvillimet ekonomike të shteteve evropiane në shekujt XV-XVII. Dinë për rregullimet shtetërore dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Dinë esencën e marrëdhënieve shoqërore, duke pasur për bazë shoqërinë angleze dhe atë franceze. | Gjeografinë, edukatën qytetare etj. |
| IV. KOHA E RE | 6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika | Idetë e reja përparimtare – Iluminizmi Iluminizmi si rrymë e re mendore e kulturore - përfaqësuesit kryesorë. (1 orë) | Dinë për kushtet dhe rrethanat në të cilat u shfaq iluminizmi. Dinë për personalitetet kryesorë të kësaj lëvizje, për ndikimin e saj në rrjedhat shoqërore, posaçërisht në ato kulturore. | Letërsinë, artin, edukatën qytetare etj. |

| | | | | |
|----------------------|--|---|--|--------------------------------------|
| | 4. Perandoria Osmane dhe Ballkani | <p>Shqiptarët në shekujt XVI-XVIII</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëndresën e shqiptarëve gjatë shekujve XVI-XVII. - Pashallëqet shqiptare, - Personalitetet e njohura shqiptare në historinë e Perandorisë Osmane. <p>(3 orë)</p> | <p>Dinë për pozitën e shqiptarëve nën sundimin osman dhe qëndresën e shqiptarëve. Kuptojnë formimin, rolin e rëndësinë e pashallëqeve shqiptare.</p> <p>Dinë për marrëdhëniet e pashallëqeve shqiptare me popujt fqinjë dhe me shtetet e Evropës.</p> <p>Dallojnë personalitetet kryesore shqiptare që lanë gjurmë në historinë e Perandorisë Osmane</p> | Gjeografinë, artin, letërsinë etj. |
| IV. KOHA E RE | 6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika | <p>Arti, kultura, besimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Arti dhe kultura, përhapja e islamizmit në trojet shqiptare. - Monumentet kulturo-historike të periudhës osmane në trojet shqiptare. <p>(2 orë)</p> | <p>Dinë për kulturën, përhapjen e islamizmit të shqiptarët. Njohin disa nga monumentet kryesore kulturoro-historike të periudhës osmane në trojet shqiptare.</p> | Gjeografinë, artin, letërsinë etj. |
| IV. KOHA E RE | 5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohës së re | <p>Revolucioni në Amerikën Veriore</p> <p>Revolucioni amerikan – krijimi i SHBA-ve.</p> <p>(1 orë)</p> | <p>Dinë kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të revolucionit në Amerikë.</p> <p>Kanë kuptuar raportet shoqërore që lindën pas përfundimit të revolucionit në Amerikë.</p> | Gjeografinë, edukatën qytetare, etj. |

| | | | | |
|--|------------------------------------|---|---|-------------------------------------|
| | 3. Evropa gjatë kohës së re | Revolucioni në Francë. - Revolucion i borgjez francez. - Perandoria e Napoleon Bonapartit dhe rënia e saj. (2 orë) | Dinë kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të revolucionit në Francë. Kanë kuptuar raportet shoqërore që lindën pas përfundimit të revolucionit në Francë. Dinë për Perandorinë e Napoleon Bonapartit, për fuqizimin dhe zgjerimin e shtetit të tij si dhe për shkaqet e rënies së kësaj Perandorie, pasojat dhe anët pozitive të saj. | Gjeografinë, edukatën qytetare etj. |
|--|------------------------------------|---|---|-------------------------------------|

Vërejtje: 3 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.).

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënies përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe të objektivave që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën, në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore me nxënësin në qendër sugjerohen metoda, forma dhe teknika të tilla si:

Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:

Puna me tërë klasën,

Puna me grupe (të mëdha ose të vogla)

Puna me çifte

Puna individuale

Metodat:

E mësimdhënies - (kallëzimi, shpjegimi, ligjërrata, biseda, demonstrimi etj.).

E të mësuarit - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe e nxënësve dhe përdoret për arrijtjen e qëllimeve, synimeve, objektivave etj.

E të nxënies - (vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës, shkëmbimi i mendimeve etj.).

Kërkimore - është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike nëpërmjet burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

Teknikat:

Ekziston numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa prej tyre.

- **Brainstormingu** (“stuhi, mendimesh“, gjenerim idesh)- është teknikë efektive që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.

- **Klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)** - nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar. Zakonisht shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.
- **INSERT-i - (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm)**. Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që e lexon.
- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë, e cila ka pesë vargje që kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës.
- **Xhigsou (Ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga nxënësit, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknika të tjera janë: **ditari dypjesësh, di – dua, të dijë, mësova, ese 5 dhe 10, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit, shkrimi i lirë etj.**

Historia gojore është gjithashtu një nga mënyrat bashkëkohore të të mësuarit të lëndës së historisë.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturoro-historike etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në ç'shikallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëheqës.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve.
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor.
3. T'i motivojë nxënësit.

4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuar.
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Tipat e vlerësimit

Ekzistojnë tipa të larmishëm të vlerësimit, si:

- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuar para parake dhe objektivat e parashikuar.
- **Vetëvlerësimi** është proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informatave dhe të veprimtarisë që nxënësi e bën vetë me ndonjë mjet vlerësues.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies, p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti etj.
- **Vlerësimi në bazë të kritereve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara, p.sh., krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.
- **Vlerësimi formues dhe diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimitdhënësi planifikon punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.

- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi në proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrolli i zakonshëm i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*
- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.
- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherit mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- *Me gojë*
- *Me shkrim*
- *Përmes paraqitjes grafike etj.*

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anë të negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.:

- *Vlerësimi i eseve*
- *Vlerësimi me dosje*
- *Vetëvlerësimi etj.*

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE:

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997.
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995.
3. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999.
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003.
6. MASHT, Plani dhe programi mësimor 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003
7. MASHT, Plani dhe programi mësimor 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
8. MASHT, Plani dhe programi mësimor 9, përgatiti për shtyp: Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.
9. Historia e popullit shqiptar I, Tiranë, 2001.
10. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Historia VI, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
11. Vilson Kuri, Ragip Zekolli, Bep Jubani, HISTORIA 5, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.
12. Vilson Kuri, Hysen Latifi, Hysni Myzyri, Historia 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.
13. Mikel Pjetrush, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.

Burimet në internet:

1. www.dadalos.org
2. www.historyplace.com
3. www.see-educoop.net
4. www.eurocliohistory.org
5. www.euroclio.net

EDUKATA QYTETARE

Klasa VI

HYRJE

Lënda Edukatë qytetare për klasën VI u mundëson nxënësve të njihen me koncepte e përmbajtje themelore shumë të rëndësishme nga fusha e qytetarisë. Përpilimi i planit dhe programit mësimor të kësaj lënde është bërë duke pasur parasysh edhe të arriturat nga mësimi i kësaj lënde në klasat e mëparshme, por edhe nevoja e nxënësve për t'i njohur më mirë ndryshimet fizike dhe psikike të shkaktuara gjatë rritjes dhe të cilat ndryshime reflektohen vazhdimisht në sjelljet në familje, komunitet dhe shoqëri. Materia e kësaj lënde vë në pah lidhjet shumë të rëndësishme ndërmjet moshës, sjelljeve dhe përgjegjësisë, në njërin anë, dhe njohurive, aftësive dhe shkathtësive për jetë, në anën tjetër. Krijimi i identitetit personal dhe zgjerimi i lidhjeve sociale, krijon nevojën për njohjen dhe zbatimin e ligjeve shoqërore, të të drejtave të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve, vlerave kulturore, ambientit jetësor e, patjetër, edhe të detyrave dhe të përgjegjësisë qytetare.

QËLLIMET E LËNDËS

- Zhvillimi i ndjenjës së identitetit dhe vetëbesimit.
- Zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë për t'u angazhuar për qytetari aktive dhe jetë demokratike.
- Aftësimi që të bëjë zgjedhje të përshtatshme dhe të marrë vendime të dobishme në lidhje me dimensionin personal, shëndetësor dhe social të jetës tash dhe në të ardhmen.
- Njohja e ligjeve shoqërore, e të drejtave njerëzore dhe e të drejtave të fëmijëve si dhe krijimi i shprehive për të kundërshtuar dhe mospranuar kurrfarë forme të diskriminimit njerëzor.

- Njohja dhe respektimi i diversitetit kulturor në shoqëri dhe i diversitetit ekologjik në natyrë.
- Njohja e ndryshimeve mjedisore dhe krijimi i shprehive për ruajtjen e mjedisit jetësor.

OBJEKTIVAT

Në bazë të qëllimeve të programit mësimor të klasës së gjashtë nxënësi duhet të arrijë këto objektiva:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:

- Të dijë të ruajë shëndetin e vet dhe me sjelljet e veta, të mos dëmtojë shëndetin e të tjerëve.
- Të jetë i hapur dhe tolerant dhe të kundërshtojë çdo formë të diskriminimit gjinor, etnik, fetar, racor.

Të njohë:

- elementet mbi të cilat mbështetet identiteti personal dhe identiteti grupor;
- konceptet si: ligj, kushtetutë, sistem ligjor, të drejtat e njeriut, detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarëve;
- dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe ato mbi të drejtat e fëmijëve dhe organizatat që merren me mbrojtjen e këtyre të drejtave;
- elementet bazë që përbëjnë kulturën njerëzore dhe faktorët mbi të cilët ngriten diversitetet kulturore (gjinia, gjenerata, religjioni, etnia e regjioni).

Të kuptojë:

- ndryshimet e shkaktuara gjatë rritjes dhe të harmonizojë sjelljet e tij në përputhje me rregullat dhe normat e mjedisit ku jeton;
- domosdoshmërinë e barazisë ligjore të të gjithë qytetarëve të një vendi;
- lidhjen ndërmjet lirisë dhe përgjegjësisë;
- ndërvashmërinë ndërmjet njerëzve, grupeve shoqërore, ambientit jetësor dhe botës në tërësi.

Të vlerësojë:

- rëndësinë e mbrojtjes ligjore të ambientit dhe të diversiteteve ekologjike në natyrë;
- rëndësinë e respektimit të vlerave dhe të besimeve të komunitetit ku jeton, por edhe të komuniteteve tjera.

Të zbatojë:

- rregullat e ruajtjes nga përdorimi i materieve të ndryshme që shkaktojnë varësi dhe e rrezikojnë shëndetin, si: duhani, alkooli, droga etj.;
- ligjet dhe normat e sjelljes në komunitet;
- rregullat dhe normat ligjore në lidhje me mbrojtjen e ambientit.

Të analizojë:

- format dhe funksionet e lidhjeve sociale si dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e identitetit personal dhe grupor;
- ndryshimet e reja kulturore në komunitetin ku jeton dhe në shoqëri.

STRUKTURA E LËNDËS

Edukata qytetare në këtë klasë mësohet me nga 1 orë në javë gjatë 18 javëve.

| KATEGORITË | NËNKATEGORITË | NUMRI I ORËVE |
|-------------------------------------|--|---------------|
| ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI | Identiteti, rritja dhe ndryshimi | 6 orë |
| | Shëndeti | |
| QEVERISJA DHE QYTETARIA | Ligji | 2 orë |
| TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË | Liritë dhe të drejtat e njeriut/fëmijëve | 5 orë |
| | Detyrat dhe përgjegjësitë | |
| KULTURA | Vlerat kulturore dhe besimet | 5 orë |
| | Kujdesi për ambientin | |

ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Përmbajtja mësimore

Nxënësi mëson për:

- Identitetin personal dhe identitetin grupor. Elementet në të cilat mbështetet identiteti personal si dhe elementet në të cilat mbështetet identiteti grupor.
- Ndryshimet fizike dhe emocionale të shkaktuara gjatë rritjes por edhe ndryshimet sociale të shkaktuara gjatë zgjerimit të lidhjeve sociale në komunitet dhe shoqëri.
- Shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Faktorët që e rrezikojnë shëndetin.

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- Shpjegon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme fiziologjike, emocionale dhe sociale të shkaktuara nga mosha.
- Kupton lidhjen e identitetit personal me zhvillimin individual dhe me jetën e ndërveprimet në familje e në shoqëri.
- Dallon përgjegjësitë individuale prej atyre grupore ose kolektive.
- Krijon shprehitë e kujdesit dhe të ruajtjes së shëndetit personal si një kusht për jetë të shëndoshë.

QEVERISJA DHE QYTETARIA

Përmbajtja mësimore

Nxënësi mëson për:

- Kuptimin e ligjit dhe rëndësinë e zbatimit të ligjit në shoqëri. Llojet e ligjeve dhe të sistemeve ligjore. Pocerurat për nxjerrjen e ligjeve. Kushtetutën.
- Organet e drejtësisë. Roli i gjykatës, i prokurorit, i hetuesisë, i avokatit, i gjykatësit.

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- **Shpjegon** se ç'janë ligjet, rregullat, adetet, zakonet. Pastaj, cilat janë llojet e ligjeve, ç'është kushtetuta.
- **Përshkruan** procedurat e nxjerrjes së ligjeve dhe **analizon** pasojat e shkeljes së ligjit.
- **Krahason dhe analizon** sistemet e ndryshme ligjore dhe karakteristikat e ligjeve në shoqëritë totalitare dhe atyre demokratike.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

Përmbajtja mësimore

Nxënësi mëson:

- Ç'janë të drejtat e njeriut. Historia e të drejtave të njeriut. Dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Ç'janë të drejtat e fëmijëve. Dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve si dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit. Ç'është ndjenja e përgjegjësisë dhe lidhja ndërmjet lirisë dhe përgjegjësisë.

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- **Shpjegon** të drejtat elementare të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve.
- **Identifikon** rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut në komunitet dhe shoqëri.
- **Identifikon** rastet eventuale të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe shoqëri.
- **Flet** për shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve në Kosovë dhe për rezultatet e punës së tyre.
- **Kundërshton** shkeljet e të drejtave njerëzore dhe të drejtave të fëmijëve si dhe çdo lloj diskriminimi njerëzor që bëhet mbi baza gjinore, gjenerative, sociale, etnike, fetare e racore.
- **Bën dhe praktikon** ankesën për shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre ose për çfarëdo lloj diskriminimi që mund t'u bëhet nga të rriturit ose shokët e tyre.

KULTURA

Përmbajtja mësimore

Nxënësi mëson për:

- Vlerat kulturore dhe llojet e tyre. Besimet dhe llojet. Diversiteti kulturor dhe rëndësia e ruajtjes së diversitetit kulturor
- Diversiteti ekologjik. Rëndësia e ruajtjes së diversitetit ekologjik në natyrë
- Mbrojtja ligjore e ambientit

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- **Identifikon** se cilat janë elementet përbërëse të kulturës (gjuha, besimi, folklori, arti, stili i jetës, zakonet, traditat etj.).
- **Krahason** modelet kulturore të së kaluarës me ato aktuale dhe **identifikon** ndryshimet e reja kulturore që po ndodhin në komunitet e shoqëri.
- **Zbaton** rregullat dhe normat e sjelljes kulturore në familje, në rrugë, në shkollë dhe në komunitet.
- **Analizon** llojlojshmërinë (diversitetin) kulturor dhe **shpjegon** se cila është rëndësia e respektimit të diversiteteve kulturore.
- **Analizon** llojlojshmërinë (diversitetin) ekologjik dhe **shpjegon** se cila është rëndësia e ruajtjes së diversiteteve ekologjike.
- **Shpjegon** rëndësinë e mbrojtjes ligjore të ambientit dhe **zbaton** normat ligjore në lidhje me mbrojtjen e ambientit

QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Programi i Edukatës qytetare në klasën e gjashtë ndërlidhet me lëndët: gjuhë amtare, gjuhë e huaj, histori, gjeografi, edukatë fizike, art figurativ dhe muzikë.

Zhvillimi individual dhe identiteti

Në trajtimin e kësaj kategorie nevojitet një qasje ndërlëndore. Edukata fizike në kuptimin e zhvillimit të aftësive dhe të shkathtësive fizike e psikomotorike mund ta vë në pah jashtëzakonisht shumë çështjen

e zhvillimit individual dhe të identitetit personal. Po ashtu, edhe muzika, arti figurativ, gjuha amtare janë lëndë të cilat ndërlidhen me përmbajtjen e kësaj kategorie. Zhvillimi i talentit për muzikë, vizatim, poezi etj., janë aspekte shumë të rëndësishme të identitetit personal.

Qeverisja dhe qytetaria

Kjo kategori ndërlidhet edhe me lëndët histori dhe gjeografi. Disa aspekte të zhvillimit historik të formave të qeverisjes dhe të sistemeve ligjore do të ishin shumë të rëndësishme për njohjen më të plotë të kësaj kategorie. Po ashtu, në lidhje me këtë kategori, kur është fjala për çështjet e organizimit territorial të administratës qeveritare, edhe gjeografia do të ndërlidhej shumë me edukatën qytetare.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Po ashtu, për t'u kuptuar më mirë kjo kategori, do të duhej të paraqitej edhe aspekti historik i të drejtave dhe përgjegjësisve, pastaj proceset dhe rrethanat historike që kanë ndikuar në nxjerrjen e dokumenteve të njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriur dhe të atyre të fëmijëve, gjë kjo e cila e bën edukatën qytetare të ndërlidhet me historinë.

Kultura

Shtjellimi i kësaj kategorie e vë në ndërlidhje të ngushtë Edukatën qytetare me lëndët si gjuha amtare, gjuha e huaj, historia, gjeografia, arti figurativ, muzika, edukata fizike etj. Njohuritë e fituara nga gjuha amtare, pastaj nga letërsia, komunikimi në gjuhë të huaj dhe njohuritë e fituara për popujt dhe kulturat e besimet e tyre, në të kaluarën dhe tash i ndihmojnë shumë edukatës qytetare në shtjellimin e kësaj kategorie. Po ashtu, talenti dhe shkathtësitë në artin muzikor dhe atë figurativ, recitim, aktrim etj. i ndihmojnë shumë nxënësit në njohjen e kulturës dhe të gjitha elementeve artistike si pjesë përbërëse të saj.

METODOLOGJIA

Metodologjia e mësimdhënies dhe e mësimnxënies është jashtëzakonisht e rëndësishme për punën në Edukatën qytetare. Për të zhvilluar një progres të fuqishëm të nxënësve, do të duhej që arsimtarët t'i përdorin një sërë metodash - varësisht nga përmbajtjet, por edhe nga detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit në kuadër të kësaj lënde. Shpjegimi i arsimtarit, leximi i literaturës, diskutimet në klasë, puna në grupe, puna

individuale, aktivitetet praktike, shfrytëzimi i internetit, aktiviteve skenike, shfrytëzimi i multimedive, observimet në komunitet, mbledhja, përpunimi dhe prezantimi i të dhënave përbëjnë shportën e metodave që do të përdoren në mësimdhënien dhe mësimnxënien e Edukatës qytetare.

Zhvillimi individual dhe identiteti

Për shtjellimin e temave të kësaj kategorie arsimtari mund të shërbehet me literaturë që ka të bëjë me fiziologjinë e njeriut e sidomos me psikologjinë e fëmijëve dhe të rriturve. Pastaj, në bashkëbisedim me nxënësit do të identifikohen karakteristikat personale fizike, mendore dhe emocionale mbi të cilat mbështetet identiteti personal. Po ashtu, në bashkëbisedim me nxënësit do të identifikohen sjelljet, aktivitetet, prirjet, preferencat, qëndrimet etj. të cilat po ashtu krijojnë identitetin personal të nxënësit. Duhet të zhvillohen diskutime në klasë edhe për gjërat të cilat janë të rëndësishme për identitetin grupor ose kolektiv, si: jeta e përbashkët, qëndrimet e përbashkëta, aktivitetet, simbolet, emblemat, logot etj.

Nëpërmjet diskutimeve, observimeve dhe auto-observimeve do të kuptohen ndryshimet fizike, emocionale dhe sociale që janë si rezultat i procesit të rritjes dhe zhvillimit individual të njeriut. Po ashtu, me shembuj konkretë do të demonstrohen dhe do të përshkruhen pasojat për shëndet nga veprimet e caktuara, si përdorimi i duhanit, konsumimi i alkoolit, i drogës etj.

Qeverisja dhe qytetaria

Arsimtari që t'u ndihmojë nxënësve që të kuptojnë ligjin dhe rëndësinë e ligjit për shoqëri duhet t'i udhëzojë ata të gjejnë publikime të ligjeve dhe të diskutojnë pjesë të ndryshme të ligjeve, si: dokumente të ndryshme, fletushka ose broshura që përmbajnë ligje të ndryshme, p.sh. Ligjin për arsim, Ligjin për mbrojtje të ambientit etj. Pastaj duhet të zhvillohen diskutime, bashkëbisedime, punë në grupe etj. lidhur me funksionin e ligjeve, nxjerrjen e ligjeve, shkeljen e ligjeve, ndryshimin e ligjeve etj.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Për të pasur të qartë nxënësit konceptet elementare mbi të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë e njeriut duhet të demonstrohen dhe mundësisht t'u shpërndahen nxënësve broshura ose materiale që përmbajnë dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve. Të lexohen pjesë nga këto dokumente dhe do të diskutohet në klasë lidhur me respektimin ose shkeljen e këtyre të drejtave në familje, në shkollë,

në komunitet dhe shoqëri. Në realizimin e temave të kësaj kategorie nxënësit duhet të punojnë në projekte individuale dhe grupore. Nisur nga përvoja e vet secili nxënës do të demonstrojë raste të diskriminimit ose paragjykimeve të ndryshme. Në projektet grupore nxënësit do të mbledhin të dhëna mbi diskriminimin e fëmijëve ose të grave ose forma tjera të diskriminimit në komunitetin ku jetojnë. Me ndihmën e arsimtarit duhet të përpunohen dhe të analizohen këto të dhëna dhe pastaj të prezantohen në klasë.

Kultura

Fillimisht nxënësit duhet të njihen me konceptin e kulturës si dhe elementet bazë të çdo kulture pastaj të diskutohet për karakteristikat dhe dallimet ndërmjet kulturave të veçanta, për shkaqet e ndryshimeve kulturore dhe për trendet aktuale të ndryshimeve. Nxënësit të zhvillojnë aktivitete në terren me qëllim të observimit dhe mbledhjes së të dhënave për elementet arkaike të kulturës, si: veglat e punës, veshmbathjet, bestyt-nitë, këngët etj., por edhe lidhur me elementet më të reja që kanë ardhur si pasojë e lidhjeve globale, ndryshimeve sociale, shkencore e teknologjike. Të dhënat e mbledhura duhet të sistematizohen me ndihmën e arsimtarit dhe pastaj të prezantohen në klasë dhe në shkollë. Nxënësit duhet të njohin rëndësinë e ruajtjes dhe të respektimit të diversiteteve kulturore dhe ekologjike e pastaj të diskutojnë, identifikojnë dhe analizojnë faktorët që përbëjnë, mundësojnë dhe zhvillojnë këto diversitete.

VLERËSIMI

Vlerësimi është moment shumë i rëndësishëm për punën në shkollë. Ai është moment i rëndësishëm edhe për nxënësit, edhe për arsimtarët e edhe për prindërit e komunitetin. Mënyra e vlerësimit duhet të jetë e shumanshme dhe permanente. Progresi i nxënësve në Edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në tërë procesin e angazhimit dhe të pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Me rastin e vlerësimit të nxënësve në Edukatën qytetare nuk duhet mbështetur vetëm në informatat njohëse, por edhe në shkathtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike si, observimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe të fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan dhe program të kësaj lënde.

Vlerësimi i arsimtarit për nxënësit duhet të bazohet në:

- **Observimet e arsimtarit**

- **Detyrat dhe testet**
- **Projektet**

Observimet e arsimitarit do të duhej të fokusohen në shkathtësitë e nxënësit për të punuar në grupe dhe për të punuar në mënyrë të pavarur, në raportet joformale të fëmijëve ndërmjet vete, por edhe të fëmijëve me të rriturit, në cilësinë e prezantimit të punës, në shprehjen e interesimeve për aktivitete të veçanta, në pjekurinë fizike, emocionale dhe mendore të nxënësit.

Detyrat do të ishin krijimi i situatave kur nxënësit do të duhej të merrnin ndonjë vendim të caktuar, ose do të duhej të mbronin dhe të argumentonin mendimet ose qëndrimet e caktuara etj.

Testet janë instrumente me të cilat në intervale të caktuara matet dija, përkatësisht progresi në njohuritë e nxënësve të fituara gjatë mësimit në klasë dhe jashtë klase.

Projektet janë punë grupore, por edhe individuale, e nxënësve që kanë të bëjnë me mbledhjen e të dhënave të caktuara, përpunimin ose publikimin e tyre.

Vlerësimi nuk duhet të jetë vetëm proces i njëanshëm (arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit. Për të mirën e shkollës, komunitetit, e sidomos të vetë nxënësve, do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit jo vetëm të vlerësohen, por edhe vetë të vlerësojnë.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 5**, Prishtinë, 1999.
2. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 6**, Prishtinë, 1999.
3. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 7**, Prishtinë, 1999.
4. Dr. Fatmira Myteberi & Astrit Dautaj & Majlinda Keta, **Qytetaria 1**, Tiranë, 2000
5. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e Edukimit Qytetar**, (DRAFT), Tiranë, 1997.
6. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Kurrikula dhe shkolla** (Lëndët shoqërore 2), Tiranë, 2002.

7. Grup autorësh, **Të gjitha qeniet njerëzore ...**, doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998.
8. David Keri, Fondacioni kombëtar për Kërkime Arsimore NEER, **Edukimi i të Drejtës për QYTETARI në Kurrikul**, Vështrim Ndërkombëtar, Londër, 1999.
9. Prof. François Andiger, **Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarisë**, Strasburg, 2000.
10. Graham Haydon, Instituti i Arsimit, **Agjenda e Edukimit Moral**, Londër, 2001.
11. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.
12. Erlehta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astrit Dautaj, **Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar**, Tiranë, prill 2003.
13. Xhemajli Beluli, **Kultura qytetare**, Shkup, 2002.
14. Shemi Krasniqi, Edukata qytetare 6, Dukagjini, Prishtinë, 2004.
15. E Mato, B. Shatri, Edukata qytetare 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
16. E. Mato, B Shatri, Edukata qytetare 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
17. E. Mato, B Shatri, Edukata qytetare 10, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
18. www.dadalos.org.

EDUKATË QYTETARE

Klasa VII

HYRJE

Programi i edukatës qytetare për klasën VII është hartuar duke pasur parasysh moshën e nxënësve, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga mësimi i kësaj lënde në klasat e mëparshme, por edhe në lëndet e tjera me të cilat edukata qytetare është në korelacion..

Përvojat nga temat e klasës VI mbi zhvillimin e identitetit personal dhe identitetit grupor, pastaj nga shëndeti dhe mbrojtja shëndetësore, ligji dhe të drejtat e njeriut, kultura dhe mbrojtja e ambientit mund të lidhen në mënyrë praktike me temat e planit dhe të programit të klasës VII. Kjo është mosha kur nxënësit ndjehen të pjekur dhe kureshtarë për të formuar klube ose shoqata të ndryshme dhe brenda këtyre klubeve ata e zhvillojnë identitetin e vet personal dhe atë grupor. Klubet e kësaj moshe zakonisht janë klube muzikore, recituese, klube aktrimi, klube kuizi, sportive etj. ose edhe shoqata ekologjike, vullnetare etj., dhe në kuadër të kësaj lënde nxënësit do të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë për aktivitete në këto forma të organizimeve shoqërore.

Përveç kësaj, në kuadër të Edukatës qytetare të klasës VII nxënësit do të mësojnë për qeverisjen, pushtetin dhe autoritetin. Nxënësit do të informohen për format e ndryshme të qeverisjes, të pjesëmarrjes dhe të ndikimit në qeverisje. Organizimi i klubeve, i shoqatave ose i organizatave joqeveritare jo vetëm që u ndihmon nxënësve në ngritjen e tyre në pikëpamje edukative dhe kulturore, por kjo u mundëson nxënësve që të përgatiten më mirë edhe për rolet e ardhshme që do t'i marrin në shoqëri.

QËLLIMET

- Të ndihmohet nxënësi që të bëhet aktiv dhe kureshtar për themelimin, funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe komunitet.

- Të vetëdijësohet nxënësi për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në krijimin e organeve drejtuese të institucioneve shoqërore.
- Të vetëdijësohet nxënësi për rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe përgjegjësive të anëtarëve të grupit dhe pengimin e çdo lloj diskriminimi (etnik, fetar, racor, gjinor etj.).
- Të ndihmohet nxënësi të njohë llojet e ndryshme të institucioneve shoqërore, mënyrën e formimit dhe funksionimit të tyre.
- Të aftësohet nxënësi të reagojë ndaj shkeljeve eventuale të rregullave dhe të procedurave të punës së grupeve dhe institucioneve.
- Të aftësohen të kuptojnë format e ndryshme të pjesëmarrjes, por edhe të ushtrimit të ndikimit të qytetarëve dhe të shoqërisë civile tek autoritetet e pushtetit.

OBJEKTIVAT

Në bazë të qëllimeve të programit mësimor të klasës së shtatë nxënësi duhet të arrijë këta objektiva:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat:

- të shfaqë qëndrim kritik në lidhje me punën e klubeve, shoqatave dhe institucioneve;
- të jetë i hapur e tolerant dhe të kundërshtojë çdo formë të diskriminimit gjinor, etnik, fetar, racor;
- të jetë kureshtar dhe i vullnetshëm për aktivitetet e klubeve, shoqatave, OJQ-ve.

Të njohë:

- konceptet si: klub, shoqatë, institucion, OJQ, shoqëri civile, qeverisje qendrore, qeverisje lokale;
- format e ndryshme të qeverisjes (qeverisja demokratike, autoritare);
- llojet e aktivitetit të shoqërisë civile në Kosovë;
- mënyrat e ndikimit të qytetarëve tek autoritetet dhe anashjelltas.

Të kuptojë:

- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në punën e klubeve, shoqatave dhe institucioneve;
- përgjegjësitë dhe kompetencat që dalin nga puna në klub, shoqatë dhe institucione;
- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në qeverisje dhe mënyrat e ndikimit në qeverisje.

Të vlerësojë:

- rëndësinë e qeverisjes demokratike për zhvillimin e klubit, shoqatës, institucionit, por edhe të shoqërisë në përgjithësi;
- nevojat dhe mundësitë për themelimin e klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe komunitet;
- nevojat e bashkëpunimit me klube, shoqata dhe institucione të tjera në shkollë dhe komunitet;
- rolin e autoriteteve në ushtrimin e përgjegjësive në qeverisje.

Të zbatojë:

- rregullat dhe procedurat e klubeve, shoqatave dhe institucioneve.

Të analizojë:

- rolin e pushtetit dhe të autoriteteve dhe rëndësinë e funksionimit të tyre sipas ligjeve demokratike;
- efektet dhe rezultatet e aktiviteteve të klubeve dhe të shoqatave në shkollë dhe komunitet.

Të sintetizojë:

- të arriturat e shoqërisë civile në zhvillimin dhe afirmimin e vlerave demokratike në shoqërinë kosovare.

STRUKTURA E LËNDËS (1 orë në javë, 37 orë në vit)

| KATEGORITË | NËNKATEGORITË | NUMRI I ORËVE |
|--------------------------|------------------------------------|---------------|
| Grupet dhe institucionet | Klubet shoqatat dhe institucionet | 20 orë |
| Qeverisja dhe qytetaria | Qeverisja, pushteti dhe autoriteti | 17 orë |

KLUBET, SHOQATAT DHE INSTITUCIONET

Përmbajtja programore

Nxënësit të mësojnë për:

Klubet dhe llojet e tyre. Formimin dhe procedurat për themelimin e klubeve.

Parimet e udhëheqjes dhe të funksionimit të klubeve, për punën në grup dhe rëndësinë e përbushjes së obligimeve të marra në grup.

Krijimi i identitetit të klubit dhe mënyrat e shprehjes së identitetit (logot, simbolet, emblemat ...).

Shoqatat dhe llojet e tyre (kulturore, artistike, ekologjike, humanitare, profesionale).

Ndikimin e aktiviteteve të shoqatave në komunitet dhe shoqëri (bashkëpunimi ndërmjet shoqatave dhe zgjerimi i aktiviteteve).

Organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe koncepti i shoqërisë civile. Pjesëmarrja në shoqërinë civile. Rrjetat e OJQ-ve dhe ndikimi i tyre në qeverisjen lokale/ qendrore.

Institucionin e familjes. Ndryshimet në familje. Roli dhe struktura e familjes dhe e farestnisë.

Llojet e tjera të institucioneve shoqërore, si: institucionet arsimore (shkolla dhe nivelet e shkollimit, shkollimi tërëjetësor etj.); pastaj institucionet kulturore (mediat, teatri, kinemaja, galeritë artistike). Ndryshimet kulturore në Kosovë dhe në botë dhe trendet e këtyre ndryshimeve.

Institucionet fetare. Llojet e besimeve dhe e drejta për ushtrimin e lirë të fesë.

Institucionet shëndetësore (spitali, ambulanca, shëndeti publik dhe faktorët që rrezikojnë shëndetin); institucionet e shërbimeve publike (posta, telekomunikacioni) dhe për institucionet e pushtetit (gjykata, policia, prokuroria, mbrojtja civile, mbrojtja sociale).

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- identifikon llojet e ndryshme të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve që veprojnë në komunitetin ku jeton dhe në Kosovë në përgjithësi;
- përshkruan punën në grup dhe përgjegjësitë që dalin nga puna në grup;

- identifikon nevojat për aktivitete të reja në mënyrë që klubi, shoqata ose institucioni të jenë vazhdimisht në rrjedhë të kohës;
- analizon rëndësinë e bashkëpunimit me klubet dhe shoqatat e tjera,
- vlerëson rëndësinë e klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve për zhvillimin e komunitetit dhe të shoqërisë.

QEVERISJA, PUSHTETI DHE AUTORITETI

Përmbajtjet programore

Nxënësit mësojnë:

Format e qeverisjes dhe rolin e qeverisjes demokratike.

Format e pjesëmarrjes në qeverisje. Sistemet zgjedhore dhe rëndësia e votës së lirë.

Format e ndikimit të qytetarëve në institucionet vendimmarrëse (ankesat, petitionet, fushatat, protestat ...).

Pushteti lokal dhe pushteti qendror. Funkcionet e qeverisjes lokale dhe format e pjesëmarrjes dhe të ndikimit në të.

Funksionet e qeverisjes qendrore dhe format e pjesëmarrjes dhe të ndikimit në të.

Format e pushtetit dhe organet e tij (pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor).

Pushteti dhe autoriteti. Respektimi, kundërshtimi dhe keqpërdorimi i autoritetit.

Rezultatet e pritura

Nxënësi:

- përshkruan format e qeverisjes;
- shpjegon rëndësinë e pjesëmarrjes në qeverisje;
- shpjegon llojet e pushtetit dhe mënyrat e funksionimit të organeve të pushtetit;
- dallon kompetencat e pushtetit lokal prej atij qendror;

- shpjegon rolin e pushtetit në përmbushjen e interesave të ndryshme të qytetarëve;
- kupton format e mundshme të diskriminimit, kundërshton dhe shpreh mendimin kritik ndaj ligjeve diskriminuese;
- identifikon interesat kundërshtuese dhe rrugët e ndryshme për harmonizimin e atyre interesave.

QASJA NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Edukata qytetare është lëndë shumëdisiplinare. Ajo ka lidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera, si: histori, gjeografi, gjuhë shqipe, muzikë, art figurativ, arsim teknik, edukatë fizike e lëndë të tjera.

Me **Historinë**, edukata qytetare krijon lidhje me temat, format e ndryshme të qeverisjes dhe të rregullimeve shtetërore. Ajo ka lidhmëri edhe me përmbajtjet e krijimit të institucioneve të ndryshme, të ngjarjeve dhe të proceseve që kanë ndikuar në ndryshimin e institucioneve, ligjeve dhe qeverive ose edhe formave të qeverisjes.

Me **Gjeografinë**, edukatën qytetare e lidhin përmbajtjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e territoreve, planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të klubeve, shoqatave dhe institucioneve nëpër regjione të caktuara. Po ashtu, ndihmojnë edhe përmbajtjet për ndarjen territoriale të komuneve dhe të funksionimit të pushtetit lokal brenda territoreve të caktuara.

Me **Gjuhën shqipe**, nxënësit në klasën e shtatë janë në gjendje të krijojnë klube të ndryshme letrare, dramatike. Këto aktivitete i ndihmojnë njohuritë e fituara nga gjuha dhe letërsia, por edhe nga edukata qytetare.

Me **Artin figurativ, Muzikën dhe me Edukatën fizike**, në shkollë dhe në komunitet, përveç klubeve letrare, mund të funksionojnë edhe klube të tjera si klubet muzikore, klubet e artistëve figurativë, klubet sportive e lloje të tjera të klubeve dhe me aktivitetet e tyre e begatojnë jetën kulturore dhe artistike në shkollë dhe komunitet. Pjesa e projekteve të parapara në edukatën qytetare mund të realizohet pikërisht nëpërmjet këtyre aktiviteteve. P.sh., përgatitja e një posterit për një fushatë mbi mbrojtjen e mjedisit mund t'i lidhë së bashku edhe lëndën e edukatës qytetare e edhe atë të artit figurativ.

Me **Arsimin teknik**, shfrytëzimi ose përdorimit i mjeteve ose i pajisjeve teknologjike, si: kasetofon, diktafon, kamerë, aparat fotografik, dhe mjete të tjera audio-vizuele.

METODOLOGJIA

Për t'u realizuar plani dhe programi i edukatës qytetare për klasën VII, do të duhej që arsimtari t'i përdorë një sërë formash, metodash dhe teknika të mësimdhënies - varësisht nga përmbajtjet, por edhe nga detyrat që duhet t'i realizojnë nxënësit në kuadër të kësaj lënde. Shpjegimi në klasë, leximi i literaturës, diskutimet, puna në grupe, puna individuale, projektet dhe aktivitetet praktike, shfrytëzimi i internetit, aktivitetet skenike, shfrytëzimi i multimedive, vëzhgimet në komunitet, vizita klubeve, shoqatave dhe institucioneve, mbledhja, përpunimi dhe prezantimi i të dhënave mundësojnë mësimdhënie dhe të nxënë të sukseshëm.

Në temat që kanë të bëjnë me **klubet, shoqatat dhe institucionet**, përveç shpjegimeve për procedurat e formimit, mënyrat e funksionimit dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e aktiviteteve, arsimtari të aktivizojë nxënësit në pjesëmarrje në aktivitetet e klubeve, shoqatave të shkollës ose komunitetit. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme i mundësojnë nxënësit që të njihet me punën dhe funksionimin e klubeve, shoqatave, por edhe i kontribuojnë zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike shkollës dhe komunitet.

Në temat që kanë të bëjnë me **qeverisjen, pushtetin dhe autoritetin**, arsimtari shpjegon kuptimin dhe rëndësinë e qeverisjes, pushtetit dhe autoritetit për shoqërinë. Pastaj duhet të zhvillohen diskutime, bashkëbisedime dhe punë në grupe lidhur me format e qeverisjes, rëndësinë e qeverisjes demokratike, nivelet e qeverisjes, funksionin e pushtetit, mënyrat e ardhjes në pushtet dhe bazat e krijimit dhe funksionimit të autoritetit.

Në realizimin e temave të kësaj kategorie nxënësit duhet të punojnë në projekte **individuale** dhe **grupore**.

Në projekte individuale nxënësi do të përshkruajë një sërë ndryshimesh që janë bërë në komunitetin e vet si rezultat i qeverisjes qendrore dhe asaj lokale.

Ndërkaq, në projektet grupore nxënësit do të mbledhin fakte nga mediat dhe jeta e përditshme për pjesëmarrjen, format e pjesëmarrjes dhe e ndikimit të qytetarëve në qeverisje. Këto projekte do të prezantohen në klasë dhe pastaj do të zhvillohet diskutim lidhur me to.

VLERËSIMI

Përmes vlerësimit konfirmohet shkalla e arritjes së kërkesave të rezultateve të pritura të parapara në plan dhe program të klasës VII, duke

filluar nga shkalla më e ulët e këkesave, si: identifikimi, përshkrimi e deri te shkalla më e lartë si analiza, sinteza, konstruktimi, vlerësimi i dukurive ...

Ai sjell informata për përparim apo për vështirësitë në përparim të nxënësit si rezultat i përshtatshmërisë së planeve dhe programeve dhe metodologjisë efektive apo joefektive të mësimdhënies.

Vlerësimi duhet të jetë i shumanshëm dhe i vazhdueshëm. Kjo bëhet përmes:

- **vëzhgimit:**
shkathhtësitë e nxënësit për punë individuale,
shkathhtësitë e nxënësit për punë në grupe,
shprehjes së interesimit për aktivitete të veçanta;
- **detyrave:**
zgjidhja e drejtë,
kryerja me kohë,
formimi i shprehive për punë në klasë dhe shtëpi;
- **projekteve:**
individuale,
grupore;
- **testeve:**
testi provues,
testet periodike,
testi final;
- **dosjeve (portofolje):**
me shkrim,
me ilustrime,
me inqizime;
- **vetëvlerësimit:**
vlerësimi i nxënësit për nxënësin,
vlerësimi i grupit për grupin,
vlerësimi i klasës për nxënësin.

Përparimi i nxënësve në edukatën qytetare nuk mund të matet vetëm me momentin e pyetjes, por në gjithë procesin e angazhimit dhe të pjesëmarrjes aktive në klasë, në shkollë, në komunitet. Vlerësimi nuk duhet të mbështetet vetëm në informatat njohëse të nxënësve, por edhe në shkathhtësitë e treguara në aktivitetet e ndryshme praktike, si: sjelljet me

rrethin, vëzhgimet në komunitet, mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të rëndësishme për shpjegimin e temave të parapara me plan dhe program të kësaj lënde.

Vlerësimi nuk duhet të jetë vetëm proces i njëanshëm (arsimtar – nxënës), por ai duhet të jetë proces i shumanshëm. Te nxënësit duhet të kultivohen shprehitë e vlerësimit kritik për përmbajtjet dhe për metodologjinë e mësimdhënies e të vlerësimit. Për të mirën e shkollës, të komunitetit, e sidomos të vetë nxënësve, do të duhej që shkolla të krijojë kushte që nxënësit jo vetëm të vlerësohen, por edhe vetë të vlerësojnë.

BURIMET DHE LITERATURA

Për metodologji të mësimdhënies

1. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003.
2. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Tiranë, 2003.
3. Erlehta Mato & Pranvera Kamani, Në kërkim të njohjes, Tiranë, 2000.
4. Fondacioni: Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, KONFLIKTI DHE KOMUNIKIMI, Tiranë, 1997.
5. Grup autorësh, Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë, Tiranë, 2003.
6. Grup autorësh, Mesazhe nga klasa – Ide dhe modele për mësimdhënie me nxënësin në qendër, (KEDP) Prishtinë, 2003.
7. Grup autorësh, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim, KEC, Prishtinë, 2003.
8. Grup autorësh, Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit, Tiranë, 1998.
9. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e edukimit qytetar**, (DRAFT), Tiranë, 1997.
10. Osman Buleshkaj – Robert C. Mizzi, **Mesazhe nga klasa**, KEDP, Prishtinë, 2003.

Për përmbajtje

1. David Keri, Fondacioni Kombëtar për Kërkime Arsimore NEER, **Edukimi i të Drejtës për QYTETARI në Kurrikul**, Vështrim Ndërkombëtar, Londër, 1999.

2. Dr. Fatmira Myteberi & Astrit Dautaj & Majlinda Keta, **Qytetaria 1**, Tiranë, 2000.
3. Erlehta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astrit Dautaj, **Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar**, Tiranë, prill, 2003.
4. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KCSF), **Lista e OJQ-ve të Kosovës**, Prishtinë, 2001.
5. Graham Haydon, Instituti i Arsimit, **Agjenda e edukimit moral**, Londër, 2001.
6. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 6**, Prishtinë, 1999.
7. Grup autorësh, **Edukatë qytetare 7**, Prishtinë, 1999.
8. Grup autorësh, **Të gjitha qeniet njerëzore ...**, doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998.
9. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Kurrikula dhe shkolla** (Lëndët shoqërore 2), Tiranë, 2002.
10. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.
11. Prof. François Andiger, **Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarisë**, Strasburg, 2000.
12. www.dadalos.org
13. Xhemajli Beluli, **Kultura qytetare**, Shkup, 2002.
14. Erlehta Mato, Bajram Shatri, **Edukata qytetare 7**, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
15. Erlehta Mato, Bajram Shatri, **Edukata qytetare 10**, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.

EDUKATË MUZIKORE

Klasa VI

Klasa VII

HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut. Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij, duke ia formuar ambientin tingullor.

Edukata muzikore mundëson:

- Dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe të shfaqjeve muzikore;
- Pjesëmarrje në formacione të ndryshme dhe veprimtari të tjera muzikore;
- Arsimim të mëtejshëm, që nënkupton interesim më të gjerë për muzikën.

QËLLIMET

Lënda ka për qëllim:

- **Të zgjojë emocione dhe interes për veprimtari të ndryshme muzikore;**
- **Të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;**
- **Të edukojë për përzgjedhje të programeve muzikore dhe për ambient të shëndoshë tingullor;**
- **Të mundësojë këndimin dhe luajtjen e përmbajtjeve muzikore, brenda mundësive individuale;**
- **Të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik;**

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

Njohin vepra të përzgjedhura muzikore nga kompozitorët botërorë dhe kombëtarë:

- vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëguara;
- dallojnë, njohin dhe sistemojnë instrumentet e ndryshme muzikore përmes dëgjimit muzikor;
- dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- dallojnë format e caktuara muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;

Muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:

- interpretojnë këngë (popullore, artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë) sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar, me dhe pa shoqërim instrumental;
- zhvillojnë aftësitë për këndim të drejtë dhe të bukur (qëndrimi i trupit, frymëmarrja, artikulimi, këndimi shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe dinamikë);
- zhvillojnë ndjenjën ritmike, melodike e harmonike përmes interpretimit dhe dëgjimit;
- njohin shenjat themelore të shkrimit muzikor si dhe dukuritë e ndryshme ritmike dhe melodike;
- Përjetojnë dhe njohin cilësitë themelore të muzikës popullore shqiptare përmes dëgjimit dhe këndimit.

Zhvillojnë shkathtësitë kreative:

- riinterpretojnë në mënyrë krijuese veprat e interpretuara;
- plotësojnë, ndryshojnë dhe krijojnë tërësi melodike dhe ritmike.
- shprehen në mënyrë kreative me mjetet shprehëse të arteve të tjera.

Mundësohet ndërlidhja e muzikës me gjuhën amtare, të huaj dhe me artet e tjera;

Zhvillojnë mendimin kritik:

- vlerësojnë ngjarjet muzikore në mjedisin e tyre.

| | KLASA E GJASHTË VEPRIMTARITË MUZIKORE | PËRMBAJTJE TË PROPOZUARA TEMATIKE-INFORMATIVE | BURIMET MUZIKORE-ARTISTIKE |
|--|--|--|--|
| <i>I N T E R P R E T I M</i> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ këndojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë; ▪ interpretojnë shoqërime instrumentale; ▪ ndërlidhin muzikën me vallëzimin; | <p>Muzika vokale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këngë dhe melodi në dur dhe mol; • llojet e zërave dhe formacioneve: solistët, ansamblet vokale, koret; • përmbajtja dhe forma e këngës; • këngë me shoqërim instrumental; | <p><i>Këngë për këndim:</i></p> <p><i>Himni i Flamurit, Molla e vogël (popullore), Muzikë e vogël e natës (Moxart) Asaman moj lule (popullore) Alfabeti shqip (patriotike), Nënë Tereze (M.Piperku), Haliti i vogël (popullore), Motiv i përjetshëm (J. Gërvalla), Red river valley (popullore amerikane) Fluturojmë të dy tok (L. Dizdari), Pranvera (Moxart), Delja rude (popullore)</i></p> |
| <i>D Ë GJ I M</i> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ dëgjojnë në mënyrë përjetuese krijime popullore dhe artistike; ▪ dëgjojnë vepra të ndryshme të kompozitorëve botërorë dhe kombëtarë. | <p>Muzika vokale -instrumentale</p> <ul style="list-style-type: none"> • harkoret dhe instrumentet e tjera me tela; • instrumentet me të fryer; • instrumentet me tastierë; • instrumentet me të goditur-perkusionet; | <ol style="list-style-type: none"> 1. Trofta, Shubert-këngë solo 2. Puna e mbarë, L. Antoni 3. Kënga e Rexhës, L. Antoni 4. Një kokë, një tokë, R. Rudi 5. Drandofilja e vogël, M. Kaçinari <p>1. B. Britën: Sheti nëpër orkestër</p> |

| | | | |
|----------------------------|---|--|--|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • <i>formazione instrumentale, solistë, formazione kamertale, orkestra;</i> <p>Muzika klasike</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Muzika me program dhe muzika absolute</i> <p>Muzika klasike</p> <p>Muzika e popullarizuar,</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>jazz, e lehtë, pop, rok etj.)</i> | <ol style="list-style-type: none"> 2. <i>A. Vivaldi: Pranvera</i> 3. <i>V. A. Moxart: Muzikë e vogël nate</i> 4. <i>A. Dvorzhak: Simfonia nga Bota e Re</i> 5. <i>Gershvin: Rapsodia blu</i> 6. <i>Shopen: Poloneza në A dur</i> 7. <i>Hajdn: Simfonia 104</i> 8. <i>F. Beqiri: Marshi ala turka</i> 9. <i>R. Mulliqi: Muzikë nga Baleti "Nita"</i> 10. <i>V. Gjini: Tema me variacionet për klarinetë dhe piano</i> 11. <i>Beatles,</i> 12. <i>A. Mula: Valsi i lumturisë,</i> 13. <i>Kapsamun: Ëndërrime, etj.</i> |
| K R I J I M | <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>imagjinimet dhe përjetimet individuale i shprehin përmes këndimit dhe ligjëritimit ritmik;</i> ▪ <i>Sajojnë shoqërime dhe tërësi të tjera muzikore</i> ▪ <i>Komentojnë në mënyrë kreative përjetimin muzikor me mjetet shprehëse të arteve të tjera.</i> | | |

| | VEPRIMTARITË MUZIKORE | PËRMBAJTJET TEMATIKO- INFORMATIVE | BURIMET ARTISTIKE MUZIKORE- SHEMBUJT E PROPOZUAR |
|-----------------------------------|--|---|---|
| D Ë GJ I M | <ul style="list-style-type: none"> • dëgjojnë vepra muzikore; • dëgjojnë, njohin dhe sistemojnë instrumentet orkestrale; • fitojnë njohuri elementare për disa forma muzikore; • njohin cilësitë themelore të muzikës popullore shqiptare; | <ul style="list-style-type: none"> ➤ njohin dhe dallojnë vepra dhe kompozitorë; ➤ dallojnë ngjyrat tingullore të instrumenteve; ➤ llojet e orkestrave dhe të ansambleve; ➤ forma të caktuara muzikore (rondo, suita, sonata, simfonia, koncerti) ➤ njohin disa nga llojet e këngëve dhe mënyrat e këndimit; ➤ njohin dhe dallojnë instrumentet popullore më të njohura; | <ul style="list-style-type: none"> - L.V.Betoven: Koncert për violinë dhe orkestër në D-dur (koncerti,rondo) - Kami Sen Sans: Mjellma nga Karnevali i shtazëve (violonçeli, piano, suita) - F. Ibrahim: Variacione mbi një temë popullore për flaut dhe orkestër (variacionet, muzikë kombëtare) - J. Hajdën: Koncert për trombë dhe orkestër në Es – dur (tromba, koncerti) V.A.Mocart: Koncert për Kornë dhe orkestër në Es –dur/Koha I (korna – briri) F.Beqiri: Kuinteti frymor (korna, kuinteti) - L.V.Betoven: Sonata për piano në G-dur (piano, sonata) V.A.Mocart: Sonata në C-dur - Facile (piano, forma e sonatës) - J.S.Bah: Tokata dhe Fuga në D-mol (organoja) - J.Hajdën: Kuarteti harkor C-dur /Finale (kuarteti) - B.Briten: Shëti nëpër orkestër (orquestra simfonike) - R.Mulliqi: Simfonia Nr.2 Kosovare (simfonia, kompozitori) - V. Gjini: Blegëron delja (këngë korale) - V.A.Mocart: Simfonia Nr. 40 G-mol |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | | <p>(simfonia)</p> <ul style="list-style-type: none"> - E.Rizvanolli: Suita për piano – Suita dasmore (suita, muzikë kombëtare) - F.Shopen: Valsi ne cis-mol (piano) - A.Vivaldi: Stinët e vitit – Vera - Çesk Zadeja – Simfonia Nr.1 - A.Koci – Baleti Sokoli e Mirusha (harpa) - R.Rudi – O ky Mehmeti (kitara) - The Beatles – Yesterday |
| I N T E R P R E T I M | <ul style="list-style-type: none"> • interpretojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë, sipas veshit (imitimit) dhe tekstit notal brenda mundësive të nxënësve; • interpretojnë pjesë nga veprat muzikore –artistike; • cilësojnë dhe vlerësojnë interpretimet e veta dhe të tjerëve; | <ul style="list-style-type: none"> ➤ interpretimi i këngëve popullore dhe artistike; ➤ përmes këngëve njohim dukuri të ndryshme ritmike - melodike; ➤ këngët, temat, meloditë, kanonet - në tonalitete të njohura dhe të reja; ➤ Shoqërojmë këndimin me instrumente popullore dhe të tjera; ➤ Luajmë tërësi të ndryshme instrumentale; | <ul style="list-style-type: none"> - Xh.B.Pergolezi: Lulja e bukur - L.V.Bethoven: Tema nga koncerti për violinë dhe orkestër në D-dur (koha I) - M.Menxhiqi: Nënë Tereze lulkurorë (kanon) - S.Spahiu: Pamje vjeshte - Patriotike: Një zë popullit - S.Gjinali: Mëma - B.Jashari: Lojë - L.V.Bethoven: Muzgu - Popullore: O bilbil - Popullore: Blegëron delja - Popullore: Oj lum e lum - Popullore: Bajram Curri |
| K R | <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit shprehin përjetimin e tyre përmes mjeteve shprehëse të arteve të tjera. | <ul style="list-style-type: none"> ➤ shprehemi përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare; ➤ riinterpretojmë në mënyrë përjetuese | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| I J I M | <ul style="list-style-type: none"> • <i>nxënësit shprehen në mënyrë kreative me mjetet shprehëse muzikore</i> | <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>përmbajtjet e përvetësuara muzikore; nxitimi për plotësim, ndryshim dhe krijim të melodisë – këngës; përcjellim ngjarjet muzikore, dallojmë cilësinë e interpretimit dhe komentojmë;</i> | |
|--|--|---|--|

REZULTATET E PRITSHME

DËGJIM

- *rinjohin veprat e dëguara dhe dallojnë format e tyre;*
- *njohin dhe sistemojnë instrumentet dhe formacionet e ndryshme interpretuese;*
- *njohin cilësitë themelore të muzikës popullore shqiptare;*

INTERPRETIM

- *kanë përvetësuar së paku gjysmën e numrit të këngëve dhe të temave të interpretuara duke përfshirë dhe luajtjen në instrumente;*
- *aplikojnë dukuritë ritmike dhe melodike të përvetësuara;*

KRIJIM

- *aplikojnë disa nga format e punës krijuese sipas prirjeve individuale;*

UDHËZIMET DIDAKTIKE-METODIKE (KL VI-VII)

Edukimi muzikor në këto klasë paraqet një ngritje të kërkesave programore si për kah zgjerimi i veprimtarive ashtu edhe thellimi i disa komponenteve mësimore, të cilat janë punuar edhe në klasat e mëparshme.

Realizimi i përmbajtjeve tematike kërkon një punë të planifikuar mirë, racionalizim të kohës dhe energjisë së nxënësit.

Veprimtaritë mësimore –muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme, prandaj formulimi i njësisve mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe për t'u mundësuar nxënësve veprimtari aktive varësisht nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore bazohen në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për interpretim dhe dëgjim
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor.
3. Informacionet për kulturën muzikore të ambientit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë botërore dhe kombëtare.

DËGJIM

Procedura metodike e dëgjimit të veprave të përzgjedhura duhet të mundësojë dëgjim aktiv. Dëgjimi duhet të jetë i shkurtër dhe i përsëritur, gjë që do të mundësojë zbatimin e koncentrimin të vëmendjes së nxënësit. Posaçërisht dëgjimi i përsëritur mundëson njohjen më të gjithanshme të veprave, kompozitorëve, epokave dhe stileve, si dhe formës muzikore e formacioneve interpretuese. Me përgatitje motivuese para dëgjimit dhe komentimet përkatëse pas dëgjimit, procedura mësimore pasurohet dhe bëhet më atraktive për nxënësin.

INTERPRETIM

Intepretimi realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në instrumente. Procedura metodike e këndimit bëhet: sipas veshit (imitimit), tekstit notal

dhe mënyrës së kombinuar (konkretizim) duke marrë parasysh mundësitë individuale të nxënësve. Luajtja në instrumente aplikohet në shoqërimin e këngëve dhe interpretimin e përmbajtjeve të veçanta instrumentale.

KRIJIM

Puna krijuese e vijuesit të mësimit të përshpejtuar duhet të përshkohet nga spontaniteti dhe liria e të shprehurit. Duke marrë parasysh moshën e rritur të tyre, ata mund të shprehen përmes: krijimit të tërësive ritmike dhe melodike, lëvizjes, shprehjes figurative dhe letrare.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore, shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndjeshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar, gjithnjë duke pasur parasysh moshën dhe mundësitë individuale të vijuesve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe ta inkurajojë interesimin e vijuesit për shprehje kreative. Format më të përshtatshme të vlerësimit janë:

- rinjohja e veprave të dëgjuara
- këndimi dhe luajtja instrumentale
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim
- prezantimi
- testi
- vetëvlerësimi

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh rezultatet e arritshmërisë në vartësi me objektivat e parashtruar për mësimin e përsheptuar.

NDËRLIDHJA MESLËNDORE

- ◆ Përmbajtjet vokalo-instrumentale nga krijimtaria popullore dhe artistike i njohin me vlerat kulturore kombëtare e botërore (gjuha amtare, gjuhët e huaja, historia, gjeografia);
- ◆ Përmbajtjet e caktuara muzikore janë të ndërlidhura me natyrën, shoqërinë (gjeografia, historia);
- ◆ Aktivitetet muzikore nxisin të shprehurit kreativ përmes arteve të tjera (arti figurativ, letërsia, lëvizja, vallëzimi).

Tirazhi: 500 copë
E përgatiti për shtyp
SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR – Prishtinë
U shtyp në Shtypshkronjën PRINTING PRESS – Prishtinë

Katalogimi në publikim – CIP
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : (Arsimi joformal) : Për klasën VI dhe VII të shkollës së mesme të ulët / [Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : "Printing Press").- 256 fq.; 24 cm.

ISBN 9951-450-58-X